

NJË VËSHTRIM
I MBULIMIT MEDIATIK
TË PROBLEMATIKËS QË
LIDHET ME FENË
Janar - Dhjetor 2016

Instituti i Dialogut dhe Komunikimit

Ky studim u mundësua në sajë të mbështetjes financiare të fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë

Instituti i Dialogut dhe Komunikimit

Rr. Myslym Shyri, Pall. 47, Ap 4, K. 1

Tiranë, Albania

Tel: +355 4 4507853

web site: www.idk-al.org

e-mail: idx@idk-al.org

PËRMBAJTJA

Hyrje	5
Diskutimet lidhur me propozimin për futjen e edukatës fetare në shkolla	15
Bashkëjetesa fetare dhe rreziku i radikalizmit/xhihadizmit islamik.....	41
Diskutimet per ndikimin turk dhe çështja ‘guleniste’	79
Disa përfundime.....	107
A summery in English	117

HYRJE

Ky studim ka si qëllim të ofrojë një pasqyrë sa më të plotë e të sistemuar të mënyrës se si media e shkruar shqiptare ka mbuluar dhe trajtuar temën e fesë gjatë një periudhe të caktuar, duke u përpjekur të evidentojë problematikat, shqetësimet, perceptimet si dhe disa prej debateve kryesore që zhvillohen aktualisht. Duke qenë në një farë mënyre, një vazhdim i një studimi tjetër të ngjashëm që Instituti i Dialogut dhe Komunikimit hartoi para pak vjetësh (shtator 2011- qershor 2012), me temën: “Feja, Laiciteti dhe Hapësira Publike.”, ai të krijon gjithashtu mundësinë për të parë në një rrafsh krahasues se si ka evoluar jo thjeshtë trajtimi mediatik i kësaj problematike, por para së gjithash shqetësimet e debatet në shoqërinë shqiptare lidhur me këtë temë.

Studimi mbulon një periudhë tetë mujore, e cila nis në muajin janar të vitit 2016 e përfundon në muajin shtator të të njëjtit vit.

Përjashtim bën vetëm kapitulli që i kushtohet diskutimeve lidhur me ndikimin e Turqisë në zhvillimet në gjirin e Islamit shqiptar, e në mënyrë më të veçantë, të ashtuquajturës ‘çështje

të gulenistëve'. Siç dihet, debatet për këtë çështje kanë ekzistuar edhe më parë, por morën hov në mënyrë të veçantë pikërisht në muajt pas grushtit të shtetit të dështuar në Turqi në mes të muajit korrik 2016. Duke qenë se këto debate jo vetëm kishin lidhje të drejtëpërdrejtë me temën e këtij studimi, por dhe shërbenin për të hedhur dritë në një problematikë me mjaft interes, u mendua që vetëm për këtë çështje periudha e marrë në shqyrtim të shtrihej deri në fund të vitit 2016.

Siç dihet qeveria turke fajësoi për grushtin e shtetit të dështuar lëvizjen FETO (guleniste), duke i shpallur asaj një luftë të pamëshirshme. Kjo gjeti pasqyrim dhe në kërkesat e vazhdueshme të autoriteteve turke ndaj qeverisë shqiptare për të marrë masa për të eliminuar ndikimin e kësaj lëvizjeje, të cilën qeveria turke e konsideron terroriste, në Shqipëri. Sipas qeverisë turke, në Shqipëri lëvizja FETO ka një ndikim mjaft të madh, e cila nuk mjaftohet thjesht në institucionet arsimore që ajo kontrollon, të njohura përgjithësisht si shkollat turke. Sipas palës turke, lëvizja FETO ka një ndikim të madh dhe në politikën, median, ushtrinë, policinë e botën akademike shqiptare, përfshirë këtu dhe vetë Komunitetin Musliman dhe institucionet që ky ka në vartësi të tij.

Ndonëse çështja është mjaft më komplekse, fakti që ajo ka lidhje të drejtëpërdrejtë me zhvillimet në gjirin e komunitetit mysliman shqiptar, e më në përgjithësi, me debatin për përdorimin e fesë nga ana e vendeve të ndryshme si një instrument i ndikimit të tyre politik e gjeopolitik, na bëri që t'i kushtojmë asaj një kapitull më vete.

* * *

Për arsye metodike, shkrimet e shqyrtuara gjatë kësaj periudhe janë të ndara në tri grupime kryesore tematike, secilit prej të cilëve i është kushtuar një kapitull më vete.

Bëhet fjalë në vija të përgjithshme për tre problemet kryesore që lidhen me fenë, që kanë tërhequr më shumë vëmendjen e opinionit publik gjatë kësaj periudhe. Janë po ashtu çështjet që kanë ngjallur dhe diskutimet më të shumta.

Në grupimin e parë janë përfshirë shkrimet që lidhen me debatet e zjarrta që ngjalli ideja e hedhur jo shumë kohë më parë nga ana e Kryeministrit Edi Rama për futjen e edukatës fetare si pjesë e kurrikulave të arsimit publik. Ndonëse ndoshta më të pakta në numër po t'i krahasosh me shkrimet e përfshira në ndonjë tjetër grupim, për nga rëndësia e problematikës që ato cekin, ky është ndoshta dhe grupimi më interesant.

Bëhet fjalë për një debat që në thelb ka të bëjë me raportet mes besimit fetar dhe institucioneve fetare dhe laicitetit, si një ndër parimet kushtetues që qëndron në themel të ngrehinës të bashkëjetesës fetare qysh prej krijimit të shtetit shqiptar diç më shumë se një shekull më parë.

Grupimi i dytë, me titullin përgjithësues “Bashkëjetesa fetare dhe kërcënimi i radikalizmit islamik”, përmbledh një numër shkrimesh nga më të ndryshmit, por që kanë të përbashkët temën e bashkëjetesës fetare dhe shqetësimet lidhur me faktorët që mund ta dëmtojnë atë. Në këtë grupim bëjnë pjesë dhe shkrimet për terrorizmin dhe, më në përgjithësi, për radikalizmin islamik.

Nga pikëpamja numerike, ky grupim përbën padyshim dhe atë më të madhin, çka shpjegohet me shfaqjen në trojet shqiptare të një islami radikal, me prirje xhihadiste e me lidhje qartazi ndërkombëtare, i cili gjeti shprehje me praninë e një numri jo të vogël shqiptarësh që shkuan të luftonin në Siri në radhët e luftëtarëve të Shtetit Islamik.

Po ashtu, mjaft vëmendje gjatë kësaj periudhe ngjalli dhe gjyqi i zhvilluar në Tiranë kundër të ashtuquajturve imamë, të akuzuar për nxitjen e urrejtjes fetare dhe për rekrutimin e luftëtarëve të dërguar në Siri. Është gjyqi i parë i këtij lloji që zhvillohej në Shqipëri.

Kapitulli i tretë dhe i fundit, siç u tha dhe më lart, është ai që i kushtohet të ashtuquajturës ‘çështje të gulenistëve’, por që, ç’është e vërteta, trajton një tematikë më të gjerë që ka të bëjë me implikimin që mund të kenë ndikimet e ndryshme nga jashtë vendit në zhvillimet fetare në vend, në vetë bashkëjetesën fetare, por po ashtu dhe në vetë politikën, e orientimin gjeopolitik të vendit.

* * *

Sidoqoftë, duhet thënë qëllimi i studimit s’është thjesht që të grumbullojë një bazë të dhënash për mënyrën se si është mbuluar tema e fesë nga ana e medias së shkruar brenda një periudhe të caktuar kohore. Objektivi kryesor është që, duke ofruar një fotografim sa më të plotë të mënyrës se si shtypi shqiptar i është qasur kësaj teme, të ketë mundësi të analizojë dhe, tek e fundit,

të mbërrijë në një sërë përfundimesh lidhur me vendin që zë aktualisht feja në shoqërinë shqiptare.

Për t'ia arritur kësaj, natyrisht që në një sërë rastesh kemi qenë të detyruar ta hedhim shikimin edhe përtej periudhës së kufizuar kohore të marrë në shqyrtim, duke iu referuar jo rrallë një sërë dukurish, e sidomos debatesh që, edhe pse mund të jenë zhvilluar më parë, vazhdojnë të mbeten domethënës kur vjen puna për të kuptuar e shpjeguar prirjet, dukuritë e tensionet kryesore që janë vërejtur gjatë viteve të fundit, sidomos në raportet mes laicitetit, si një ndër parimet kryesore kushtetuese mbi të cilët është organizuar jeta publike e vendit, dhe presionit për një prani gjithnjë e më të madhe të fesë dhe simboleve të saj në hapësirën publike të vendit.

Fjala është, para së gjithash, që duke vëzhguar e analizuar mënyrën se si shtypi i një periudhe të caktuar kohore ka mbuluar një sërë ngjarjesh të ndodhura që në një mënyrë a një tjetër kanë lidhje me fenë, apo ato debate për të cilat ka pasur më shumë vëmendje mediatike, të mund të nxirren në pah dhe njëkohësisht të kuptohen më mirë ndjeshmëritë e ndikimet që ekzistojnë në ambiente të ndryshme të opinionit publik lidhur me faktorin fetar, apo diskutimet dhe shqetësimet e herëpashershme për ndërhyrjen e mundshme të fesë në politikën shqiptare, apo dhe frikën prej pasojave që mund të sjellin përpjekjet e faktorëve të ndryshëm jashtë vendit për ta përdorur fenë si një instrument ndikimi me karakter politik apo dhe gjeopolitik.

Po ashtu, në fund të studimit, duke u bazuar në materialin e mbledhur, do mundohet të ravijëzohen fare shkurt, disa skenarë

të mundshëm për sa i takon së ardhmes së afërt.

Shqyrtimi ynë është i përqendruar sigurisht, në radhë të parë në median që botohet aktualisht në Shqipëri, ku historikisht ekziston gjithnjë një ndjeshmëri e veçantë për sa i takon dinamikës së raporteve mes shoqërisë shqiptare dhe faktorit fetar. Po ashtu, duhet thënë se, për arsye praktike, studimi mbulon kryesisht median e shkruar dhe më pak atë elektronike, e cila do kërkonte një tjetër nivel monitorimi që ne s'i kishim mundësitë ta bënim në kuadër të këtij studimi.

Kjo nënkupton që gjatë një periudhe nëntë mujore janë nxjerrë të gjitha shkrimet që në një farë mënyre kishin lidhje me fenë, të botuara në gazetata e përditshme. Në një sërë rastesh janë nxjerrë dhe disa shkrime të botuara fillimisht në disa prej portaleve më me ndikim, por në përgjithësi kjo ka ndodhur vetëm atëherë kur këto shkrime kanë gjetur jehonë dhe kanë ndërhyrë në median '*mainstream*'.

Në studim ka gjithashtu një pjesë të veçantë që i kushtohet medias së Kosovës, e debateve të zhvilluara gjatë së njëjtës periudhë aty për këtë temë. Sigurisht që në këtë rast kemi të bëjmë me një vështrim disi më të përmbledhur, pa asnjë pretendim shterues. Kjo është bërë për arsyen e thjeshtë se, pavarësisht nga specifikat dhe dallimet që ekzistojnë në këtë aspekt mes Shqipërisë dhe Kosovës, s'ka asnjë dyshim se për një mori arsyesh mes tyre ekziston një lidhje e kontaminim reciprok i cili nuk mund të neglizhohet. Kjo është veçanërisht e dukshme në çështjen e radikalizmit islamik, apo të së ashtuquajturës "çështje"

guleniste.

Si përfundim, duke u munduar të japim një vështrim sistematik dhe gjithë përfshirës të mënyrës se si media shqiptare ka mbuluar gjatë një periudhe të caktuar kohore temën e fesë, të ngjarjeve që lidhen me të, të vendit që feja dhe simbolet e saj zënë apo duhet të zënë në hapësirën publike, objektivat kryesore që synohet të arrihen nga ky studim janë dy:

- Të ofrojë një vështrim të përgjithshëm të atyre çështjeve që ekzistojnë, si dhe të gjithë shqetësimeve, frikërave, pretendimeve, pritshmërive dhe ankesave që karakterizojnë aktualisht perceptimin e publikut në përgjithësi, apo qoftë dhe të grupeve apo grupimeve të ndryshme.
- Të ndihmojë për një ndërgjegjësim publik përsa i takon problemeve, sfidave dhe rreziqeve që mund të sjellë në kohën e globalizimit për një vend si Shqipëria, konfuzioni, ambiguiteti apo improvizimi që ka rrethuar deri tani një fushë si kjo, kaq të rëndësishme kur vjen puna për të ruajtur balancat që kanë ekzistuar tradicionalisht në një vend si Shqipëria, por në fund të fundit, edhe vetë kohezionin fetar të shoqërisë shqiptare.

Sigurisht që një ndër objektivat e një vrojtimi të tillë është të tregojë se cilat janë disa prej sfidave të mundshme me të cilat

shoqëria shqiptare mund të përballet në këtë drejtim në një të ardhme të afërt.

* * *

Gjatë periudhës së shqyrtuar në shtypin e shkruar shqiptar është botuar një numër ndoshta rekord shkrimesh që, në një mënyrë a një tjetër, kanë lidhje me tematikën fetare. Vetëm për nevojat e këtij studimi u shqyrtuan 487 shkrime numër ky që s'ka dyshim që duhet të jetë mjaft më i madh, duke pasur parasysh se kërkimi i kryer u përqendrua kryesisht vetëm në gazetatat kryesore të përditshme, si dhe në një numër mjaft të kufizuar portalesh, të cilët u përzgjedhën për shkak të ndikimit që mund të kishin në debat.

Është një shifër kjo gati sa dyfishi i asaj të katër vjetëve më parë.

Sidoqoftë, arsyeja e këtij interesimi të shtuar në një farë mënyre është lehtësisht e shpjegueshme. Kjo lidhet, para së gjithash, me aktualitetin e veçantë që mori tema e luftës kundër terrorizmit të motivuar fetarisht gjatë kësaj periudhe. S' duhet harruar se gjatë kësaj periudhe tema e luftës kundër ISIS (Shtetit Islamik- Daesh) ka qenë në krye të axhendës ndërkombëtare, ndërkohë që në Europë, jo larg nesh, patëm një sërë ngjarjesh tejet të rënda, si atentatet terroriste në Paris, në Bruksel, apo dhe në Turqi, të cilat ndikuan dukshëm në shtimin e vëmendjes ndaj terrorizmit islamik. Kësaj i duhet shtuar dhe çështja e vërshimit në Europë të refugjatëve prej Lindjes së Mesme, dhe tensionet e

debatet e mëdha politike që kjo ngjalli në mbarë Europën edhe lidhur me çështjet fetare. Në këtë kontekst global të rritjes së perceptimit të një rreziku islamik, çka solli kudo në Europë një rritje të stereotipeve dhe të një populizmi anti-Islam, është e natyrshme që në një vend si Shqipëria, të kemi një vëmendje të shtuar për këtë temë.

Kjo shpjegon dhe një rritje të dukshme të shkrimeve të përkthyer nga shtypi botëror që janë botuar në shtypin shqiptar të kësaj periudhe. Bëhet fjalë për shkrime që kanë në qëndër të tyre Shqipërinë e më në përgjithësi, shqiptarët, por po ashtu dhe debatin e madh që po zhvillohet sot në Europë lidhur me islamin.

Në fakt, parë nga më afër, janë të shumtë faktorët që, në një mënyrë a një tjetër, ndikuan që gjatë kësaj periudhe të kemi një vëmendje të shtuar jo thjesht në shtyp, por më në përgjithësi, në mbarë ligjërimin publik, ndaj temës së fesë. Kjo lidhet dhe me shqetësimet e natyrshme që ngjall në një vend si Shqipëria, e cila është e destinuar të përjetojë tensionet që sjell ‘ambiguiteti’ mes faktit që, nga njëra anë, shqiptarët mbeten një ndër popujt më entuziastë për të përqaftuar çdo gjë europiane, që e shohin fatin e tyre historik të lidhur ngushtë me familjen e madhe të popujve europianë, ndërkohë që, nga ana tjetër, janë një ndër popujt e paktë të kontinentit ku shumica e popullsisë është e besimit musliman. Një situatë e tillë, natyrshëm sjell shqetësime e debate në një plan afatshkurtër, për rreziqet që mund të vinë prej radikalizimit fetar e xhihadizmit islamik. Kurse në një vështrim më të gjerë, për raportet mes identitetit kombëtar dhe fesë, për vendin e fesë

në hapësirën publike e në politikë, për rreziqet që mund të vijnë në një kohë kur feja është duke u bërë gjithnjë e më shumë një instrument e ndikimit politik e gjeopolitik, e kështu me radhë. Kjo shpjegon dhe shqetësimin në rritje për një aktivizim gjithnjë e më të dukshëm për aktivizimin e fesë (Islamit) si një instrument të ndikimit politik e gjeopolitik nga ana e Turqisë, apo për dyshimet lidhur me raportet mes Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare dhe Greqisë.

DISKUTIMET LIDHUR ME PROPOZIMIN PËR FUTJEN E EDUKATËS FETARE NË SHKOLLA

Le ta fillojmë, duke kujtuar se dhe para disa vjetësh (në vitin 2012) pati po ashtu një debat të ngjashëm për futjen ose jo të edukatës fetare në arsimin publik, kur Ministri i atëhershëm i Arsimit, z. Myqerem Tafaj, i Partisë Demokratike (me mbështetjen e fortë, duhet thënë, të komuniteteve fetare) paraqiti në Parlament projektligjin e ri për arsimin parauniversitar, në të cilin parashikohej dhe përfshirja e edukatës fetare në kurrikulat e shkollave publike.

Atë kohë propozimi i Ministrisë së Arsimit u hodh poshtë nga Komisioni Parlamentar i Arsimit dhe Kulturës, dhe çështja që dhe atë kohë ngjalli mjaft diskutime në shtyp, u mbyll me kaq.

Sidoqoftë, është me vend të kujtojmë se aso kohe s'u duk të ishte krejtësisht një koincidençë fakti që vetëm pak muaj përpara propozimit të Ministrisë Tafaj, një propozim mjaft i ngjashëm për futjen e edukatës fetare në arsimin publik qe bërë në Kosovë, në formën e disa amendimeve për ligjin të arsimit të Republikës së

Kosovës. Siç dihet¹, propozimi ngjalli mjaft debate në Kosovë dhe më në fund, Parlamenti i Kosovës i hodhi poshtë amendimet e propozuara.

Duhet shtuar se dhe në debatet që ngjalli propozimi i z.Tafaj në vitin 2012, një pjesë e madhe e debatit lidhej me paqartësinë se ç'nënkuptohej me idenë e 'edukimit fetar', kurse shqetësimi kryesor lidhej me cenimin e laicitetit të arsimit publik.

Ishte pra e pritshme që një propozim i tillë do të ngjallte mjaft debate, aq më tepër kur së paku fillimisht s'qe aspak e qartë se çfarë nënkuptohej me një propozim të tillë, madje qenë jo pak ata që hodhën dyshimin që mbas një propozimi të tillë qëndronte një lloj flirtimi politik me motive elektorale me komunitetet fetare, e së pari atë musliman. Kjo lidhej dhe me faktin që për herë të parë këtë ide kryeministri Rama e përmendi pikërisht në një aktivitet të organizuar prej Komunitetit Musliman Shqiptar (Ditëlindja e Muhamedit, më 9 prill 2016).

Sidoqoftë, duhet thënë se nëse vërtet gjatë fjalës së tij kryeministri Rama ndoshta s'qe fort i qartë se çfarë nënkuptonte me konceptet edukatë fetare apo 'kulturë e feve', ai qe mjaft i qartë përsa i takonte motiveve që qëndronin pas një nisme të tillë.

“Besoj fort,” tha ai ndër të tjera, “se ka ardhur momenti që me kurajo, shteti shqiptar t'i çelë dyert e shkollave për njohjen e besimeve fetare. Ti çelë dyert e shkollave për t'i dhënë çdo

1 Për më shumë për këtë, shih “Feja, Laiciteti dhe Hapësira Publike, Shtypi Shqiptar për raportet mes fesë, laicitetit dhe hapësirës publike - shtator 2011- qershor 2012.” IDK

fëmije mundësinë të armatoset me instrumentet e dijeve dhe të mos jetë viktimë e propagandave tunduese të atyre që s'kanë asnjë lidhje me profetët që i çelën rrugë qytetërimeve të sotme dhe që në emër të islamit kryejnë krime të cilat janë të destinuara të ndëshkohen,” deklaroi Edi Rama, duke shtuar: “Besoj se sot të gjithë duhet të ndiejmë përgjegjësinë e madhe se të rinjtë, adoleshentët në Tiranë apo Paris, Prishtinë apo Londër, në Europë apo ShBA, janë të paarmatosur me instrumentat e dijes për t'u përballur me demagogët, me sharlatanët që kërkojnë të nxjerrin përfitime duke e përgjakur njerëzimin apo duke e tërhequr për hunde. Unë besoj se mbi këtë terren injorance, ku përfitojnë ekstremistët e dhunshëm apo ato të veshur me kostum dhe kravatë që i flasin Evropës dhe Amerikës për rrezikun e myslimanëve, i takon çdo shteti që t'i hapë rrugë që çdo fëmijë të ushqehet me kulturën e feve. Sepse aty qëndron një forcë e madhe jo vetëm për besimtarët, por edhe jo besimtarët.” (Gazeta Shqiptare, datë 10 prill, 2016).

Pikërisht një keqkuptim i tillë (në fakt, u desh një farë kohe deri sa të sqarohet se s'bëhej fjalë për mësimin e fesë, por për historinë e feve) karakterizon sidomos fillimisht (por jo vetëm) një pjesë të madhe të debatit që pasoi nismën e shpallur prej Kryeministrit. Në fakt, për këtë kontribuoi dhe entuziazmi me të cilin u prit ky propozim nga një pjesë e madhe e përfaqësuesve të bashkësive fetare, apo të njerëzve pranë tyre, si dhe mënyra se si shumë prej tyre e interpretuan atë.

“Së fundmi hidhet një hap për përfshirjen e një lënde fetare në sistemin arsimor, domosdoshmëri, marrë për bazë edhe situatat

e krijuar këto kohë mbi shqetësimet tepër serioze të prodhimit të ekstremizmit të dhunshëm. Por ajo që do ta qartësojë plotësisht, pasi të ulen pjesëmarrës të Komunitetit Mysliman Shqiptar, nga Ministria e Arsimit është bisedimi se cili draft do të përzgjidhet për Shqipërinë”, komentonte Ylli Gurra, myftiu i Tiranës (gazeta Shqip ‘Feja në shkollat e Shqipërisë, mes polemikash e përkrahjesh’, 10 prill 2016). Sipas shkrimit të kësaj gazete, qeveria kishte një farë kohe që zhvillonte konsulta, të cilat “... pritet të vazhdojnë ndërmjet përfaqësuesve të komuniteteve fetare në lidhje me programin mësimor, sesa i thelluar do të jetë informacioni mbi fenë dhe se cilët mësues do ta japin këtë lëndë nëpër shkolla.”

“Kisha Katolike ka reaguar në lidhje me diskutimet për futjen e kulturave fetare si lëndë e veçantë në shkolla, duke mbështetur projektin pilot që do të aplikohet në 10 institucione arsimore.” njoftonte ‘Gazeta Sot’ në një shkrim të titulluar: *“Kisha Katolike: Në Shqipëri ka boshllëk në futjen e kulturave fetare si lëndë e veçantë”* (11 prill 2016)

Ndërsa Monsinjor George Frendo, duke e përshëndetur nismën që, sipas tij, do mbushte një boshllëk të sistemit arsimor, vinte në dukje se *‘gjithë përfaqësuesit e besimeve kryesore fetare këtu në Shqipëri, kemi bërë disa sugjerime.’* Duke shtuar se, sipas tij, *“Mësuesit që japin mësim mbi fenë, duhet të jenë shumë të përgatitur.”*

Por më tej i njëjti artikull i gazetës Shqip që citonte dy klerikët, s’linte pa shtuar faktin se *‘deklarata e kryeministrit dhe mungesa e informacionit mbi këtë projekt ka ndezur polemika në rrjetet*

sociale lidhur me laicitetin e shkollës sonë.” Sipas njoftimit të kësaj gazete, mjaft prej “*pedagogëve të Universitetit të Tiranës deklarohen kundër kësaj ideje.*” Dhe në shkrim citohej një prej tyre, profesor Artan Trebicka, i cili shprehej i indinjuar: “*Ku jemi këtu, në Iran, në Arabinë Saudite apo në Evropën mesjetare? Nëse një prind do që fëmija e tij të marrë mësim fetare, e çon në një shkollë të licencuar për këtë punë dhe jo në një shkollë shtetërore. Mos vallë duhet ta mbushim shkollën me ferexhe apo veladone priftërinjsh?*”.

Mbështetje të pakushtëzuar ndaj idesë së kryeministrit shprehte dhe Ylli Doçi, Kryetar i Vëllazëria Ungjillore të Shqipërisë, në një shkrim të gjatë me titullin domethënës: “*Pse mbështesim nismën e kryeministrit për mësimin e fesë në shkolla*” (Gazeta Tema, 14 prill 2016.). Ndër të tjera, z. Doçi, pasi analizon arsyet përse, sipas tij, nisma e kryeministrit duhej përshëndetur, kujtonte dhe se përpara bërjes publike të kësaj nisme, qeveria kish komunikuar me bashkësitë fetare: “*Kryeministri ka qenë transparent me ne, 5 komunitetet e zyrtarizuara fetare (Ungjillorët, Ortodoksët, Katolikët, Muslimanët dhe Bektashinjtë), duke na njoftuar më herët për këtë iniciativë dhe duke na ftuar në procesin e përgatitjes së zbatimit të kësaj iniciative.*” shkruante ai. Autori e mbyllte shkrimin me idenë se “*Fatmirësisht ekzistojnë përvoja të shumta nga vende të ndryshme në këtë drejtim dhe nuk do kemi nevojë të krijojmë çudira, por sigurisht do kërkohej një diskutim i përshtatur ndaj situatës shqiptare ku asnjë nga fetë nuk ka monopolin e Shqiptarisë që konsiston në bazën e bashkëjetesës sonë vëllazërore.*”

I vetmi komunitet fetar që duket sikur shprehte një qëndrim më së paku të rezervuar ndaj këtij projekti të paraqitur prej kryeministrit, ishte ai ortodoks. Ndonëse nuk kemi një reagim zyrtar prej këtij komuniteti, në ditët menjëherë pas prezantimit të projektit kemi dy shkrime të gjata prej njerëzve pranë tij. I *pari nga Miron Çako*, përgjegjës i zyrës së katekizmit pranë KOASH, titullohej: “*Përse e mbështes me rezerva nismën e qeverisë për futjen në shkollë të mësimi fetar*” (gazeta Tirana Observer, 12 prill 2016); kurse i dyti i titulluar: “*Avantazhet dhe pikëpyetjet e mësimi të fesë*” kishte si autor *Lek Tasin dhe Lluka Qafokun*, (Panorama, 26 prill 2016.)

Shkrimi i parë, ndonëse në parim e mbështeste idenë e përfshirjes së edukatës fetare në programin mësimor të shkollave publike, shprehte dyshime për sa i takonte rolin që do të kishin vetë bashkësitë fetare në këtë proces.

Dhe shkrimi i dyti është pak a shumë në të njëjtën linjë. Ndërkohë që mbështetet ideja e përfshirjes së lëndës për fenë në arsimin publik, shfaqen jo pak dyshime porsa i takon mënyrës se si mund të vihet në jetë ky projekt, duke shprehur rezerva serioze për vetë konceptin e lacitytit të shkollës, së paku, sipas tyre, në mënyrën se si ai interpretohet sot tek ne.

Për më shumë lidhur me këtë, *shih dhe shkrimin: “Kisha Katolike: Në Shqipëri ka boshllëk në futjen e kulturave fetare si lëndë e veçantë”* (Gazeta Sot, 12/04/2016, si dhe Baklanweb, të po asaj date.)

* * *

Sidoqoftë, ndoshta pikërisht duke parë reagimin e madh që ky propozim shkaktoi në një pjesë të opinionit publik, qeveria u ngut të sqaronte, fillimisht nëpërmjet Ministres së Arsimit, znj. Lindita Nikolla, e më pas nëpërmjet vetë kryeministrit, se s’bëhej fjalë për mësimin e fesë në shkolla, por për historinë e feve.

“Ministrja Nikolla: Nuk fusim mësimin e fesë në shkolla, por të kulturave fetare.” e titullonte lajmin ‘Balkanweb’ (11 prill, 2016). Kurse gazeta ‘Koha Jonë’ e së njëjtës datë e titullonte shkrimin e saj: *“Studim jo i fesë, por i historisë së feve”*. Gazeta ‘Panorama’ nga ana e vet e titullonte shkrimin e saj: *“Debati për fenë në shkolla, ministrja Nikolla: Do të jepet nga mësuesit, jo klerikët”* (11 prill, 2016). *“Ministrja e Arsimit, Lindita Nikolla,”* thuhet në lajmin që kjo gazetë botoi, *“pas deklaratës së Kryeministrit Edi Rama për futjen e fesë në shkollë, ka sqaruar se bëhet fjalë për një projekt pilot që do të aplikohet në vitin akademik 2016-2017 në vetëm 10 shkolla. Lënda e re do të quhet “Historia e besimeve fetare” dhe do të mësohet në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme.”* Sipas saj, *“Fillimisht projekti do të zbatohet në 10 shkolla pilot, në klasat e gjashta dhe në vitin e parë në gjimnaz”*, siç sqaroi ajo më pas në Komisionin e Arsimit.”

Po të njëjtën ditë reagoi për këtë çështje që nga Shtetet e Bashkuara, ku ndodhej atë kohë për një vizitë zyrtare, dhe vetë kryeministri Edi Rama, duke iu përgjigjur kështu akuzave dhe shqetësimeve të ngritura lidhur me futjen e fesë në shkolla.

“Kjo ide,” shkroi ndër të tjera kryeministri Rama, “s’ka asnjë lidhje me çka është komentuar fare gabimisht, si mësim i fesë në shkollë. Është një program që nuk do cenojë kurrse laicitetin e shkollës. Ai do të pajisë të rinjtë qysh në shkollë me disa njohuri bazë, për të kultivuar respektin për besimin e tjetrit dhe për të mos rënë pre e rrjeteve të propagandës ekstremiste, në emër të një feje apo kundër një feje tjetër. Siç e thotë edhe Ardian Vehbiu, një program i tillë do të kërkojë kohë të konsiderueshme, vite, për të dhënë fryte pasi të jetë konsoliduar dhe përfshirë plotësisht në kurrikulat shkollore. (“Rama: Feja në shkolla, pajis të rinjtë me kulturë besimi, nuk cenon laicitetin” Gazeta Panorama, 11 prill 2016).

Në ndërhyrjen e tij Rama iu referua një shkrimi të publicistit Ardian Vehbiu, të botuar fillimisht (po atë ditë) në blogun e tij ‘*Peizazhe të fjalës*’. Madje kryeministri shkoi dhe më tej, duke e ribotuar krejt shkrimin e Aradian Vehbiut në faqen e tij në Facebook.

Duhet thënë se ndër përkrahësit e idesë së kryeministrit për futjen e edukimit fetar në arsimin publik, Ardian Vehbiu ishte ndoshta ai i cili qysh në fillim arriti të artikulonte më qartë argumentet në favor të idesë për studimin e historisë së feve në shkolla. Kjo është dhe arsyeja përse më poshtë po japim disa pasazhe të zgjeruara nga ky shkrim.

Shkrimi i Ardian Vehbiut titullohej : *“Në shkolla, studim jo i fesë por i historisë së feve”* (“Peizazhe të fjalës,11 Prill 2016).

Pasi kujton kundërshtimin dhe skepticizmin me të cilën

ishite pritur ideja e kryeministrit për studimin e fesë në shkollat e republikës, Vehbiu kritikonte disa media të cilat e kishin interpretuar këtë si ‘futje’ të “mësimin të fesë” në shkolla.

“Në mësimin e fesë,” shkruan ai, ‘nxënësit mësojnë për fenë e tyre; përkundrazi, ideja e kryeministrit, që përsiatet prej kohësh në Europë, është që në shkolla nxënësit të mësojnë për fenë e tjetrit. “ Më tej Ardian Vehbiu vazhdonte: “Nuk besoj se sot në Shqipëri mund të kërkojë kush futjen e fesë në shkollat publike, qoftë ai edhe kryeministri vetë; por vetëm studimin e historisë së feve, diçka krejt tjetër.”

Njohuritë për fetë, që nuk duhen ngatërruar me besimin fetar, janë bërë tashmë të domosdoshme për formimin qytetar evropian (dhe jo vetëm); në rrethanat kur fetë e ndryshme ballafaqohen mes tyre, por edhe me ateizmin, agnosticizmin dhe misticizmin haptazi dhe fshehurazi.

Brezi im u rrit në një mjedis fetarisht të sterilizuar; por kjo sot na krijon jo pak vështirësi, në përpjekjet për të komunikuar me kulturën, në Perëndim dhe në Lindje.

Brezat më të rinj se imi, që kushedi i ekspozohen trysnive nga burime të radikalizuara të dijes fetare, ndeshin në vështirësi të një lloji tjetër: atje ku ne më të vjetrit mezi i dallojmë diferencat dhe fillesat e ndryshme kulturore, atyre më të rinjve këto mund t’u duken arsye të mjaftueshme për konflikt moral dhe jo vetëm.

Të dyja këto patologji ekspozojnë ndaj rreziqeve dhe konflikteve sociale, sidomos në afat të gjatë.

Padija që shpesh kemi për fenë e tjetrit, por edhe fenë tek e cila thjesht nuk besojmë, shndërrohet në burim përçarjeje dhe

dhune.

Të paditur, e shohim Tjetrin si karikaturë, ose veç duke ia lexuar shenjat e jashtme.

Tjetër punë si do të realizohet njohja e fesë së Tjetrit, ose kush do t'i mësojë mësuesit dhe kush do t'i edukojë edukatorët: historia e feve është disiplinë komplekse dhe e vështirë për t'u rrokur, përtej klisheve pseudo-ekumenike ose kurioziteteve antropologjike. Vetëm vullneti i mirë nuk mjafton; puna e filluar tani, do të japë frytet e saj shumë më vonë.” përfundonte ai.

Duhet thënë se për disa javë me radhë debati për këtë çështje u kthye në diskutimin mbizotërues në pjesën më të madhe të shtypit kryesor shqiptar, çka në një farë mënyre dëshmon ndjeshmërinë e madhe që ekziston në opinionin publik për këtë temë.

Në tërësinë e tyre, mund të thuhet se reagimet e shprehura mund të ndahen në tre grupime të mëdha:

Së pari, në ata që mbështetën propozimin e kumtuar prej kryeministrit.

Në ata që qenë kundër këtij propozimi, të cilët, duhet thënë, përbënin dukshëm shumicën.

Ndërkohë që në një grupim të tretë mund të përmbliidhen ata që, edhe pse në parim s'qenë kundër kësaj ideje, vinin në dukje problematikën dhe vështirësitë e vënies në jetë të kësaj ideje

Në mbrojtje të idesë së futjes së edukimit fetar në shkollat publike, u shprehën një sërë figurash të njohura publike, ndonëse shumë më pak se ata që u shprehën kundër.

Ndër ta mund të përmendet publicisti Andrea Stefani, me shkrimin e tij *“Edhe Marksini e kanë keqlexuar për fenë”* (Gazeta Dita, 12 prill 2016), ku ndër të tjera ai e konsideronte atë si *“një mënyrë e duhur për të parandaluar edhe rënien e njeriut në grackat e ekstremizmit apo terrorizmit që kamufllohet i veshur me petka dhe frazeologji fetare.”*

Po ashtu Daut Gumeni, që në po të njëjtin numër të ‘Gazetës Dita’, botonte shkrimin *“Asgjë e keqe, përkundrazi!”*, ku ndër të tjera shprehej se: *“Mësimi në shkollat tona i historisë së religjioneve të mëdha, do të plotësonte njohuritë e nxënësve tanë me një pjesë të rëndësishme të historisë njerëzore, që ka munguar mjaft gjatë. Nuk ka pse të mos mësohet dhe historia e religjioneve tok me historinë e letërsisë e me historinë e artit. Nuk është katekizëm dhe as cenim i laicitetit të shkollës, të mësojnë nxënësit historinë e religjioneve të mëdha, që kanë transformuar vetë historinë e kulturës njerëzore.”* (Gazeta Dita, 12 prill 2016)

Po kështu në favor të futjes së edukatës fetare në shkolla, u shpreh dhe ish rektori i Universitetit të Tiranës, Shezai Rrokaj (*“Rrokaj: Erdhi koha për një tekst pa dogma dhe që nuk predikon”*, (Gazeta Shqip, 19 prill 2016); apo Sadik Bejko (*“Pse do na vlente historia e fesë”* - Gazeta Panorama, 20 prill, 2016). Mund të përmendet dhe shkrimi i Besi Bekteshit *“Laiciteti shoqëror nuk pengon orën e kulturës së besimit”* (Gazeta Sot, 10 prill, 2016). Apo *“Njohuri fetare dhe jo mësim fetar në shkollat laike’*, nga Piro Prifti (gazeta Shqip, 19 prill 2016).

Një shkrim mjaft interesant është dhe ai me karakter historik, i titulluar *“Kur feja mësohej në shkollë”*, që ka për autor Dr. Hasan

Bellon. Është fjala për një shkrim që na jep një informacion mjaft interesant për përvojën e mësimin të fesë në shkollat shqiptare në periudhën e para luftës së Dytë Botërore. (Gazeta Dita, 14 prill 2016).

Siç është bërë tashmë zakon, në këtë debat të ndezur nuk mund të rrinin pa ndërhyrë dhe ambasadorët e huaj me seli në Tiranë. Kështu, dy prej tyre, më konkretisht ambasadori i Francës në Tiranë, z. Bernard Fitoussi, dhe ai i Gjermanisë, z. Hoffmann, nxituan të jepnin mbështetjen e tyre për nismën e kryeministrit, duke e parë atë si një instrument efikas në luftën kundër terrorizmit. (*“Franca, pro mësimin të fesë në shkollë”* Gazeta Dita, 13 prill 2016; dhe *“Feja në shkolla, Hoffmann: Çdo vend duhet ta shohë vetë këtë mundësi”* Gazeta Panorama/Balkanweb, 13 prill 2016).

Në favor të nismës së parashtruar prej kryeministrit Rama, u shpreh sakaq dhe Ministri i Jashtëm i Kosovës i aso kohe (sot zëvendës kryeministër), z. Petrit Selimi: (*“Selimi: Mësimi mbi fetë duhet futur në shkolla”*), i cili në fakt kërkon që diçka e tillë të vihet në jetë dhe në Kosovë. (Gazeta Panorama 14/04/2016).

Por është interesante të vihet në dukje se si një tjetër figurë po aq e rëndësishme e politikës kosovare, nënkryetar i Partisë Demokratike të Kosovës, e njëjta forcë politike pjesë e së cilës është dhe zoti Petrit Selimi, aktualisht Ministër i punëve të Jashtme të Kosovës, Enver Hoxhaj, u shpreh sakaq në mënyrë kategorike kundër një ideje të tillë. “Enver Hoxhaj del kundër Ramës: Feja dhe arsimit nuk mund të kenë pikëtakim”, e titullonte njoftimin e saj për këtë gazeta Panorama (11 maj 2016), duke iu referuar një interviste të dhënë prej Zotit Hoxhaj në emisionin

Monitor të RTK- së, në të cilën ai ngrinte mjaft pikëpyetje për dobinë e një nisme të tillë në shoqërinë kosovare. Sipas Enver Hoxhajt, Kosova si shtet sekular duhet të ruante karakterin e tillë në çdo institucion.

Në Shqipëri në rrafshin politik përgjithësisht çuditërisht reagimet qenë fare të pakta lidhur me nismën e re të kryeministrit. Vetë forca kryesore e opozitës, Partia Demokratike, nuk bëri asnjë koment lidhur me të. Pati vetëm dy reagime: ai i Ben Blushit, aso kohe ende deputet i Partisë Socialiste, i cili i ftuar në emisionin “5 pyetje nga Babaramo” në Report Tv, u shpreh kundër futjes së lëndëve fetare në sistemin arsimor. *“Më duket e parëndësishme.”* tha Blushi. *“Është shpejt të them e dëmshme. E para se nuk besoj se shkolla vuan se nxënësit nuk kanë njohuri mbi fenë. E dyta nuk jemi një vend që e kemi akoma këtë shqetësim. Shkollat nuk vuajnë nga kjo gjë, vuajnë nga çështje të tjera dhe kjo nuk është një reformë. Shkolla ka nevojë për reformim për arsye të tjera. Kjo është totalisht jo thelbësore e cila po krijon një debat që reformon shkollat”,* u shpreh Blushi. (*“Ben Blushi: Jam kundër hyrjes së fesë në shkollë, Rama ka të drejtë për Trump”* (Tema, 28 prill, 2016.) Politikani tjetër që u shpreh ashpër kundër një ideje të tillë, ishte Luan Rama i LSI-së. *“Një ndër eksponentët e rëndësishëm të LSI-së, Luan Rama ka dalë kundër Ramës në Opinion, në lidhje me përfshirjen e lëndës fetare në shkolla. Luan Rama është shprehur se kryeministri Rama nuk mund të bëjë politikë me fenë...”* njoftonte gazeta Panorama. (*“Mësimi i fesë në shkolla? Luan Rama: Kryeministri po bën politikë. Kundër.”* Panorama 12 prill 2016). *“Nuk bëhet politikë me fenë, por kur*

Kryeministri bën politikë ne nuk mund të rrimë apolitik”, qe shprehur ndër të tjera Luan Rama gjatë debatit të zhvilluar në emisionin Opinion në televizionin Klan.

Në fakt, të krijohet përshtypja se reagimi i eksponentit të LSI-së e ka zanafillën te ai keqkuptim që karakterizon përgjithësisht një pjesë të reagimeve të menjëhershme në shtyp me t’u bërë e njohur kjo nismë e re e qeverisë, pra përpara se Ministria e Arsimit dhe më pas dhe vetë kryeministri të sqaronin se s’bëhej fjalë për të futur në shkolla mësimin e fesë, por të historisë së feve.

* * *

E filluam me ata që u shprehën në favor të idesë së kryeministrit për futjen e edukatës fetare në shkolla. Por është vendi të thuhet se numri i atyre që u shprehën në shtyp kundër kësaj nisme, apo që për arsye nga më të ndryshmet, e vunë në dyshim dobinë apo mundësinë e vënies së saj në jetë pa krijuar probleme, ishte mjaft më i madh. Pa pretenduar të mbërrihet në përgjithësime përsa i takon qëndrimin që ka shoqëria shqiptare për një çështje të tillë, një reagim i tillë (jo vetëm në shtypin *mainstream*, por dhe duke gjykuar nga një vështrim i shpejtë i komenteve në një pjesë të medias sociale) lë të kuptohet ndjeshmërinë e madhe që ekziston (së paku në pjesë të rëndësishme të elitave shqiptare) sa herë që mendohet/dyshohet se rrezikon të preket parimi i laicitetit, një ndër parimet bazë mbi të cilin është ngritur bashkëjetesa jonë fetare, së paku që prej krijimit të një shtetit shqiptar në fillimet e

shekullit të XX.

Për të kuptuar disa prej arsyeve e argumenteve mbi të cilat mbështetej një reagim i tillë ndaj idesë për futjen e edukatës fetare në shkolla, le t'i hedhim në vështrim të shpejt disa prej shkrimeve kryesore.

Një ndër kritikët më të ashpër të nismës së kryeministrit qe prof. Artan Fuga. Kjo kuptohet nga vetë titujt e disa shkrimeve që ai shkroi për këtë temë: *“Fuga: Feja në shkollë e rrezikshme, prodhon radikalizëm”* (gazeta Standard, 14 prill 2016). *“Vendosja e një programi fetar në shkolla,”* shkruante Fuga ndër të tjera. *“në klasat ku ka nxënës minorenë, dhe detyrimi i tyre ligjor për ta ndjekur atë, në kundërshtim me traditat fetare të familjeve të tyre, mund të interpretohet sigurisht nga ana ligjore dhe kushtetonyjëse si shkelje e lirisë të besimit të familjeve dhe e së drejtës të tyre për të edukuar fëmijët e tyre me besimin e paraardhësve. Edhe po qe se është një interpretim laik i historisë të fesë përsëri ky intepretim nuk është neutral por cenon historinë e fesë të shkruar sipas të katolikëve, sipas myslimanëve, sipas hebrenjëve, sipas ortodoksëve.”* Duke e përfunduar me një paralajmërim: *“Kujdes ! Po hyni në një rrugë shumë të rrezikshme që prodhon radikalizim nëpërmjet konkurrencës mes feve dhe konkurrencës mes feve dhe shkollës.”*

Shkrimi tjetër i Artan Fugës kuptohej që nga vetë titulli se kishte qëllim të polemizonte me vetë sqarimin që pasoi shpalljen e nismës prej qeverisë: *“Nuk do mësojmë fenë, por historinë e feve, budallallëk pedagogjik”*, e titullonte atë Artan Fuga. (Standard, 14 prill 2014). Në fakt, kësaj here argumenti i tij është

krejt i ndryshëm: “*Fe ne formë historie...*” shkruan ai. “*çfarë budallallëku pedagogjik është të thuash se nuk do të mësojmë fenë në shkolla, por do të mësojmë historinë e feve. Këta po shekullarizojnë hyjnoren... Ore a ka klerikë në këtë vend apo jo?*” pyet ai në fund.

Një tjetër emër i njohur, Moikom Zeqo, e titullonte ndërhyrjen e tij në gazetën Dita (12 prill 2016) : “*Shpresoj që deklarata e Ramës të harrohet sa më shpejt*”. Nga argumentet që ai parashtron, duket se ky reagim ka gjasa të bazohet më shumë në keqkuptimin që karakterizoi shumë prej reagimeve të para, pra në perceptimin se bëhej fjalë për mësimin e fesë dhe jo të historisë së feve. “*Deklarata e Edi Ramës është jashtë parametrave kushtetues. Futja e mësimit të fesë në shkollat tona është një gjë as e arsyetuar dhe as e argumentuar, as kombëtare dhe as juridike. Laiciteti i shtetit është një fitore kolosale e njerëzimit.*” shkruante Moikom Zeqo. Që vazhdon po aty “*Që në shekullin e 19-të, pra rreth tre shekuj më parë rilindasit tanë të mëdhenj e kishin shumë të qartë laicitetin e shtetit.*”

Në të njëjtën gazetë, shkrimtarja Flutura Aça shqetësohet për atë që ajo e sheh si një eksperimentim me ‘laicitetin e shkollës.’ Jo rastësisht ndërhyrja e saj titullohet: “*Laiciteti në shkolla, shkrimtarja hap debat: Të mbahet Referendum popullor*”(Gazeta Dita, 18 prill 2016). Ndër të tjera Flutura Aça shkruan “*Në Perëndim kam vënë re se Kisha rri të Kisha, edhe Xhamia rri te Xhamia. Vetëm këtu, në kaosin tonë shteti do të thotë Kishë dhe Xhami dhe anasjelltas... Jam e sigurt që eshtrat dhe hija e ideatorëve të vërtetë të Laicizmit të Shtetit dhe Shkollës*

Shqiptare, rrëqethen kur dëgjojnë si i ngatërrojnë dhe i fusin në një godinë shqiptarët dhe politika sot Fenë dhe Shkencën. Ata janë të ndara... të paktën në shkolla, duhet të mbeten të tilla. Meqenëse referendimet shihen si mjet të vendimit të popullit, e mira e do që në këtë pikë, politika t'i drejtohet popullit për të vendosur për Laicitetin e Shkollës, ndryshe pas njëzet, tridhjetë vitesh, demi (nëse do të jetë i tillë), do të jetë i pariparueshëm!” shkruan ajo.

“Feja nuk është zgjidhja por vetë problemi” shkruan gazetari Mentor Kikia (Balkanweb 11 prill 2016). “...Gjëja më e mirë që mund të bëjmë është që shkollën te mos e ngatërrojmë me këtë punë. Ekstremizmit shteti ti tregojë forcën e ligjit, duke mbyllur xhamitë-punishte ku Kurani lexohet si tu teket kriminelëve sharlatanë që bëjnë thirrje për gjak. Ndërsa fenë ta lëmë aty, në qetësinë e vet. Kush të dojë le të besojë, kush të dojë le të mësojë Bibël e Kuran, kush të dojë ti drejtohet Krishtit e kush Muhamedit. Sa më larg fenë nga shteti, sa më larg nga politika, sa më larg nga shkolla, sa më larg nga kutitë e votimit. Këtë duhet të bëjmë sot e në të ardhmen.” Shkruan ndër të tjera Kikia në shkrimin e tij.

“Mësimi fetar në shkolla është thjesht i tepërt!” reagon, po ashtu, publicisti Ben Andoni, i cili e mbyll shkrimin e tij të gjatë me akuzën se një nismë e tillë s’është gjë tjetër veç një “harrim i përpjekjes së madhe të patriotëve shqiptarë që laicitetin e shkollës e shpallën kredo të punës së tyre dhe që shërbeu për krijimin e shkollës laike kombëtare, një nga gjërat më të mira që ka mbajtur këtë vend në shekuj.” (TemA on line/Java news 10 prill 2016.)

Edhe më i ashpër tregohet pedagogu Fatos Tarifa në shkrimin e tij *“Në një shtet sekularist! Në shekullin e 21-të!”* (Gazeta Mapo, 14 prill 2016). *“Debati lidhur me mësimin e fesë në shkollat tona, që ka nisur kohët e fundit,”* shkruan Tarifa. *“mund të jetë vetëm maja e ajsbergut e asaj tronditjeje të thellë që mund të ndiejë shoqëria shqiptare nëse mësimi i fesë në shkollat publike legjitimohet në atë mënyrë që nuk duhet.”* E nis ai shkrimin e vet, të cilin e mbyll kështu: *“Në një shtet laik dhe në një shkollë laike, nxënësit duhet të mësohen të dyshojnë në besimet e fesë dhe në çdo dogmë (fetare, politike ose ideologjike) duke ia nënshtruar ato një arsyetimi rigoroz e të mbështetur empirikisht, dhe jo të ushqehen me to.”*

Nuk e shohim me vend të rendisim këtu radhën tepër të gjatë të shkrimeve të botuara në gazetatat kryesore ditore që kundërshtonin nismën e shpallur nga Kryeministri Rama. Sidoqoftë, mendojmë se përsa i takon problematikës së ngritur dy janë shqetësimet kryesore që ato shprehnin:

1. Frika e cenimit të parimit të laicitetit në arsimin publik, që për autorët e shkrimeve vazhdon të mbetet parimi themelor mbi të cilin ngrihet kohezioni ynë kombëtar si shqiptarë.
2. E lidhur me këtë, faktorizimit të fesë si një element përçarës. Për këtë mjafton t’u hedhësh një shikim sado të përciptë titujve të tipit” *“Feja në arsim për të përçarë shqiptarinë”* nga Dr.Albano Zhapaj (gazeta Standard

14 prill 2016); apo “*Kryeministri rrezikon bosnjëzimin e Shqipërisë*”, me autor Dritan Hilën. (gazeta Koha Jonë, 16 prill 2016)

Sidoqoftë, për të patur një tablo më të plotë të problematikës interesante që doli nga ky debat, duhet thënë se përveç dy grupimeve kryesore që u shprehën në favor apo kundër idesë së përfshirjes së edukatës fetare në arsimin publik, ekziston dhe një tjetër grupim shkrimesh që, në një farë mënyre, qëndrojnë në mes.

Me fjalë të tjera bëhet fjalë për shkrime të cilat edhe pse në parim janë dakord me një ide të tillë, shprehin rezerva e dyshime kur vjen puna për mundësinë e implementimit të saj. Dhe në këtë grupim kemi një sërë emrash të njohur figurash me peshë publike, duke nisur që nga Aurel Plasari, me shkrimin e tij: “*Mendime për historinë e fesë si lëndë mësimore*”, (Panorama, 13 prill 2016), në të cilin ai, pasi shprehet pozitivisht në parim për një nismë të tillë, shtonte: “*Në një shtet laik dhe, sidomos, të themeluar si laik, lënda e historisë së feve nuk ka se përse të mos ketë vendin e vet në programet arsimore.*” Por më tej Aurel Plasari rendit ato që sipas tij përbëjnë, “*vetëm disa prej vështirësive që mund të qesë përpara konceptimi dhe trajtimi i një lënde të tillë në realitetin shqiptar.*”, duke bërë 13 pyetje konkrete me mjaft interes, ndërkohë që paralajmëron për padobinë, në mos problemet që mund të dalin nga huazimi i ndonjë teksti të huaj të përkthyer në shqip. Për shembull, një nga pyetjet që Plasari shtronte është: “*Nuk di të them se si dhe sa do të mund të zinin vend në një lëndë të tillë të historisë së feve idetë e ateizmit: diç nga tiparet e ateizmit shqiptar,*

sidomos atij politik, sigurisht që nuk mund të përjashtohet. Por ajo çfarë ka vlera më shumë është: A do t'i jepet vendi i duhur në një lëndë të tillë lindjes dhe forcimit të ideve laike, mandej parimeve të laicizmit social e politik, të cilat qëndrojnë në themelet e shtetit në të cilin vijojmë të jetojmë edhe sot?"

Rezerva të një karakteri tjetër shpreh në shkrimin e tij Çapajev Gjokutaj: "Modulet për fenë: qasje e vjetruar" (Panorama, 13 prill 2016). Duke mirëkuptuar shqetësimin e qeverisë se të rinjtë "janë të paarmatosur me instrumentet e dijes, për t'u përballur me demagogët, me sharlatanët", që i shtynjë në rrugën e indoktrinimeve fetare ekstreme.", Ç.Gjokutaj vë në dyshim dobinë e futjes në programin mësimor të një lënde si ajo e historisë së feve. Ai gjykon se: "Qasja e qeverisë për të shmangur mundësitë e indoktrinimeve ekstreme fetare duket e vjetruar. Shkolla e sotme, kudo në botë, nuk ka problem informimin. Zhvillimi i masmediave moderne dhe posaçërisht i internetit ka nxjerrë në pah rrezikun që vjen jo nga mungesa e informimit, por nga tepria e tij. Në këto rrethana, shkolla po synon që t'i pajisë të rinjtë me instrumente për seleksionimin dhe përpunimin e informacionit. Të menduarit kritik zë vend të dukshëm ndër këto instrumente. Por të menduarit kritik për punë të fesë, vështirë se vjen nga historia e fesë, e kulturës fetare dhënë në module disaorëshe. Ashtu si për shumë fusha të tjera, edhe për fenë, të menduarit kritik vjen nga relativizimi i të vërtetave, nga ngulitja e parimit poperian se askush nuk ka monopolin e së vërtetës. Të rrimë shtrembër e të flasim drejt, asnjë nga fetë monoteiste, në histori dhe në aktualitet, nuk e pranon relativizimin e të vërtetave,

secila e shpall të vërtetën e vet me burim hyjnor dhe me karakter absolut. Te kjo këmbëngulje për absoluten, për besimin dhe jo për dyshimin, për pranimin dhe jo për diskutimin, zë fill krimbi i intolerancës. Si i tillë ky krimb gjendet në embrionin e çdo feje.” e përfundon autori argumentimin e tij.

Duke qenë në parim dakord me idenë e futjes së historisë së feve në arsimin publik, janë të shumtë autorët që shprehin dyshime për një sërë aspektesh që lidhen sidomos me mënyrën se si ka për t’u venë në jetë një nismë e tillë. Për këtë mjafton të lexosh titujt e disa prej shkrimeve të tyre: Kosta Barjaba: “*Historia e fesë: Një terra incognita?*” (Gazeta Dita, 22 prill 2016); Ndriçim Kulla: “*Një zgjidhje kompromisi për mësimin e fesë në shkolla*” (MAPO, 19 prill 2016); Arjan Galdini “*Feja në shkolla, a jemi gati?*” (Gazeta Shqiptare, 15 prill, 2016), etj, etj.

Duhet thënë se ka dhe një tjetër grupim të cilët, ç’është e vërteta, në shtypin ‘mainstream’ zënë një vend relativisht të vogël, por që bëhen mbizotërues në një sërë blogjesh me orientim fetar. Është fjala për ata që këtij debate i qasen ose nga pozitat e atyre që kërkojnë një rehabilitim të plotë të vendit që zë feja në shoqërinë shqiptare, dhe e shohin këtë si një rast për të ngucur polemikën e tyre me atë që ata e etiketojnë si ‘laicitet’, që në shikimin e një prej atyre që është më aktiv në polemikat e atyre ditëve, Redi Shehu, na qenka kthyer në ‘*një religjion më vete që shërben për të ikur nga religjioni, atëherë funksioni i saj kushtetues bie dhe kthehet pastaj në ideologji imponuese, e cila merret me përcaktimin e thelbit dhe formës së religjioneve duke hyrë në terrene që nuk i takojnë.*” (Redi Shehu, Gazeta Panorama,

“Të mësuarit nga cilësitë e feve” 15 prill 2016).

I njëjti autor, i cili njihet për qëndrimet e tij të afërta me ato të disa qarqeve myslimane, e shtjellon edhe më tej konceptin e tij në një tjetër shkrim: “*Më shumë se pyetja; ‘A cenohet laiciteti në shkollat shqiptare’ unë do bëja pyetjen tjetër; ‘A ndihmon kjo nismë për liritë fetare?’ Si mund të ketë liri fetare në një vend, si e drejtë kushtetuese dhe vlerë universale, nëse nuk kuptohet drejt ‘Tjetri’ dhe ‘e ndryshmja’ ndaj nesh? Meraku më i madh nuk është se a duhet një proces i tillë të ndërmerret, ashtu siç edhe pjesa më e madhe e vendeve perëndimore e kanë bërë, por, shqetësimi real është se si ai do të ndërmerret këtu në Shqipëri nga strukturat tona qeverisëse. Për këtë duhet një transparencë e plotë e procesit dhe një sens bashkëpunimi frutdhënës.*” (Redi Shehu, “Përplasjet vijnë nga mosnjohja”, Gazeta Dita, 13 prill 2016)

Ndërsa Doan Dani, i afërt dhe ai në mjaft prej qëndrimeve të tij me autorin e mësipërm, edhe pse në tërësi e mbështet idenë e futjes së edukatës fetare në shkolla, tregohet mjaft kritik për ato që ai i sheh si arsytet që qëndrojnë mbrapa një nisme të tillë. Në përgjithësi dhe ai tregohet mjaft kritik ndaj të ashtuquajturës ‘laicite’.

“*I gjithë debati buron,*” shkruan autori i shkrimit, Doan Dani, që e prezanton veten si publicist dhe që ashtu si dhe Redi Shehum është mjaft aktiv sidomos në faqet e disa blogjeve, “*nga shfrytëzimi që Rama u bën rregullisht sferave fetare. Arsytet variojnë nga publiciteti, nganjëherë ndërkombëtar, legjitimimi dhe shtrirja e konsensusit përmes retorikës sakrale, zhvendosja e vëmendjes*

kolektive nga probleme serioze – megjithëse në këtë aspekt nuk e konkurron dot mjetin hipnotizues ‘kronikë e zezë’ – joshja e partnerëve ndërkombëtarë të komuniteteve fetare specifike, deri te sipërmarrja e votave. Nuk shpjegohet ndryshe gjithë ky pasion i zbuluar për Xhaminë e Namazgjasë me të ardhur në pushtet, ndërkohë që si kryetar bashkie ishte në pozita krejtësisht të kundërta, të shfaqura publikisht vetëm pak muaj para zgjedhjeve – kur partia tjetër flirtonte për të njëjtat arsye – nga zëra të afërt me Ramën, si Artan Shkreli e Artan Lame, të cilët deri vonë nuk e fshihnin dot antipatinë deri edhe ndaj “siluetës” së Xhamisë së Et’hem Beut (Lame) apo “veshjes” orientale me plumb të Kullës së Sahatit (Shkreli). S’kanë arsye të tjera valëvitja e certifikatës së pagëzimit para një viti e gjysmë, nënvizimi i vazhdueshëm i identifikimit fetar (personal e familjar, pa kursyer as të porsaardhurin Zaho), deklarata e pjesëmarrjes epike në meshën e 4 nëntorit 1990, iftaret, inaugurimet, përmbushja e amaneteve të Baba Reshat Bardhit e deri te ceremonia e fundit e Komunitetit Mysliman Shqiptar.” Më tej po i njëjti autor vazhdon: “ Teksa mes dy bashkësive kryesore të krishtera Rama synon përmbysjen e imazhit të një PS-je me bastione vetëm në jug e qendër, e përkëdhelur nga Greqia dhe e afërt me Kishën ortodokse, duke u prezantuar me besimin fetar si asnjë homolog i mëparshëm i këtij rangu (deri në OKB është marrë vesh drejtpërdrejtë), në ceremonitë e bashkësisë myslimane ai mban leksione, frymëzohet për zgjidhje problemesh globale dhe lokale, hap e mbyll ixhtihadin, shqetësohet edhe për Bibliotekën e Mosulit, ndërsa disa nga ato të vendit të tij janë në kushte tragjike. Një autoritet i

tillë politik mund t'i gërrryejë parimet bazike të laicitetit. Kësisoj, në fushën e arsimit, laiciteti mund të rrezikohet jo aq nga hyrja e fesë në shkollë sesa nga ndërhyrja e shtetit në kodifikimin e fesë që më pas do t'i transmetohet nxënësve. S'bëhet fjalë për metodë e kuadro, por për përmbajtje e kontroll. E tepërt të thuhet se ky debat i ka fillesat në interesa konsensusi (elektoral), çka dëshmon se edukimi është shqetësimi më i fundit.” (Doan Dani, Gazeta Mapo, 18 prill 2016)

Një të njëjtën linjë është përgjithësisht dhe Alfred Lela, në shkrimin e tij “Feja që na propozon kryeministri dhe ‘shqiptaria e së majtës” (MAPO, 16 prill 2016), merret kryesisht me ato që ai i quan “arsyet e vërteta politike të një nisme të tillë,” të cilën ai e konsideron “...si një ekzigjencë elektorale e kryeministrit Rama, e cila do t'i mundësonte atij një ngrohje me qarqet konservatore e fetare, të cilat nuk e kanë pasur ndonjëherë me sy të mirë.” Ndërkohë, Alfred Lela ç'është e vërteta, s'e ka thjeshtë me kryeministrin; goditja e tij kryesore është kundër intelektualëve të së majtës që sipas tij, janë kundër futjes së mësimin të fesë në shkolla: “Nëse bëni një listë të kundërshtarëve të futjes së mësimin të njohurive fetare në shkolla,” shkruan ai. “do të gjeni se janë të së majtës. Fakti që i kundërvihen idesë së një Kryeministri nominalisht të tillë, nuk përbën paradoks: Ata janë gati të ndërrojnë luajalitetet politike kur u cenohet dogma ideologjike. Kjo dogmë, e fshehur mirë pas formulimeve të laikes, sekulares, shkencore, racionales, si Hirushja pas një këmbë të vogël e të varfër, është në luftë me traditën.” Sipas Lelës, ata janë njerëz që “shkojnë e vijnë nga qarqe, qofshin akademike, mediatike e të

*tjera, që i përkasin një shkolle të majtë të mendimit dhe qëndrimit.
E cila dallohet nga ateizmi, më shumë se nga laicizmi, një lloj
qëndrimi akut dhe asket që ende e sheh fenë si ‘zakon prapanik’
apo ‘opium për popullin’”.*

BASHKËJETESA FETARE DHE RREZIKU I RADIKALIZMIT/ XHIHADIZMIT ISLAMIK

Vendin kryesor për nga numri i shkrimeve të botuara gjatë kësaj periudhe me temë fenë, e zënë padyshim ata për radikalizmin fetar dhe terrorizmin dhe xhihadizmin islamik. Gjatë kërkimeve (sado që jo të plota) që u kryen për të hartuar këtë studim, u regjistruan 328 shkrime të botuara që lidheshin me këto tema, numër ky që padyshim do të kishte qenë shumë më i madh nëse në këtë vëzhgim do të qe përfshirë media elektronike (televizionet dhe radiot), e aq më shumë ajo sociale.

Kjo rritje e ndjeshme krahasuar me tre a katër vjet më parë kur u krye një studim i ngjashëm, e shkrimeve që kanë për temë radikalizmin fetar islamik, natyrisht që ka shpjegimet e veta:

Së pari, ajo lidhet me faktin që në planin ndërkombëtar gjatë vitit 2016 patëm një vëmendje të shtuar ndaj dukurisë së radikalizmit fetar e terrorizmit me orientim islamik, si rezultat i shtimit të ndjeshëm të akteve terroriste që goditën një sërë vendesh të Europës dhe të Lindjes së Afërt. Aktet e përgjakshme terroriste të kryera në Paris, në Bruksel, apo në Stamboll, ndikuan

ndjeshëm në krijimin e një ndjenje pasigurie në opinionin e gjerë publik. Një ndjenjë pasigurie kjo për të cilën ndikoi jo pak dhe ajo që po ndodhte në Irak e në Siri, e frika prej implikimeve afatgjata që prania e shtetit islamik (ISIS – Daesh) dukej se do të kishte për gjendjen e sigurisë në Europë.

Kuptohet që kjo vëmendje e shtuar e medias ndërkombëtare ndaj këtyre dukurive pati pasqyrimin e vet dhe në median shqiptare.

Një faktor me rëndësi që solli po ashtu një shtim të vëmendjes së opinionit publik shqiptar ndaj kësaj teme, që padyshim dhe shfaqja e një radikalizmi islamik me prirje xhihadiste në trojet shqiptare, çka e dëshmoi para së gjithash prania e luftëtarëve xhihadistë shqiptarë në radhët e ISIS-it apo të organizatës tjetër ekstremiste, Al Nusra, në Siri. Këtu është ndoshta me vend të kujtojmë se deri pak kohë më parë, pjesa më e madhe e shqiptarëve dukeshin të bindur se në një farë mënyre shqiptarët qenë të imunizuar prej dukurive të tilla siç janë radikalizmi militant fetar, xhihadizmi e terrorizmi. Zbulimi se s’paskësh qenë kështu, dhe që për më tepër, qenë jo të paktë ata shqiptarë nga Shqipëria, e edhe më të shumë ata nga Kosova, që kishin shkuar të luftonin me mijëra kilometra larg në emër të një islami radikal në radhët e luftëtarëve të shtetit islamik, duket se e kapi opinionin publik shqiptar të papërgatitur. Në këto kushte është e natyrshme që opinion i gjerë publik do kërkonte të mësonte diç më shumë, e të kuptonte se ç’po ndodhte.

Duhet thënë, po ashtu, se një ndikim jo të vogël në këtë drejtim ka luajtur padyshim dhe vëmendja e madhe që media

e agjencitë kryesore ndërkombëtare të lajmeve i kushtuan gjatë kësaj periudhe temës së luftëtarëve xhihadistë shqiptarë në radhët e shtetit islamik në Siri.

Një faktor i tretë i cili, në një farë mënyre është i lidhur drejtpërdrejt me ato që u thanë më sipër, që ndikoi dukshëm për të rritur vëmendjen dhe mbulimin mediatik të kësaj teme, që padyshim interesi i madh që ngjalli arrestimi dhe më pas, gjyqi që u zhvillua ndaj një numri personash, kryesisht imamë që drejtonin një sërë xhamish jashtë kontrollit të Komunitetit Musliman, të cilët akuzoheshin për nxitjen e radikalizmit fetar islamik, të urrejtjes fetare, si dhe për rekrutimin e xhihadistëve shqiptarë të dërguar për të luftuar në radhët e ISIS-it, në Siri. Bëhej fjalë për gjyqin e parë të këtij lloji në Shqipëri, gjë që natyrshëm tërhoqi vëmendjen e opinionit të gjerë publik.

* * *

Siç mund të merret me mend, një pjesë e madhe e shkrimeve që lidhen me këtë temë kanë një karakter thjeshtë informues. Për arsye të kuptueshme, në analizën tonë s' do merremi me këtë grup, duke u përqendruar para së gjithash në shkrimet problemore, të cilët të lejojnë të krijosh një ide më të plotë të mënyrës se si shtypi shqiptar e percepton dhe i është qasur problematikës që lidhet me çështjen e radikalizmit dhe të terrorizmit islamik.

Po ashtu, një vëmendje e veçantë në analizën tonë i është kushtuar një sërë shkrimesh nga media ndërkombëtare të cilët trajtojnë temën e radikalizmit fetar ndër shqiptarët. Bëhet fjalë për

shkrime të cilët janë të botuara të përkthyer në shtypin shqiptar. Arsyeja përse këto shkrime janë përfshirë në këtë vëzhgim lidhet me ndikimin që shkrime të tilla zakonisht kanë në krijimin e perceptimeve të opinionit publik, si dhe në debatet e zhvilluara gjatë kësaj periudhe lidhur me këtë çështje.

Duhet thënë se pjesa më e madhe të shkrimeve të përkthyer që janë botuar gjatë periudhës së marrë në shqyrtim në shtypin shqiptar, me temë radikalizmin dhe terrorizmin me orientim islamik, kanë po ashtu thjeshtë një karakter informativ për akte të ndryshme terroriste në botë, apo për luftën që po zhvillohet kundër shtetit Islamik në Siri e në Irak. Një pjesë e tyre janë pjesë e debatit të ndezur që po zhvillohet aktualisht në botë për rrezikun e shtuar të terrorizmit, faktorët që ushqejnë radikalizmin islamik, mënyrën se si ai mund të luftohet, e më në përgjithësi akoma, për vetë krizën identitare që po përjeton sot një pjesë e madhe e shoqërive multifetare e multikulturore në Perëndim.

Në këtë studim ne jemi ndalur vetëm në ato shkrime të përkthyer të botuara në shqip, të cilët kanë në qendër të tyre radikalizmin fetar islamik shqiptar, e në mënyrë të veçantë, xhihadistët shqiptarë që luftojnë në Siri, në emër të Islamit në radhët e ISIS-it.

Por, s'ka dyshim se vëmendjen më të madhe në këtë studim ia kemi kushtuar debateve që janë zhvilluar në shtypin shqiptar gjatë periudhës së marrë në shqyrtim, lidhur me çështjen e radikalizmit fetar e problematikën që lidhet me këtë dukuri të dalë në sipërfaqe vetëm tani vonë.

* * *

Sidoqoftë, vështrimin tonë do ta fillojmë pikërisht me disa prej shkrimeve të përkthyer që janë botuar në shtypin shqiptar gjatë kësaj periudhe, të cilët kanë si temë radikalizmin fetar islamik të shfaqur së fundmi në Shqipëri e në Kosovë.

Arsyeja përse po e nisim me këtë grup lidhet jo thjeshtë e vetëm me ndikimin që zakonisht shkrime të tilla kanë në krijimin e opinioneve, por dhe se, duke qenë se pas tyre qëndrojnë organe të mirënjohura të shtypit ndërkombëtar, ato duhen konsideruar si pjesë e natyrshme e debatit më të gjerë që zhvillohet në hapësirën publike.

Le ta fillojmë me një reportazh të gjatë që gazeta e mirënjohur amerikane ‘*Washington Post*’ i kushtonte dukurisë së radikalizmit islamik në Shqipëri. Reportazhi i *Washington Post*-it në shtypin shqiptar u botua me titullin: “*REPORTAZHI/ Shqipëria – anëtare e NATO-s – në hall me rekrutuesit e ISIS-it (dhe rritja e numrit të xhamive vahabiste)*” (gazeta Tema/Republika, 16 janar 2016).

Reportazhin e saj *Washington Post*-i e niste me një intervistë me Bujar Hysën, “*imami i burgosur, një prej tre imamëve dhe gjashtë personave të tjerë të dënuar muajin e kaluar me më shumë se tetëmbëdhjetë vjet burgim për inkurajimin e shqiptarëve të rinj për t’iu bashkuar xhihadit të dhunshëm.*”, siç cilësohet ai në reportazh.

Janë “*Më shumë se 100 shqiptarë që kanë udhëtuar drejt*

Lindjes së Mesme për t'iu bashkuar radhëve të grupit terrorist,” sqaronte autori i reportazhit, “dhe disa prej tyre kanë rënë në sy, duke përdorur thirrjet në internet për bashkatdhetarët e tyre. Thirrja e tyre për t'iu bashkuar militantëve ultrakonservatorë ka hasur në përkrahjen e disa xhamive, që kanë nisur të ndërtohen viteve të fundit nga organizata bamirëse islamike dhe misione fetare nga Turqia dhe rajoni i Gjirit Persik.”

Pasi shpjegonte se si, “Qysh në fillim të viteve të nëntëdhjeta, organizatat bamirëse islamike, disa prej të cilave prapa vetes kishin mbështetjen e mbretërive të kamura të Gjirit, u vërsulën në Tiranë për të nisur ndërtimin e xhamive dhe medreseve. Ndërsa që studentëve më të dalluar u ishin ofruar bursa për studimin e teologjisë nën tutelën e imamëve fundamentalistë në Arabinë Saudite dhe Turqi.”, gazetari i Washington Post-it kujtonte se si gjatë dekadës së fundit, “nëpër qytetet e mëdha shqiptare janë ndërtuar shumë xhami të mëdha që nuk ishin nën ombrellën e Bashkësisë Islame Shqiptare, organizata që është autoriteti ligjor në krye të besimtarëve myslimanë të vendit... duke rritur shkallën e qasjes sektare në një shoqëri për të cilën shqiptarët thonë se ka qenë gjithnjë tolerante.”

Reportazhi nuk lë pa përmendur as xhaminë e madhe që është duke u ndërtuar në qendër të Tiranës: “Sot një prej projekteve më të mëdha të ndërtimit në Tiranë,” thuhet në të. “është një xhami e madhe prej 34 milionë dollarësh amerikanë, fond që më së shumti është mbuluar prej Qeverisë turke. Megjithëse zyrtarët nuk kanë kundërshtim për fondet shtetërore turke, ka prej tyre që privatisht thonë se nuk po u pëlqen ndikimi i turqve.”

Duke iu kthyer sërish gjyqit që po zhvillohej aso kohe në Tiranë, reportazhi përfundonte duke treguar se si: *“Procesi gjyqësor ndaj imamëve u shndërrua në sensación publik, meqë të akuzuarit kishin fyer gjykatësit dhe akuzuar prokurorin se ishte shndërruar në kukull të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Megjithatë, zyrtarët shqiptarë, të ndjeshëm ndaj akuzave për shkak të së kaluarës së tmerrshme kundër feve në kohën e komunizmit, kanë lejuar të akuzuarit që të nxjerrin dufin nëpërmjet intervistave të pacensuara për gazetaret.”*

Në të njëjtën linjë me reportazhin e mësipërm është dhe një shkrim tjetër që po e njëjta gazetë amerikane botoi me titullin: *“Shteti Islamik” po infiltrohet që të destabilizojë Ballkanin*” (Gazeta Tema, 29.12. 2015), ku siç kuptohet dhe nga vetë titulli, jepet një tablo më e gjerë e kësaj dukurie në mbarë Ballkanin Perëndimor.

Po ashtu, në këtë kontekst vlen të përmendet dhe një reportazh i televizionit CNN, me titull: *“Shqipëria, një vend mysliman që e do Amerikën”*, i cili kishte për autore gazetaren Frida Ghitis (shih gazeta Tema online, 31 Mars, 2016). Në këtë reportazh Shqipëria paraqitet si një vend model porsa i përket bashkëjetesës fetare, dhe njëkohësisht, një prej vendeve më pro-amerikane në botë.

Mjaft aktive në mbulimin e kësaj teme gjatë kësaj periudhe ka qenë dhe shtypi italian, ku gjatë periudhës së shqyrtuar janë botuar një numër i madhe shkrimesh që ngrinin shqetësimin prej të ashtuquajturve ‘xhihadistë shqiptarë’, e rrezikun që këta mund të përbënin për Italinë.

Kështu, për shembull, gazeta *‘La Stampa’* e titullonte shkrimin

e saj të gjatë: *“Propagandë e rekrutim. Shqipëria udhëkryq i xhihadistëve”*. (Shkrimi u botua në shqip me titullin: *“Shërbimet sekrete ndërkombëtare në alarm nga xhihadistët shqiptarë: Kanë postet më të larta në ushtrinë e ISIS”* (Ora News/Gazeta Shqiptare, Tema 02/01/2016).

Shkrimi i gazetës ‘La Stampa-s’ ka për autor Lorenzo Vidinon, korrespondent i kësaj gazete në Washington, dhe ka në qendër të tij atë që, sipas autorit, përbën *“shqetësimin e shërbimeve sekrete antiterroriste europiane, amerikane e të Lindjes së Mesme mbi rritjen e numrit të xhihadistëve shqiptarë që rekrutojnë luftëtarë të rinj të ISIS në komunitetin e diasporës shqiptare në Europë, përfshirë dhe Italinë.”*

Sipas këtij shkrimi të gazetës italiane, *“Kosova ka numrin më të lartë në Europë të luftëtarëve xhihadistë në Siri në raport me numrin e popullsisë dhe xhihadistët me etni shqiptare zënë postet më të larta në forcat ushtarake të Kalifatit të Bagdadit... Megjithëse jug-perëndimi i Ballkanit ka qenë gjithmonë një territor i islamit të moderuar e laik, ky problem ka lindur pas viteve ‘90”*, kujton autori i shkrimit.

Pasi shpjegon se zanafilla e kësaj dukurie shqetësues duhet kërkuar në fillim të viteve nëntëdhjetë, me praninë e një morie organizatash nga vendet e Gjirit dhe nga Turqia, autori ndalet te lufta e ndërmarrë kundër kësaj dukurie nga ana e autoriteteve lokale. Sipas autorit, *“Shqipëria është shumë më efiçase në këtë drejtim se sa Kosova dhe Maqedonia.”*

Natyrshëm që një pjesë e mirë e këtij shkrimi të gjatë merret me implikimet që shfaqja e një dukurie e tillë në brigjet lindore të

Adriatikut mund të ketë në Itali: “Hysa,” shkruan autori, “kishte lidhje të forta me Italinë, e pista ballkanike mbërrin drejtpërdrejtë në shtëpinë tonë. Shërbimet antiterroriste italiane në ambientet fundamentaliste ballkanike të vetëdijshëm për rrezikshmërinë e tyre, deri në atë pikë sa kanë frikë se Shqipëria mund të shndërrohet në atë që sot Belgjika është për Francën, prapavija logjistike nga ku planifikohen sulme.”

Sidoqoftë, autori e mbyll shkrimin e tij me një notë pozitive. “Islami “made in Albania”,” shkruan ai, “mbetet një model tolerance. Pavarësisht se 20 vjet propagandë ekstremiste kanë tërhequr një pjesë të myslimanëve shqiptarë si në Ballkan e në diasporë, duke gjeneruar një burim të ri rreziku për Italinë.”

Lidhur me mbulimin nga ana e shtypit italian të kësaj teme, shih dhe shkrimin: “Fantazitë e mediave italiane mbi rrezikun e ISIS-it në Shqipëri” (Observer, Lavdrim Lito, 9 janar 2016), ku autori në një mënyrë disi konfuzë, reagon ndaj dy artikujve të botuar nga gazetatat ‘La Stampa’ dhe ‘Il Giornale’ për të ashtuquajturin rrezik xhihadist që vjen nga Shqipëria.

Me interes të veçantë për informacionin që sjellin janë dhe dy shkrime të marra nga shtypi ndërkombëtar, të cilët kanë në qendër të tyre Kosovën dhe shqetësimin për rritjen e ndikimit të radikalizmit islamik aty.

I pari ndër ta titullohet: “A po rrëshqet Kosova drejt radikalizmit fetar?”. Bëhet fjalë për një vëzhgim të kryer nga radioja gjermane Dojçe Velle, të transmetuar në datën 7 korrik 2016 (botuar nga gazeta Tema në po atë datë).

Nga ç’del nga analiza e radios së njohur gjermane, ndryshe nga ç’ndodh në shoqërinë shqiptare, ku gjithsesi radikalizmi fetar islamik vazhdon të mbetet një dukuri përgjithësisht marginale, ndërkohë që shoqëria në tërësinë e saj vazhdon të karakterizohet nga bashkëjetesa e toleranca fetare, në Kosovë me sa duket problemi është bërë mjaft më shqetësues. Sipas radios Dojçe Veles, në një sërë segmentesh të besimtarëve muslimanë në Kosovë janë shfaqur *“forma të radikalizuar... Për rrjedhojë islami nuk duket që është në formën e tij ashtu siç është predikuar me shekuj me të cilin një pjesë e popullsisë është mburrur dhe e ka përqafuar atë – si besim dhe si kulturë... ndërkohë që në Kosovë është ngritur alarmi për siç thuhet “rrëshqitje” i një pjese të popullatës nga civilizimi perëndimor në atë lindor.”*

Emisioni i DW i referohej një studimi të fundit të kryer prej Institutit për Hartimin e Politikave (KIPRED), në Prishtinë, sipas të cilit në Kosovë është duke u rritur numri i atyre që e identifikojnë veten në radhë të parë me religjionin para përkatësisë së tyre kombëtare.

“57 përqind e shqiptarëve myslimanë e ndiejnë veten shqiptarë së pari pastaj myslimanë. 32 % e ndiejnë veten së pari myslimanë e pastaj shqiptarë dhe kjo është ajo zhvendosja shumë e madhe, ku identiteti shqiptar shndërrohet në identitet linguistik dhe është ai drejtimi që po e merr drejt për këtë pjesë të shoqërisë, si një shoqëri religjioze – etnike, në vend që të ishte etnike dhe pastaj me elemente fetare qysh kanë qenë përpara shqiptarët”, sipas drejtorit të Institutit (KIPRED), Lulzim Peci.

Gjithmonë sipas tij, *“Nëse ky trend vazhdon me këtë ritëm,*

atëherë ka rrezik që të shënohet “përfundimi i shqiptarisë”, ashtu siç e njohim ne dhe me të së bashku edhe fundi i Kosovës sekulare dhe pro-perëndimore.”

Analiza e radios gjermane citonte dhe sociologun kosovar Smajl Hasani, sipas të cilit, *“Dalja në skenë e grupit terrorist ISIS, ka nxjerrë në pah sfidat e Kosovës”*. Sipas tij, *“reagimi i institucioneve të Kosovës pas shfaqjes së radikalizmit fetar ishte i vonuar... Ky nuk është islami me të cilin popullata jonë është mburrur me shekuj dhe e ka përqaftuar – si besim dhe si kulturë.”* shprehet ai.

Një shqetësim të ngjashëm lidhur me shtimin e radikalizmit fetar në Kosovë, shprehte dhe një radio tjetër e mirënjohur, *“Europa e Lirë”*, ku studiuesi David Phillips, nga Instituti për Studime të Drejtave të Njeriut në Universitetin Columbia, ShBA, shprehte shqetësimin e tij për faktin se numri i radikalistëve islamikë në Kosovë është duke u rritur (*Shih për këtë, Gazeta Express, e enjte, 11 Shkurt 2016*). *“Shumica dërmuese e qytetarëve të Kosovës vazhdojnë të jenë pro-amerikanë dhe pro-perëndimorë,” shkruan Phillips, “por numri i atyre që po radikalizohen është në rritje”*.

Pasi analizon disa prej shkaqeve kryesore që, sipas tij, e ushqejnë këtë dukuri, David Phillips mbërrinte në përfundimin se, *“Për fat të keq ajo lidhja e ngushtë ndërmjet shqiptarëve dhe amerikanëve është zbehur.”* Sipas tij, ajo, *“mund të rivendoset, por duhet të bashkëpunojmë më nga afër, ndërkohë që edhe perspektiva evropiane e Kosovës duhet të fuqizohet.”*

Interesant është dhe vëzhgim tjetër që i njëjti autor bën:

“Autoritetet,” shkruan ai. “na kanë dhënë një numër prej 300 kosovarësh të rreshtuar përkrah Shtetit Islamik... Në fakt, unë mendoj se numri është thelbësisht më i lartë, mbase 1,000 vetë.”

Ndër shkaqet kryesore që sipas radios “Europa e Lirë”, shpjegojnë një dukuri të tillë kaq shqetësuese, është dhe ajo që David Phillips e quan: *“roli shumë tinëzar që Turqia po luan në radikalizimin e vendeve në Ballkanin Perëndimor.”*

“Turqia,“ thotë Phillips. “po eksporton agjendën islamiste të Partisë për Drejtëm dhe Zhvillim [AKP], po shfrytëzon Agjencinë Turke për Zhvillim Ndërkombëtar dhe Bashkëpunim si mekanizëm për të promovuar agjendën e saj ideologjike, për të mbështetur atë që ajo e cilëson si kapituj të vëllazërisë myslimane në botë, duke rindërtuar xhami dhe institucione të tjera islame.”

* * *

Siç u tha dhe në krye të këtij kapitulli, një interes të veçantë gjatë kësaj periudhe ngjalli gjyqi që po zhvillohej ndërkohë në Tiranë, i pari i këtij lloji i zhvilluar ndonjëherë në Shqipëri, kundër personave të akuzuar për nxitje të urrejtjes fetare e rekrutim të luftëtarëve xhihadistë të dërguar për të luftuar në radhët e shtetit islamik në Siri.

Sigurisht që një pjesë e madhe e lajmeve të botuara për të në fakt s’janë veçse pjesë e kronikës, ndaj dhe nuk po ndalemi shumë në ta.

Po mjaftohemi vetëm duke përmendur disa prej titujve të

tyre, thjesht për të kuptuar atmosferën që e shoqëroi këtë gjyq të bujshëm.

“*Gjyqi i xhihadistëve: Genci Balla nuk jam pronë e Ramës, zbatohet ligjet e Kuranit* “ , e titullonte kronikën e vet ‘Gazeta Shqiptare’ (Datë 12.04., 2016). “*Gjyqi i xhihadistëve – po na dënioni për t’i bërë qejfin amerikanëve.*” (19 prill 2016, gazeta Tema); “*Vizitë në shtëpinë e Lavdrim Muhexherit*” (Gazeta Dita, 26 janar 2016); “*Gjyqi i xhihadistëve, kreu i KMSH: Në 2 xhamitë predikohej radikalizëm*” (Gazeta Dita, 8 mars 2016). “*Përgjimet/ Si e urrejnë perëndimin, SHBA dhe liderët shqiptarë, islamikët e burgosur*” (gazeta TemA, 6 Prill, 2016). “*Raporti sekret i SHISH: 89 xhami në Shqipëri janë jashtë kontrollit*” (Balkanweb, 26.11.2016).

Ajo ku ne do të ndalojmë më gjatë në këtë studim janë disa prej shkrimeve problemore që iu kushtuan këtij gjyqi, të cilët kërkojnë të analizojnë dukurinë e radikalizmit e të xhihadizmit islamik, shprehje e të cilit ishin dhe nëntë imamët e dënuar në gjyqin e Tiranës.

Le ta fillojmë këtë vështrim me një shkrim interesant që ka për autor Besnik Mustafajn. Shkrimi titullohet: “*Një vështrim në gjyqin ndaj xhihadistëve*” (gazeta Panorama, 29 janar 2016), dhe ka në qendër të analizës problematikën tepër komplekse të luftës kundër një dukurie të tillë të re me të cilën po përballet aktualisht shoqëria shqiptare .

Sepse për Besnik Mustafajn, fakti që ky përbën “... *procesin e parë të këtij lloji për drejtësinë shqiptare, përbën një sfidë të*

një rëndësie të veçantë, përveç të tjerash edhe profesionale, për gjykatat tona.”

Sipas autorit të shkrimit, “Në strategjinë globale kundër terrorizmit, rrjedhimisht edhe në strategjinë e shtetit tonë, drejtësia është dhe do të jetë njëra nga hallkat kryesore, në mos kryesorja. Gjithë zinxhiri i punës së institucioneve të specializuara për identifikimin e radikalëve të dhunshëm, term ky i përdorur nga Presidenti Obama për të përcaktuar radikalët fetarë të lidhur me ISIS, puna për mbikëqyrjen e tyre dhe për neutralizimin e tyre për t’i përballur me ligjin, rrezikon të dështojë në qoftë se drejtësia nuk është në lartësinë e duhur... drejtësia në këtë rast, dukshëm më shumë se në aspektet e tjera të veprimtarisë së saj, është faktor kyç për mbarëvajtjen e sigurisë sonë kombëtare dhe po ashtu për kontributin e Shqipërisë në luftën globale kundër terrorizmit...”

Autori B. Mustafaj e bën këtë hyrje, pikërisht sepse atë e shqetësojnë një sërë aspektesh të mënyrës se si po zhvillohej ky proces gjyqësor: “Me çfarë kam mësuar nga mediat lidhur me zhvillimet në seancat e panumërta të kryera deri tani,” shkruante ai. “dilet lehtë në përfundimin se nga trupi gjyqësor, si edhe nga prokurori kërkohen doemos aftësi të mëdha profesionale, por edhe guxim i vërtetë njerëzor dhe nerva të hekurta. Të akuzuarit, me sjelljen e tyre në sallën e gjyqit, si edhe me deklaratat e tyre, shfaqen si njerëz vërtet me tru të shpëlarë deri në keqardhje, por ata shfaqen po aq edhe si njerëz dinakë, të cilët e njohin shumë mirë sistemin e drejtësisë së një shteti ligjor, të cilit i janë kundërvënë dhe vazhdojnë t’i kundërvihen publikisht, njohin po

aq mirë kodin penal dhe kodin e procedurës penale dhe i përdorin me mjeshtëri të madhe këto njohuri me qëllimin e vetëm dhe të qartë për ta zvarritur procesin deri në dështim... Në mënyrë të përsëritur, të akuzuarit kanë deklaruar se nuk e njohin këtë gjykatë, sepse nuk njohin as vetë shtetin e Republikës së Shqipërisë, që do të thotë se nuk njohin as Kushtetutën tonë dhe të gjitha ligjet që rrjedhin prej saj... ata do të ishin të gatshëm t'i nënshtroheshin vetëm një gjykate të shtetit islamik, të mbështetur mbi sheriatin... Deklaratat e tyre ata i shoqërojnë vazhdimisht edhe me veprime, që përmbajnë të njëjtën logjikë: nuk sjellin avokat dhe refuzojnë me fyerje vulgare dhe me kërcënime avokatin e caktuar kryesisht, fyejnë dhe kërcënojnë hapur dhe shumë rëndë trupin gjykues dhe prokurorinë, ... nuk respektojnë asnjë nga rregullat e solemnitetit të parashikuara me ligj për zhvillimin e një seance gjyqësore... e kështu me radhë. Nga ana tjetër, ata e shfrytëzojnë deri në fund rastin për të bërë vend e pa vend deklarata dhe akuza politike bombastike.”

Besnik Mustafaj e ka të qartë se për të akuzuarit objektivi është që nëpërmjet medias, ti drejtoheshin opinionit publik. Siç deklaronte një prej të pandehurve: “*Sa më shumë që ne rrimë këtu, aq më shumë shtohen përkrahësit tanë jashtë*”. Duke analizuar këtë pohim të të pandehurit që, sipas Besnik Mustafajt, “... nuk është bërë as nga budallallëku e as nga humbja e kontrollit të vetes nga ana e të pandehurit. Përkundrazi. Ai është bërë kthjelltësisht për t’u përcjellë nëpërmjet mediave të pranishme jashtë mureve të sallës së gjyqit, atje ku janë me veshët ngrehur mbështetësit e tyre të njohur apo edhe ende të panjohur nga

agjencitë e shtetit, të specializuara për të gjurmuar e mbajtur nën mbikëqyrje kontingjentet e prekura nga sindroma e fanatizmit fetar të dhunshëm. Të pandehurit po vazhdojnë me vendosmëri të plotë planin e tyre për t'u shndërruar në viktime, thënë me fjalët e tyre: në martirë të një "kryqëzate perëndimore kundër Islamit". Ata myslimanë që e kanë lexuar me sinqeritet librin e shenjtë të Kuranit, e dallojnë lehtë se në fjalët e as në sjelljet e këtyre të pandehurve nuk ka asnjë shenjë të porosive të Profetit Muhamet." vazhdonte Besnik Mustafaj. "Sipas teatrit të tyre të realizuar ditë pas dite me një vullnet shumë të madh, ata duhet të kthehen nga të akuzuar në akuzues dhe procesi i tyre nga një gjyq penal në një gjyq politik."

Për Besnik Mustafajn nuk ekziston kurrfarë dyshimi se : "Me qëndrimin e tyre, ata synojnë të frymëzojnë individë apo grupe të caktuara mbështetësish, me të cilët, për arsye të arrestimit, kanë ndërprerë komunikimin e drejtpërdrejtë. I takon trupit gjykues dhe vetëm atij, në përputhje me kompetencat që i jep ligji, t'ua presë edhe këtë vrull agjitativ." Gjë që, sipas tij, "... nuk do të ishte mohim i të drejtës së tyre kushtetuese për fjalën. Sallat e gjyqit nuk janë vende agjitacioni..."

Me shkrimin e tij Besnik Mustafaj tërheq vëmendjen për faktin, "se ky proces përbën gjithashtu shembullin e parë publik se si shteti ligjor është thellësisht i vendosur dhe i aftë t'i ndëshkojë dhe t'i neutralizojë armiqtë e demokracisë, pa ua dhunuar atyre të drejtat që i gëzojnë si të gjithë qytetarët e tjerë përpara ligjit, pavarësisht se ata vetë nuk e njohin këtë ligj." Po ajo çka më shumë rëndësi për autorin është fakti që,

“Ky proces i parë gjyqësor, i cili, sipas shumë gjasave nuk do të jetë i fundit i këtij lloji, duhet të shërbejë si një përvojë e çmuar për të nxjerrë në pah mangësitë që mund të ketë legjislacioni shqiptar në këtë fushë. Unë shpresoj se qeveria, posaçërisht Ministria e Drejtësisë, por edhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë, zyra e Prokurorit të Përgjithshëm, trupa gjyqësore në të gjitha nivelet, Komisioni i ligjeve në Parlament, Policia e Shtetit dhe shërbimet e inteligjencës po e ndjekin procesin me përqendrim të veçantë dhe do të bëjnë analiza të thelluara për të identifikuar pikërisht mangësitë në legjislacion dhe për t'i plotësuar ato pa vonesë. Po ashtu, kjo përvojë duhet të shërbejë edhe për të identifikuar dobësitë në praktikën e gjykimit.” e përfundonte Besnik Mustafaj shkrimin e tij.

Një mendim krejt të kundërt me atë të Besnik Mustafajt për të njëjtën çështje ka gazetari Andi Bushati. Në shkrimin e tij të titulluar: *“Rreziku i gjykimit të islamistëve”* (Lapsi.al. 6 prill 2016), A. Bushati s’ka dyshime se *“Kërkesa e prokurorisë për të dënuar me 152 vjet burg 9 të akuzuarit për rekrutimin e luftëtarëve të xhihadit të linte një shije të keqe... Gjykatat shqiptare,”* shkruante Bushati, *“nuk kanë dënuar në këto përmasa, as masakra vdekjeprurëse si ajo e Gërdecit, apo krime spektakolare politike, që nga 2 prilli i ’91 e deri tek 21 janari i dy dekadave me pas.”*

Madje Andi Bushati shkonte edhe më tej se kaq, kur shkruante se jo vetëm që masat janë të ekzagjeruara, por dhe se *“imamët e vetëshpallur po dënohen përpos akteve të tyre edhe për bindjet e tyre; Se më shumë sesa drejtësia, ndaj tyre po ndiqet politika e të bërit shembull.”*

Sipas Andi Bushatit, “... në pretencën e prokurorisë, në gjuhën e përdorur, vë re pa vështirësi, një gjykim të pastër politik dhe ideologjik.” Pasi e pranon se “ashtu siç del nga dëshmitë, nga vetë pohimet e tyre dhe nga përgjimet të cilave i janë nënshtruar, 9 të akuzuarit nuk janë aspak engjëj”. Dhe se “Një betejë në sipërfaqe juridike ata janë munduar ta kthejnë me të gjitha mjetet në një përballje thelbësisht politike.” Sipas Andi Bushatit: “Ky është kurthi që ata kanë ngritur dhe me sa duket në këtë kurth kanë rënë edhe institucionet tona demokratike.”

Po ashtu, në ndryshim nga ç’shkruante Besnik Mustafaj, Andi Bushati është i indinjuar për faktin që, sipas tij me arsye absurde, trupi gjykues paskësh vendosur të mos lejonte filmimin e seancave, apo dhe që po “Me arsye absurde mediat në mënyrë të denjë për një regjim totalitar, e kanë pasqyruar këtë proces vetëm nga këndvështrimi i njëres anë.”

Andi Bushati e mbyllte shkrimin e tij me pyetjet: “A mund të dënohen ata për bindjen dhe për mendimet e tyre? A duhen shndërruar në shembuj të dënueshmërisë, ngaqë shohin xhihadin si zgjidhje të një bote globale, dhe adhurojnë martirët e rënë në Siri?... A duhen linçuar sepse në vend të kushtetutës sonë ëndërrojnë vendosjen e sherihatit? Në fund të fundit,” pyet ai. “a i duhet bërë padrejtësi se janë të ndryshëm dhe mendojnë në mënyrë të kundërt me ne?”

Në kontekstin e këtij debati, meriton të kujtojmë dhe një shkrim të agjencisë investigative ‘Birn’, me autore Aleksandra Bogdanin. Shkrimi titullohej: “Shqipëria përballet me rrezikun

e 'luftëtarëve xhihadistë në hije', apo 'ujqve të vetmuar'" (23 Mars, 2016, TemA Online). Në të analizohet situata e xhamive jashtë kontrollit të Komunitetit musliman Shqiptar dhe që akuzohen për propagandë të dhunshme xhihadiste dhe për rekrutimin e rreth 70 luftëtarëve xhihadistë shqiptarë që kanë vajtur për të luftuar në Siri.

Sipas shkrimit të agjencisë investigative 'Birn', bëhet fjalë për shtatë xhami të tilla, ndër 811 xhami që janë në Shqipëri, të cilat operojnë jashtë autoritetit të KMSH-së dhe kanë refuzuar udhëheqjen nga imamë të caktuar nga KMSH. Sipas shkrimit, futja e këtyre xhamive nën kontrollin e Komunitetit Mysliman Shqiptar është kthyer në një prioritet kryesor për Shqipërinë. E megjithatë, sipas tij, KMSH-ja ka hasur vështirësi të shumta për të vendosur kontroll mbi të gjitha xhamitë. Sipas shkrimit, *"Xhamitë që mbeten jashtë kontrollit KMSH-së raportohet se i përkasin traditës shumë konservatore Selefi dhe rreth shtatë prej tyre, duke përfshirë edhe xhaminë e Mëzezit, janë lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me promovimin e xhihadit të dhunshëm dhe rekrutimin e luftëtarëve për ISIS-in dhe Al Nusrën."*

Më tej shkrimi trajton çështjen e qasjes ndaj luftëtarëve të kthyer nga Siria. Sipas tij: *"Në fillim të vitit 2014, të paktën 40 luftëtarë shqiptarë ishin kthyer nga Siria, që sipas një dosje të shërbimeve sekrete të parë nga BIRN, besohet se 15 luftëtarë të kthyer në vend përbëjnë një kërcënim akut për sigurinë."*

Sipas analizës së agjencisë 'Birn', *"qeveria e gjeti veten pa një legjislacion për të ndjekur penalisht luftëtarët e ardhshëm xhihadistë, ata që janë kthyer apo ata që akuzohen për radikalizëm fetar, financim dhe mbështetje të ekstremizmit të dhunshëm"*

islamik. Vetëm në shkurt 2014, parlamenti miratoi paketën ligjore që e bënte... pjesëmarrjen në konflikte të armatosura dhe bashkimin në grupe ushtarake në vende të huaja një vepër penale të ndëshkueshme...” Bëhet fjalë për ligjin që i hapi rrugën kontrolleve dhe arrestimeve të kryera në muajin mars 2014, si dhe gjyqit që pasoi ato.

Shkrimi i ‘*Birn*’ shtjellonte gjatë dhe nevojën e parandalimit të radikalizmit islamik dhe të gjetjes së mënyrave për rehabilitimin e luftëtarëve të kthyer nga Siria, për çka, sipas autores, nuk ekziston ende një strategji.

E njëjta agjenci investigative ‘*Birn*’ botoi gjatë kësaj periudhe dhe një shkrim tjetër investigativ për mënyrën e financimit të xhihadistëve shqiptarë që i janë bashkuar radhëve të ISIS-it dhe Al Nusrës në Siri prej vitit 2012 deri në vitin 2014. Shkrimi titullohet : “*Misteri i financimit të xhihadistëve të Shqipërisë*” (Reporter.al, 2 dhjetor 2015). Sipas shkrimit, “*Dokumentat e hetuesisë që BIRN ka siguruar tregojnë se burimi për financimin e 90 shqiptarëve që luftojnë në Siri vazhdon të mbetet një mister.*”

Për më shumë për të njëjtën temë, shih dhe shkrimin: “*Financimi i mistershëm i radiove fetare në Shqipëri, AMA nis hetimet, Salaj: Do hetohen dhe televizionet, dyshime për pastrim parash*” (16 Prill 2016, gazeta Tema).

* * *

Gjatë kësaj periudhe janë jo të pakta shkrimet që trajtojnë situatën që ekziston në gjirin e Komunitetit Musliman të Shqipërisë.

Ndër autorët që tashmë prej vitesh e ka venë në shënjestër të kritikave të tij këtë Komunitet, është dhe Ermir Gjinishi, teolog, por njëkohësisht mjaft aktiv në media për çështjet që kanë lidhen me Islamin. Ndër kontributet e shumta të tij gjatë kësaj periudhe kemi zgjedhur intervistën që ai i ka dhënë gazetarit Ben Andoni, në të cilën Ermir Gjinishi përmbledhtazi shprehte qëndrimin e tij në lidhje me disa nga pikëpyetjet më domethënëse që i bën vetes aktualisht një pjesë e madhe e opinionit publik.

Intervista e Ermir Gjinishit titullohej: *“Gjendja e myslimanëve në Shqipëri, jashtë kontrollit!!!”* (Revista Java, gazeta Tema, 16 nëntor 2016.).

Ndër të tjera E. Gjinishi përpiqet të shpjegojë dhe faktorët që, sipas tij, sollën atë numër jo të vogël të rekrutëve të ISIS-it që kanë dalë nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia. Sipas tij, muslimanët shqiptarë janë të prekur nga doktrina ekstremiste *tek friste*. *“Është e izoluar, e lokalizuar, por prezente.”* thotë ai. Po sipas tij, ky, *“... Është një problem që na përket të gjithëve, sepse realiteti fetar shqiptar në shekuj është një strukturë e qëndrueshme e cila bazohet në bashkëjetesë dhe harmoni, si e tillë na prek të gjithëve pavarësisht zgjedhjeve që kemi në raport me religjionin.”*

“Duhet theksuar” e vazhdonte Ermir Gjinishi arsyetimin e tij, *“se tek ne fenomeni është i lindur nga ligjërimet fetare dhe i huazuar (ekstremizmi) nga eksperiencia fetare të ndryshme jashtë vendit, por gjithsesi mbetet i lokalizuar.”* Sipas tij, *“Ka patur një sërë anomalish në funksionimin e institucioneve të cilat me mosveprimin e tyre krijuan një boshllëk të mjaftueshëm*

për shfaqjen e ekstremizmit.” Një ndër këto anomali ai e sheh te: “Mungesa e kontrollit të territorit (objektet e kultit) nga institucionet përfaqësuese të besimit, Komuniteti Musliman. Ato funksionojnë menjëhierarki të përcaktuar që fillon nga funksionari më i lartë, kryetari, nëpërmjet strukturave përkatëse përcillet deri tek punonjësi më i thjeshtë, që ka për qëllim organizimin, orientimin dhe kontrollin e të gjithë aktivitetit fetar.” Shkruante E. Gjinishi, i cili vazhdonte se: “Asnjëherë këto institucione nuk shfaqën ndonjë shqetësim deri kur rasti i dy xhamive (Unazës dhe Mëzezit) apo arrestimi i imamëve në Kosovë, u bë objekt i institucioneve të sigurisë.”

Sipas Ermir Gjinishit, kemi një ftohje dhe largim të besimtarëve nga institucioni përfaqësues si rezultat i mungesës së autoritetit të tij institucional: *“Në Shqipëri,”* thotë ai. *“KMSH është mjaftuar me deklarata për shtyp pa u marrë me thelbin e problemit për të ofruar zgjidhje nëpërmjet predikimit fetar. Nuk ka trajtime teologjike nëpër objektet e kultit për fenomenin e ekstremizmit si doktrinë, që besimtarët të qartësohen. Ka një mungesë totale të përballjes me fenomenin. Asnjë konferencë, tryezë diskutimi apo dhe simpozium të hapur publik rajonal për të diferencuar hapur dhe qartë besimin islam nga doktrinat me të cilat kamuflohet ekstremizmi e terrorizmi.”* Atë e shqetëson dhe fakti që objektet e kultit janë lejuar të përdoren për interesa politike.

“Nëpër mimbere,” shkruan E. Gjinishi. *“gjatë zgjedhjeve bëhen thirrje të hapura për orientimin e votës së besimtarëve drejt një force politike të caktuar.”*

Ligjërimi fetar abuziv, intolerant, emocional, i pakontrolluar, me qëndrime radikale ekstreme që lancojnë praktika që nuk i përshtaten realitetit, kulturës dhe ambientit shqiptar.

Keqpërdorimi (tek ne) nga politika i aktiviteteve e ceremonive të ndryshme fetare për të sulmuar apo fajësuar politikisht rivalët partiakë mbi moszgjidhjen e problemeve të cilat shqetësojnë besimtarët, përveç shkeljes së parimit të laicitetit, ushqen radikalizëm dhe militantizëm partiak në komunitetin e besimtarëve. Fjalori partiako-politik në ambiente religjioze nxit të ashtuquajturin islamin politik. Tendenca e herëpashershme e inisiativave për një parti fetare muslimane nuk është vetëm një imitacion i huazuar nga jashtë vendit, por dhe një frymëzim nga fjalori religjioz i pa vend që përdor politika si një mënyrë e rivalitetit partiak, një tentativë e cila konsiston në imazhin e partive pro dhe kundër feve apo të një komuniteti të caktuar.”

Sipas Ermir Gjinishit “*Islami politik po shihet si një model i mundshëm...*” Ai tërheq vëmendjen dhe në mangësitë e theksuara, sipas tij, të mënyrës së funksionimit të institucioneve të sigurisë, të cilat, gjithmonë sipas tij, “*vepruan vetëm pasi mediat e huaja raportuan prezencën e luftëtarëve shqiptarë në Siri, ndërkohë që për vite të tëra predikimet e dhunshme, intolerante, ekstreme, radikale, nxitëse të urrejtjes fetare ishin publike madje të dokumentuara edhe në blogje e forume. Parandalimi nuk ndodhi megjithëse ishte krejtësisht i mundshëm.*”

Sipas analizës që bën Ermir Gjinishi: “*Blogjet e forumet në internet janë një burim i madh i keqinterpretimeve e manipulimeve fetare dhe një mënyrë e indoktrinimit e rekrutimit.*

Fenomeni jo vetëm na gjeti të pa përgatitur por me veprime e mosveprime institucionesh përgjegjëse fatkeqësisht i kemi dhënë hapësirën e nevojshme.”

Por fajtorin kryesor për këtë gjendje shqetësuese, *Ermir Gjinishi* bën Komunitetin Musliman Shqiptar, i cili sipas tij, “*nuk gëzon respektin dhe reputacionin e duhur tek besimtarët... Është i mbyllur në selinë e tij, i shkëputur nga problemet reale që shqetësojnë besimtarët. Ineficient në përballjen me fenomenin e ekstremizmit... Politika ka shfrytëzuar negativisht dobësitë e Komunitetit për interesat e saj. Komuniteti duhet të dalë menjëherë nga guaska ku e ka futur veten, i ka të gjitha mundësitë për t’a bërë këtë. Është në të mirën e tij, të besimtarëve dhe të vendit. Boshllëkun e krijuar nëse nuk e rimerr Komuniteti, do t’a uzurpojnë ekstremizmat dhe kjo do na kushtojë të gjithëve. ... Bashkëjetesa fetare në Shqipëri ka modelin e saj, çdo eksperimentim mund ta cenojë.” e përfundon ai arsyetimin e tij.*

Në këtë intervistë të gjatë, E. Gjinishi s’lë pa përmendur dhe marrëdhëniet e klerit musliman me Turqinë dhe vendet e Gjirit.

“Komuniteti musliman nuk mund të ringrihej pa ndihmë nga jashtë, ashtu siç ndodhi dhe me komunitetet e tjera fetare.” shpjegon Gjinishi. Por “Problemi qëndron në mënyrën e bashkëpunimit. Komuniteti Musliman nuk pati hapësira zgjedhjeje, por ishte i detyruar të bashkëpunonte me cilindo që erdhi në Shqipëri. Mungesa e një kornize ligjore shpesh e vuri në vështirësi përfaqësinë e muslimanëve si institucion, megjithatë ai e ruajti identitetin e tij. Vitet e para të demokracisë sollën fondacione fetare e humanitare arabe, turke, europiane etj.

Dominonin ato arabe. Ambienti shqiptar ishte totalisht vakum, dhe këto kishin hapësira plot në aktivitetin e tyre. Sigurisht ardhja e tyre nga vende me tradita fetare të ndryshme nga ne, reflektoi në realitetin tonë. Shfaqja e errymave dhe shkollave fetare ndryshe nga trashëgimia jonë, i dedikohet kësaj periudhe.... Pas ngjarjeve të Shtatorit, roli i tyre u reduktua në minimum. Dalëngadalë vendin e tyre e zunë fondacione të tjera, kryesisht turke. ... Çështja është se ç'raport kanë këto ndryshime me vetë religjiozen. A janë brenda kontureve religjioze apo thjeshtë fasadë. Këtu duhet të jemi të kujdesshëm. Ka një shqetësim ditët e sotme mbi "otomanizimin e Ballkanit". Nuk është një tezë pa gjë. Është normale që shtete të fuqishme si Turqia të shtrijnë influencën e tyre në rajon, por kjo nuk është arsye për të ç'bërë historinë dhe të cënojë identitetin tonë. Prej kohësh në botën fetare ballkanike flitet për influencën e lëvizjes gyleniste apo "Perandorisë Gylen", e njohur ndryshe si "struktura paralele" ... Po t'i referohemi përplasjes së kësaj lëvizje me qeverinë turke, sigurisht kjo duhet të na shqetësojë..."

Ermir Gjinishi e përfundon intervistën e tij për revistën Javën duke thënë se: *"Pa pavarësi fetare nuk ka pavarësi kombëtare."*

Me interes në këtë janë dhe dy shkrime të gazetarit Mero Baze, të titulluar: *"Parisin duhet ta mbrojmë në Tiranë"* (14 Nëntor, 2015, gazeta Tema) dhe *"Terrorizmi dhe pasiguria jonë kombëtare"* (22 Mars, 2016, gazeta TemA). Ndërsa shtron nevojën e hartimit urgjent të një strategjie kombëtare për luftën kundër terrorizmit, Mero Baze është i mendimit se *"Ajo që ne shqiptarët duhet të bëjmë në këtë orë të keqe të historisë, është të mos bëhemi palë me të keqen. Sepse, » shton Baze. « Për fatin*

tonë të keq, qindra shtetas shqiptarë nga Shqipëria dhe pak më shumë nga Kosova dhe Maqedonia, janë sot ushtarë të kësaj perandorie të së keqes, dhe po luftojnë dhe flasin shqip në emër të saj. Qindra të rinj nga Shqipëria kanë lënë familjet dhe shpesh dhe kanë marrë si peng fëmijët e tyre atje, dhe kanë prodhuar këtu drama të mëdha. Disa shtetas të Kosovës janë figura kryesore të këtij organizmi të ri famëkeq.»

Mero Baze shqetësohet edhe sepse, sipas tij «*në Shqipëri kjo e keqe po kalon në heshtje.*», ndryshe nga ç'ndodh, gjithmonë sipas tij, në Kosovë, ku jo vetëm që “*ekziston një debat i hapur publik kundër tyre, Por dhe qeveria ka vepruar me vendosmëri kundër një grupi hoxhallarësh që janë kthyer në ambasadorë të ISIS, ndërsa shtypi ka pasur raporte serioze hulumtuese, për lidhjet e tyre politike dhe financiare në Kosovë dhe në ISIS. Mes tyre kanë qenë mbresëlënëse disa raporte të thella të gazetës “Zëri” dhe reporterëve të saj, të cilat kanë vënë në rrezik dhe jetën e gazetarëve.*»

Mero Baze është veçanërisht kritik ndaj shtypit në Shqipëri. «*Ne ende nuk kemi bërë detyrën tonë si gazetarë,*” shkruan ai. ‘*për t’i shkuar deri në rrënjë këtij problemi, që po mbin si kërpudhë helmuese në këtë vend, dhe që mund të na kushtojë shpërbërjen e kombit tonë...*’ shkruan ai.

Gjithnjë sipas Mero Bazes: “*Të gjithë ata që tentojnë ta relativizojnë këtë rrezik, të bëjnë interesantin, duke theksuar gabimet e perëndimit, të bëjnë paralele pa lidhje mes akteve terroriste mes fraksioneve terroriste mes Bejrutit apo Damaskut dhe asaj që ndodhi në Paris, apo të tjerë që pafuqinë apo apatinë*

e tyre ndaj qeverive të korruptuara në rajon, bëjnë sikur ua mbush terrori i ISIS, janë realisht aleatët e rrezikshëm të kësaj ideologjie. Shteti shqiptar duhet të tregojë dhëmbët duke forcuar legjislacionin e tij, duke pasur parasysh rrezikun e islamit politik, i cili duhet të ndëshkohet si fashizmi, me një kuadër ligjor që të ndalojë dhe propagandën fetare të tyre... Shteti shqiptar duhet të marrë kontrollin e rreptë ligjor, mbi çdo tekst apo libër fetar që hyn në Shqipëri dhe duhet ta konsiderojë këtë çështje të sigurisë kombëtare. Ashtu siç licenson tekste shkollorë, ashtu duhet të licensojë dhe të kontrollojë në detaje çdo tekst fetar që predikohet në xhamitë tonë. Me të njëjtën përgjegjësi, Komuniteti Mysliman shqiptar duhet të detyrohet me ligj të marrë kontrollin mbi çdo xhami ilegale në Shqipëri dhe të përjashtojë nga hierarkia e vet çdo hoxhë, i cili në vend të Kuranit, bën propagandë për islam politik. Islami politik është armiku ynë kombëtar dhe është një nga ato mekanizma që mund të na zhbëjë si komb, shumë më shpejt se sa mendojmë ne, nëse nuk merret seriozisht. Legjislacioni për ushtarët që largohen si luftëtarë, duhet të forcohet dhe duhet të shtohet logjistika për tërheqjen prej shtetit shqiptar të fëmijëve të marrë peng atje, apo grave dhe familjarëve të tjerë të tyre. “

Mero Baze e përfundon shkrimin e tij me thirrjen që: «Ndaj një ideologjie antidemokratike, terroriste, nuk duhet lejuar të ketë shanse të përdorë standardet tona të lirisë për të na mundur. Ne duhet të përdorim ndaj tyre, kufizimin e të drejtave të tyre, për të qenë shtetas të lirë, për të bërë terror në këtë vend apo diku tjetër, pasi ata nuk mund të përdorin lirinë tonë, për të sjellë mesjetën.”

Për më shumë për të njëjtën temë, shiko dhe shkrimet: “*Terrorizmi dhe lufta kundër kimit*” (27 Nëntor 2016, Gazeta MAPO), me autor Derand Krasniqi; ciklin e shkrimeve në formë eseje të publicistit të njohur kosovar Veton Surroi, me titull “*A ka lidhje islami me dhunën?*” (Gazeta Koha Ditore, 27 Nëntor 2019); si dhe shkrimin: “*Identiteti ynë në rrezik*” me autor Ilir Yzeirin (Gazeta Panorama, 16 Nëntor 2016), sipas të cilit, “*Të dyja elitat politike, si ajo në Kosovë si kjo në Shqipëri kanë hequr dorë nga ringritja kulturore e bashkëkombësve të tyre dhe i kanë dorëzuar ata në sallat e errëta të xhamive ku predikohet xhihad apo në salla të errëta ku ulërijnë këngëtarët banalë të turbofolkut.*” Sipas tij, “*Identiteti ynë kulturor po zhbëhet përditë dhe shqiptarët në të dyja anët e kufirit po u dorëzohen impulseve orientale që kanë qenë fshehur në nënvetëdije. Ndërsa një pjesë e konsiderueshme të rinjsh identifikohet lehtë me islamin radikal duke na rreshtuar ne pa të drejtë me terroristët islamikë të Kalifit.*”

Me mjaft interes, sidomos për të kuptuar atë që po ndodh në Kosovë, është një shkrim i shkrimtarit dhe akademikut kosovar Mehmet Kraja. Shkrimi i tij i gjatë titullohej: “*Letër myslimanëve të Facebook-ut*” (gazeta Koha Ditore, 16 korrik 2016/ gazeta Tema, po atë datë). Ai që shkruar në formën e një bashkëbisedimi imagjinar me ata që, sipas tij, “*pandehin se Kosovën e keni bërë tashmë shtet islamik*”, prej të cilëve Mehmet Kraja kërkonte të vendosin një dialog të qytetëruar për të debatuar mes tyre.

“*Para se t’i bisedoj me ju disa gjëra që më shqetësojnë,*” e nis shkrimin e tij Mehmet Kraja. “*dua t’ju bëj disa pyetje miqësore:*

A ka mundësi të bisedojmë për disa gjëra rreth fesë, ose thënë më mirë rreth përdorimit të fesë në vendin tonë, pa fyerje, pa kërcënime, pa sharje? Pra, a ka mundësi të hapim një dialog të civilizuar, t'i diskutojmë gjërat një për një, sepse më duket se mjaft më jemi fshehur nga njëri-tjetri. Kosova është shumë e vogël, për t'iu krijuar hapësirë përjashtimeve të këtilla. Ju, myslimanët e të gjitha proveniencave, as ju të Facebook-ut, nuk mund të më injoroni, nuk mund të thoni se nuk ekzistoj. Unë jam sekular, nuk jam ateist, më së paku në kuptimin komunist të kësaj fjale: nuk shaj Zotin, nuk e kam sharë fenë e askujt, shprehem me respekt për besimin e secilit.”

Për veten, Mehmet Kraha e sqaron qysh në krye të herës kredon e tij: *“botëkuptim e tij perëndimore... për shoqërinë, për laicitetin e shtetit, për lirinë e fesë dhe të besimit, për ekumenizmin fetar dhe për çdo gjë tjetër që lidhen me këto.”*

M.Kraja është po ashtu i bindur se, *“Si unë besoj se ka edhe shumë të tjerë në Kosovë. Madje, mos t’ju vijë keq nëse ju them se ne përbëjmë shumicën. Vetëm se, duke na bërë të zbrapsemi, të tërhiqemi, të manifestojmë tolerancë dhe indiferentizëm, për të mos e çuar këtë Kosovë të shumëvujtur në armiqësi të reja, për shkak të agresivitetit, për shkak të militantizmit, për shkak të radikalizmit, sekush ka krijuar idenë e gabuar se ju jeni shumicë në këtë vend.”* Por njëkohësisht ai e pranon se, *“... edhe përkundër dijenisë se ne përbëjmë shumicën, nuk mund ta injorojmë faktin se ju, besimtarët myslimanë, ekzistoni dhe se jeni pjesë e rëndësishme e këtij vendi, pavarësisht në jeni myslimanë tradicionalë, të moderuar ose jo, fundamentalistë*

ose jo, vehabistë ose jo, besimtarë të vërtetë apo të manipuluar, predikues të besimit apo propagandues të ideologjisë fetare.”

“Pra, ju jeni dhe ne jemi;” shkruan Mehmet Kraja. “ju ekzistoni dhe ne ekzistojmë. A duhemi? Jo, nuk duhemi. A urrehemi? Them se jo, tani për tani. Por ne duhet të bashkëjetojmë me njëri-tjetrin, sepse ky është atdheu ynë i përbashkët, atdhe tjetër nuk kemi.”

Ajo që e shqetëson më shumë Mehmet Krajën, më shumë dhe se e sotmja, ka të bëjë para së gjithash me të ardhmen e Kosovës: *“Tani, kam një pyetje për të bërë,” shkruan ai. “ e cila kërkon përgjigje të qartë dhe pa ekuivoke; nuk kërkon aq shumë dritë të mendjes, sa gjerësi shpirtërore dhe paqe me njeriun dhe me Zotin: Çfarë do të bëni me Kosovën? Ku do ta çoni atë, në Lindje apo në Perëndim? Këtë ende nuk e keni thënë haptas. Por unë e di, ta zëmë, se çfarë mendoni për historinë dhe duke e ditur çfarë mendoni për historinë, nuk është vështirë të nxirret edhe projekzioni i të ardhmes.”*

Për fat të keq s’është vendi këtu të zgjatemi shumë me këtë shkrim, i cili arrin të përmbledhë më së miri atë që shqetëson shumëkënd sot në Kosovë e jo vetëm, për shfaqjen e një islami radikal e intolerant, i cili sfidon në radhë të parë vetë islamin tradicional që ka ekzistuar aty ndër shekuj.

Duhet thënë se tabloja që vizaton akademiku i njohur kosovar është vërtet mjaft shqetësuese dhe do duhej të shërbente si një këmbanë alarmi për gjithë shqiptarët, sidomos në Kosovë:

“Por nuk mund të mos e pranoj,” shkruan Kraja, “se nga muaji i shkuar (i Ramazanit) mbeti një shije e hidhur, e cila po përsëritet nga viti në vit:” shkruan akademiku kosovar, “

një atmosferë e imponuar fetare, një ambient i degraduar në pikëpamje civilizuese, e cila nuk të lë të zgjedhësh përkatësinë tënde fetare dhe besimin tënd. Ju, myslimanët e Facebook-ut, a keni menduar ndonjëherë, përse njerëzit në Prishtinë, kur vjen iftari, i mbyllin dyqanet të gjithë me radhë, ikin nga rrugët, nga kafenetë dhe tërhiqen mënjanë. Mendoni se të gjithë agjërojnë? Kurrë, në asnjë rrethanë. Ata thjeshtë i nënshtrohen një frike që vjen prej jush, sigurisht më shumë e supozuar dhe shumëfish e ekzagjeruar. A keni menduar, pra, pse njerëzit u dashkan të ndjejnë frikë, pse u dashka të ndihen të terrorizuar, vetëm pse nuk mendojnë si ju dhe nuk ndihen si ju?”

* * *

Dhe tani le të kthehemi sërish në Shqipëri, ku dhe aty, ndonëse situata është e ndryshme nga ajo që përshkruan Mehmet Kraja për në Kosovë, ekziston dhe ana tjetër e medaljes. Ndërsa pjesa më e madhe e shkrimeve të botuara me këtë temë, së paku në shtypin *mainstream*, shpreh shqetësimin për pasojat që mund të ketë në shoqërinë shqiptare ndikimi i një islami radikal, apo qoftë dhe një islami politik, gjen dhe disa shkrime që kanë një shqetësim të kundërt.

Kështu, për shembull, një autor si Fatos Lubonja jo vetëm që nuk është i shqetësuar, por përkundrazi është i mendimit se shoqëria shqiptare ka nevojë për një prani më të madhe të fesë. “*Lubonja: Shqipërisë nuk i vjen rreziku nga Islami, madje këtu*

duhet të rritet ndikimi i feve” (gazeta Tema online, 4 janar 2016).

Po kështu, në shkrimin e tij *“Toleranca në provë: Shqipëria përballë sfidës së radikalizimit”* Vladimir Karaj (10 dhjetor 2016, gazeta Tema), shqetësimin e tij kryesor e ka për rrezikun e rritjes së islamofobisë.

Sidoqoftë, për të kuptuar gamën e gjerë të mendimeve dhe shqetësimeve të këtij grupi shkrimesh, të cilët më shumë se sa në shtypin mainstream i gjen nëpër portalet e shumta, po sjellim vetëm disa shembuj.

Kështu, për shembull, në një shkrim të botuar te gazeta Tema online (20 janar 2016), me titull: *“T’i bëjmë shqiptarët terroristë me zor”*, me autor një imam, Ilir Currin, autori e nis duke akuzuar fillimisht shtypin e huaj, ku ai sheh pothuajse një konspiracion për ta paraqitur Shqipërinë si një bazë të terrorizmit islamik. Në këtë përpjekje, shprehet ai, *‘për kriminalizimin e muslimanëve shqiptarë, demonizimin shqiptarëve’, fajin e kanë vendet fqinjë që kërkojnë të nxinë imazhin e shqiptarëve. Por në të njëjtën kohë autori mendon se “edhe vetë muslimanët shqiptarë po vetëdijësohen se paraqitja e identitetit të tyre islam si i huaj, jo kombëtar, ... nga rrethe letrarësh dhe intelektualësh kameleonë të regjimit monist janë vetëm maja e ajsbergut e përpjekjeve për shkombtarizimin e defetarizimin e tyre. Siç po e kuptojnë se islamofobia në rritje është tregues i fortë se muslimanët s’janë thjeshtë shumicë numerike në trojet shqiptare, por një faktor në zgjim për të përcaktuar kursin e kombit shqiptar...”*

Ndërsa gazetari Fitim Zekthi, në shkrimin e tij *“Njerëzit e fesë dhe përdorimi i turpshëm politik”* (28 Qershor 2016, gazeta

MAPO) shqetësohet për atë që, sipas tij, është përdorimin i njerëzve të fesë nga ana e politikës. Shqetësimi i tij e merr shkasin nga një darkë iftari që shtroi vitin që shkoi kryeministri Edi Rama, i cili për të ishte: *“Një iftar i transmetuar live në të gjitha televizionet, një skenë e ideuar me kujdes që të rrezellijë në ekrane, me ndricim të gjelbër, me pjesëmarrës të zgjedhur, shumica dërrmuese jo agjërues. Fjalimi i kryeministrit, një fjalim politik...”* . Por siç shprehet ai vetë vetëm fare pak më poshtë: *“... ajo që bën qeveria nuk është çështje e këtij shkrimi. ... çështje e këtij shkrimi është ajo që bëjnë njerëzit e fesë, njerëzit e komuniteteve fetare, hoxhallarët, myftinjët në këtë rast, por edhe priftërinjtë apo shërbyes të tjerë në raste të tjera”* Sepse, sipas Zekthit, këta *“... nuk mund të shndërrohen në aktorë të atij teatri...”* Në këtë mënyrë ai mendon se klerikët *“... po sillen si aktorë të teatrit politik.”*

Fitim Zekthi shkon dhe më tej, kur duke shkuar pas në kohë, merret me pjesëmarrjen e katër klerikëve shqiptarë në manifestimin e madh kundër terrorizmit që u zhvillua në Paris, pas aktit terrorist kundër gazetarëve të Charlie Hebdo.

“Më e turpshmja ishte,” shkruan ai. *“ bredhja qesharake në Paris e katërshes së famshme të klerikëve në manifestimin kundër terrorizmit, që kryeministri për t’u shfaqur si përbashkues i madh dhe si lider ideator, i mori si pjesë të delegacionit..”* Zekthi është i mendimit se vetë manifestimin i Parisit s’që gjë tjetër veçse një shfaqje dhe *“gjithashtu edhe dëshmi e paragjyqimit të thellë dhe e islamofobisë.”* Ndërkohë që për të *“... klerikët tanë ishin vetëm një dekor i gjithë këtij teatri të shëmtuar me dirigjent*

kryeministrin.”

Në fakt, iftari i shtruar nga kryeministri Rama që në qendër të kritikave dhe në mjaft shkrime të tjera, me autorë persona të afërt me segmente të caktuara të besimtarëve muslimanë. Kështu, për shembull, mjaft kritik ndaj tij, që një ndër portalet më të njohur zëdhënës të këtij besimi: E-Zani i Nalte. Shih për këtë shkrimin *“Iftari i keqkuptimeve”* (E-Zani i Naltë, 18 korrik 2016).

Edhe më interesant për të kuptuar shqetësimet që kanë ambiente të tilla, le të shohim disi më gjatë një tjetër shkrim të botuar në një portal. Është fjala për shkrimin: “Myslimanët shqiptarë përballë ekstremizmit “laik” E Zani i Naltë, 14 dhjetor 2015), cili fillon me frazën: *“Është bërë e modës që, pas çdo atentati terrorist me justifikim islam në Europë, të vërshojë në mediat shqiptare një valë opinionesh me pretendime mesianike, disa për qytetërimin “tonë” e disa për islamin, athua se ky nuk është pjesë e kulturës shqiptare dhe e pronorit ‘tonë’.* Më tej shkrimi merr me radhë e analizon një sërë shkrimesh të botuara në faqet e shtypit shqiptar, të cilët autori i konsideron si zëdhënës të asaj që ai e konsideron ‘laiciteti ekstrem’ dhe shprehës të një logjike *“paragjykimi, përjashtimi dhe të huajësimi”*.

Dhe së fundi, një tjetër shkrim nga po i njëjti portal, që shpreh kundërshtimin ndaj një prej tezave kryesore mbi të cilën rëndom mbështetet kundërshtimi ndaj asaj që shumëkush i sheh si deformime që po ndodhin si rezultat I ndikimeve të ushtruara nga jashtë gjatë dy dekadave të fundit. Është fjalë për tezën se historikisht ndër besimtarët myslimanë shqiptarë ekziston një

traditë tolerance e bashkëjetesës, të cilën disa e kanë emërtuar si Islami Shqiptar.

Shkrimi i botuar te “E-zani I Naltë, titullohet pikërisht “Islami i padukshëm shqiptar” (19 janar 2016). “Prandaj, na rezulton se islami shqiptar nuk ekziston gjëkund ose, thënë ndryshe, është pozitiv pikërisht sepse nuk ekziston” shkruan autori që mbetet anonim, i cili e mbyll shkrimin e tij polemik me fjalët: *“Në një gjë kanë të drejtë: me sa duket është tolerant, aq sa ndjekësve të tij u ka rënë për hise të tolerojnë revanshin e 5 shekujve, të shprehur pak a shumë haptazi nga çdo cep I trojeve e në çdo mënyrë, në një shoqëri me bregëzime fashiste ku çifuti është “vëllai” i shqiptarit islamit model. Është fatura e të qenurit mysliman shqiptar.”*

* * *

Dhe për ta mbyllur këtë kapitull, le të mos lemë pa përmendur dhe dy shkrime, që ndonëse në një farë mënyre qëndrojnë më vete, cekin dy problem me rëndësi.

I pari ai i Besnik Mustafajt, trajton problemin e pjesëmarrjes së Shqipërisë në Konferencën Islamike, një çështje kjo që, siç dihet, prej vitesh ka qenë në qendër polemikash mjaft të zjarra. Shih për këtë “Anëtarësimi në Konferencën Islamike? Ja çfarë thotë Besnik Mustafaj” (15 Qershor 2016, gazeta Mapo), ku autori, që le ta kujtojmë për disa vjet ka qenë ministër i jashtëm i Shqipërisë, pasi parashton arsyet që, sipas tij, vazhdojnë ta ushqejnë një debat të tillë, del në mbrojtje të pjesëmarrjes së

Shqipërisë në këtë konferencë.

I dyti, me të cilën mbyllet ky kapitull i studimit, është një shkrim në formë eseje, me autor dom Gjergj Metën. Shkrimi titullohet: “*Midis kambanave dhe namazit*” (gazeta Panorama, 24 maj 2016). Ai është shkruar pas atentatit terrorist në Bruksel, një përsiatje për roli e religjionit në shoqëritë moderne, por ç’është më e rëndësishmja, një përgjithësim i asaj që ne rëndom e quajmë bashkëjetesa jonë fetare. Më poshtë po e japim atë thuajse të plotë:

“Më ndodh shpesh që ndërsa nis meshën në Kishën e Shën Luçisë dhe i bie ziles së vogël që lajmëron hyrjen e meshtarit, njëkohësisht nisin e bien kambanat e Kishës ortodokse dhe altoparlantët e dy xhamive të Durrësit thërrasin namazin. Në vijë ajrore dy Kishat ortodokse, dy xhamitë e Durrësit dhe Kisha katolike janë shumë pak metra larg njëra-tjetrës.

Nganjëherë më duket Durrësi si një Jerusalem i vogël bregdetar.”

Aty reflektimi im u bë i thellë. Në ajër takoheshin zëra të ndryshëm, tinguj diku njerëzorë e diku të bërë nga njerëzit, por me një qëllim: t’u kujtojnë njerëzve Zotin! Ndërsa thosha meshën, nisa të reflektoj mbi ambiguitetin që simbolet mbartin në vetvete. Se si kambana e Kishës thërret për gëzim, por thërret edhe për mort.

Njerëzit që të falen, por e dëgjon edhe në gojën e disa terroristëve që duke vlarë, kinse bëjnë vullnetin e Zotit. Fuqia e simboleve është e jashtëzakonshme dhe reflektimi mbi to është

një nevojë. Situata në të cilën gjendet bota për shkak të terrorizmit është një teh shpate nëpër të cilin jemi të detyruar të kalojmë.

Dhuna dhe terrori kanë pasur ngjyrimë të ndryshme në historinë e botës, por gjithmonë kanë dështuar përballë instinktit të mbijetesës dhe të së mirës që gjendet brenda njerëzve e brenda popujve. Kjo gjë hap ndaj shpresës se e keqja do të mundet, por jo automatikisht. Kërkon angazhim.

Dhe në këtë pikë një rol të rëndësishëm kanë edhe religjionet. Ato vazhdojnë akoma të luajnë një rol të rëndësishëm në jetën e botës. Po sot në këtë situatë, cili mund të jetë roli i tyre? Në këtë situatë gjeopolitike, çfarë mund të bëjnë religjionet? Mendoj që zërat dhe tingujt që emëtohen në ajër duhet të zbresin përtokë e të shohin realitetin në të cilin sot jeton bota.

Për këtë është me rëndësi që religjionet të tejkalojnë veten e tyre e të dalin përtej kufijve të vetvetes jo për të vërshuar në fushat e të tjerëve, por për të mësuar prej të tjerëve. Asnjë religjion nuk është i vetëmjaftueshëm pavarësisht se çdo religjion jeton të vërtetën brenda disa bindjeve apo postulateve të veta. Me këtë dua të them se ky takim midis religjioneve nuk duhet të jetë vetëm një përzierje tingujsh në ajrin e qytetit, por një dialog në jetën konkrete të njerëzve.

Religjionet duhet të shkëputen vazhdimisht nga trajtat e tyre historike apo kulturore, duhet të shkojnë përtej atyre trajtave dhe të shohin njeriun konkret, madje çdo njeri, i cili me vetë ekzistencën e tij është një risi absolute në këtë botë. Një religjion që nuk i përgjigjet kësaj risie, apo i përgjigjet asaj me postulate

të vjetra e të ngurta, do të prodhojë vetëm mure dhe ndasi. U takon në mënyrë të veçantë religjioneve që të nxjerrin në pah e të nxisin atë instinkt të së mirës dhe të së bukurës që Zoti ka vendosur në zemrat e njerëzve.

Nëse s'e bën, ka dështuar në vokacionin e tij.

Një problem tjetër i madh është edhe çështja e një marrëdhënieje problematike që kanë religjionet me laicitetin e shteteve ku ato janë. Nuk munden të injorojnë njëri tjetrin e as nuk mund të hyjnë në jetën e njëri-tjetrit.

Por mund të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin për të mirën e përbashkët. Në shumë vende shteti dhe religjioni "shfrytëzojnë" njëri-tjetrin, diku bëhen edhe bashkëfajtorë apo patericat e njëri tjetrit, ose hyjnë në konflikt të pakuptimtë për çështje shumë anësore, ndërkohë që ka fusha të pambarimta bashkëpunimi dhe pune për të mirën e përbashkët.

Ndërkohë që mesha shkante drejt fundit, dhe në atë meshë u lexua episodi i tradhtisë së Judës, mendova përsëri për aktet terroriste në Francë, Turqi, Nigeri, Siri, Irak, Libi, Pakistan e së fundi në Belgjikë. Juda përpara se të tradhtojë Jezusin tradhton vetveten. Ne njerëzit jemi, së pari, tradhtarët e vetvetes dhe çdo akt terrorist është tradhti ndaj një vokacioni zanafillor që secili nga ne ka, ai i dashurisë."

DISKUTIMET PER NDIKIMIN TURK DHE ÇËSHTJA ‘GULENISTE’

Debati për të ashtuquajturin ‘ndikim gulenist’ në Shqipëri nuk është se nisi në korrik të vitit 2016, kur autoritetet turke bënë përgjegjës për grushtin e shtetit të dështuar lëvizjen Guleniste, dhe ndërmorën një fushatë mjaft të ashpër ndëshkuese kundër saj, teksa shtuan ndjeshëm presionin në tërë ato vende ku kjo lëvizje qe e pranishme. Ç’është e vërteta debatet për këtë lëvizje në shtypin shqiptar patën nisur veçanërisht që kur, gjatë vizitës së tij në Shqipëri në muajin maj të vitit 2015, presidenti turk Erdogan u kërkoi autoriteteve shqiptare mbylljen e shkollave të kontrolluara nga kjo lëvizje, që për qeverinë aktuale turke tashmë përbënte armikun numër një. Bëhej fjalë për atë rrjet të gjerë institucionesh arsimore të ngritura prej gati dy dekadash, e që deri atëherë shqiptarët i kishin njohur thjeshtë me emrin ‘shkollat turke’, e për të cilat opinioni publik shqiptar deri atëherë s’kishte patur asnjë informacion se paskëshin lidhje me një lëvizjen të quajtur guleniste.

Madje deri atëherë mund të thuhet se përmendja e kësaj lëvizje, që nga ç’rezulton, ka një shtrirje mjaft të gjerë në

Shqipëri, shumë rrallë kishte ndodhur të përmendej në faqet e shtypit shqiptar.

Pas grushtit të shtetit të dështuar të korrikut 2016, hapësira që zunë në shtypin shqiptar lajmet apo debatet lidhur me këtë lëvizje u shtuan aq shumë, sa që menduam se do të ishte e udhës që kësaj çështjeje t'i kushtohet një kapitull më vete, për vetë rëndësinë e problematikën që ajo ngërthen.

Sidoqoftë, përpara se të japim një pasqyrë të zgjeruar të mënyrës se si shtypi shqiptar e ka mbuluar këtë çështje, e shohim të udhës të bëjmë disa sqarime:

E para, arsyeja përse kësaj çështjeje po i kushtohet një kapitull i veçantë ka të bëjë me faktin se gjatë gjysmës së dytë vitit 2016 diskutimet për të ashtuquajturën 'prani guleniste' në Shqipëri (apo dhe më në përgjithësi, ndër shqiptarët në Kosovë e Maqedoni) zunë një vend mjaft të dukshëm në mbarë shtypin shqiptar. Për më tepër, një pjesë e këtyre debateve lidhet drejtpërdrejt me situatën që ekziston në bashkësitë islame të Shqipërisë e të Kosovës, pra pikërisht me problematikën që ka në qendër të vet ky raport.

E dyta, i gjithë ky diskutim s'mund të kuptohet dot pa mbajtur parasysh një diskutim tjetër mjaft më të gjerë e më kompleks, i cili ka tashmë vite që është pjesë e debateve publike në vend.

Fjala është për të ashtuquajturën qasje neo-otomane të politikës së re turke, e cila tashmë prej disa vitesh është kthyer në një nga debatet kryesore në hapësirën mediatike shqiptare. Ndër të tjera, pjesë e këtij debati ka qenë dhe vendi që zë apo duhet të zërë identiteti fetar në të ashtuquajturin identitetin kombëtar shqiptar.

Siç dihet, në një pjesë të opinionit publik tashmë prej vitesh ekziston dyshimi (e shqetësimi) se Turqia është duke u përpjekur ta përdorë komponentin fetar mysliman, krahas promovimit të trashëgimisë së përbashkët osmane, si instrumente të ndikimit të saj politik në vendet e Ballkanit Perëndimor ku siç dihet, ka një popullsi në shumicë myslimane, me pasoja të mundshme rrafshin politik, gjeopolitik, kulturor e fetar.

E treta, vetë diskutimi për të ashtuquajtur ‘çështje guleniste’ është mjaft më i gjerë, ndërkohë që në këtë raport do mjaftohemi duke shqyrtuar vetëm atë çka lidhet në temën e këtij raporti: pra, me fenë.

Dhe e fundit, siç u theksua dhe në hyrjen e këtij studimi, ndërsa kapitujt e tjerë të tij mbulojnë një periudhë kohore nëntë mujore, pra periudhën janar-shtator 2016, ky kapitull mbulon një periudhë një vjeçare, pra vëzhgimet e kryera për të shtrihen nga janari deri në dhjetor të vitit 2016.

* * *

Siç dihet, në muajin korrik të vitit që shkoi në Turqi pati një tentativë për grusht shteti në të cilën qe e përfshirë një pjesë e ushtrisë turke. Tentativa dështoi. Pasojat e saj qenë jo thjeshtë rreth 300 viktimat që ajo shkaktoi, por sidomos një ashpërsim i skajshëm i situatës politike në vend dhe një fushatë ndëshkuese, e cila nuk përfshiu thjesht ata që dyshoheshin për pjesëmarrje në grushtin e shtetit, por gjithkënd që gjykohej si kundërshtar politik

i regjimit të presidentit Erdogan. Në qendër të kësaj fushate u vu e ashtuquajtura FETO (Lëvizja Gulen- sipas emrit të krijuesit të saj Fejtullah Gulen, i cili prej disa vjetësh jeton në Pensilvani, në SHBA). Pas grushtit të shtetit në Turqi kemi një përndjekje të kujtudo që kishte apo dyshohej se ka patur çfarëdo lloj lidhjeje me këtë lëvizje, e cila dikur qe aleate e afërt me presidentin Erdogan, por që prej disa vitesh konsiderohet prej tij si armikja kryesore, e akuzuar për krijimin e një shteti paralel në Turqi.

Duke qenë se kjo lëvizje qe e shtrirë jo vetëm në Turqi, por e kishte shtrirë veprimtarinë e saj në shumë vende të tjera të botës, së pari nëpërmjet ngritjes së një sistemi të tërë institucionesh arsimore (por jo vetëm), lufta e autoriteteve turke kundër lëvizjes FETO u shtri sakaq dhe jashtë Turqisë, duke kërkuar neutralizimin e asgjësimin e ndikimit të kësaj lëvizjeje kudo që të ndodhej.

Sipas asaj që thonë autoritetet turke, një prej bazave kryesore të kësaj lëvizjeje jashtë Turqisë, qenkësh pikërisht në Ballkanin Perëndimor, në vende si Shqipëria, Kosova, Bosnja apo Maqedonia. Rrjedhimisht, që të nesërmen e dështimit të grushtit të shtetit qeveria turke ndërmori një fushatë këmbëngulëse për neutralizimin e plotë të të gjitha zgjatimeve të lëvizjes FETO, të shpallur prej saj terroriste, në vendet e Ballkanit Perëndimor. Pjesë e saj qenë dhe kërkesat e vazhdueshme e këmbëngulëse në adresë të autoriteteve shqiptare për të mbyllur institucionet e kontrolluara prej kësaj lëvizjeje në Shqipëri, si dhe më në përgjithësi, marrjen e masave kundër ndikimit të saj në Shqipëri. Kërkesa këto që duhet thënë që nuk u mjaftuan thjesht duke ndjekur kanalet e zakonshme të komunikimit ndërmjet shteteve,

por përdorën gjerësisht dhe mjetet e komunikimit masiv, jo thjesht si një mjet presioni, por po ashtu, si një mënyrë sensibilizimi të opinionit publik vendas.

Rrjedhimisht, në shtypin shqiptar të kësaj periudhe (korrik-dhjetor 2016) gjejmë vazhdimisht njoftime që kanë lidhje me lëvizjen Guleniste në Shqipëri, të cilat ose drejtpërdrejt ose nëpërmjet të tretësh, duket që e kishin burimin tek autoritetet zyrtare turke. Kjo duket qartë për shembull, te një shkrim si: “AA: Ja rrjeti i Fetullah Gulen në Shqipëri”, i cili u botua në një pjesë të madhe të shtypit shqiptar, në 26 korrik 2016 (gazeta MAPO). Shkrimi bazohet te një intervistë e ambasadorit të Turqisë në Tiranë, z. Hidajet Bajraktar, dhenë gazetës Shqiptare, ku ai njoftonte se autoritetet turke i kishin kërkuar qeverisë së Edi Ramës të vepronte kundër zgjatimit të asaj që ai e quante, organizata terroriste Feto në Shqipëri. “Ne presim,” theksonte ambasadori turk në intervistën e tij, “që ndaj aktivitetit të institucioneve dhe individëve që kanë lidhje me këtë organizatë, të ndërmerren sa më shpejt masa serioze dhe efektive”.

Njëkohësisht ambasadori komentoi dhe lidhur me një listë me iniciale emrash të njohur përfaqësuesve të politikës, të medias e botës akademike, që sipas shkrimit të botuar vetëm para pak ditësh (pa u njoftuar burime se nga qe marrë) në pjesën më të madhe të shtypit shqiptar, paguheshin prej kësaj lëvizjeje. “Sa i përket asaj që media e ka etiketuar si “lista Gulen”, me mbështetës të Fetyllah Gylen në Tiranë, - thuhej në shkrimin e gazetës Shqiptare që shoqëronte intervistën me ambasadorin turk, ‘ai (ambasadori) nuk jep emra, duke thënë se është një listë

e klasifikuar.”

Ndërkohë, shkrimi i referohet dhe një shkrimi të agjencisë turke të lajmeve Anadolu, sipas të cilit” *“rrjeti i predikuesit Fetyllah Gylen, që akuzohet se ka organizuar grushtin e shtetit në Turqi, është shumë i shtrirë në Shqipëri.”* Në këtë shkrim jepet një informacion i përmbledhur për praninë e kësaj organizate në Shqipëri, që e shohim me interes ta riprodhojmë, për të kuptuar se çfarë nënkuptojnë autoritetet turke kur flasin për shtrirje të kësaj lëvizjeje në Shqipëri.

“Aktiviteti i kësaj organizate,” thuhet në shkrimin e agjencisë Anadolu, *“nisi në vitin 1993 me ngritjen e Fondacionit Gulistan. Në Tiranë ata kanë gjimnazet “Mehmet Akif” dhe “Turgut Ozal”, “Memorial International School of Tirana”, kurse në Shkodër dhe Durrës kanë shkollat fillore “Hasan Riza Pasha” dhe “Turgut Ozal”.*

Po sipas këtij shkrimi: *“Dy universitete të mëdha, Epoka dhe Beder në Tiranë kanë lidhje me FETO, që ka marrë kontrollin e shkollave tradicionale islamike, të njohura si medrese”.*

Sipas Agjencisë Anadolu, *“lëvizja Gyleniste ka privatizuar medresetë në Tiranë, Kavajë, Korçë, Elbasan dhe Berat, duke bërë biznes me këto shkolla, që më përpara ishin pa pagesë.”* Po ashtu, po sipas Agjencisë Anadolu, lidhje me këtë lëvizje, ka edhe institucioni i edukimit Meridian, ashtu si dhe një OJQ, e quajtur Horizontet e Reja. Kurse, *“Librat e Gulen botohen në Shqipëri nga kompania Prizmi.”*

Në ditët menjëherë pas tentativës për grusht shteti, ambasadori turk në Tiranë qe mjaft aktiv në shtypin shqiptar, me një sërë

intervistash në shtypin e shkruar e në disa prej televizioneve kryesore të vendit.

“Ambasadori turk në Tirane: Gjarpri shfaqet përsëri po nuk ia shtype kokën”, e titullonte shkrimin e vet lidhur me këtë gazeta Shekull e datës 27 korrik, në të cilën përsëritej mesazhi se për Turqinë “shkatërrimi e të gjitha zgjatimeve të FETO-s, kësaj strukture terroriste” përbënte një përparësi. Shkrimi mbyllej kështu: “Bajraktar i cilëson si të përkryera marrëdhëniet me Shqipërinë, duke nënvizuar se: “E dimë që institucione të lidhur me FETO-n veprojnë edhe në Shqipëri. Vendi ynë e ka përparësi shkatërrimin e të gjitha zgjatimeve të FETO-s, kësaj strukture terroriste. Marrëdhëniet tona me Shqipërinë janë në nivel të përkryer. Vlera e investimeve tona në Shqipëri është mbi dy miliardë dollarë dhe falë këtyre investimeve janë punësuar rreth 10.000 vetë. Për më tepër marrëdhëniet midis vendeve tona janë të singerta. Në këtë kuadër ne besojmë me gjithë zemër se do të hidhen hapat e duhura.”

Jo shumë kohë më pas i njëjti mesazh erdhi nga vetë Ministri i jashtëm turk, gjatë vizitës së Ministrit Ditmir Bushati në Turqi. *“Çavuşoğlu: FETO ka një strukturim serioz në Shqipëri”,* titullohej njoftimi i gazetës Shqiptare për këtë vizitë, ku ndër të tjera thuhej se *“Çavuşoğlu u shpreh se Organizata Terroriste FETO ka një strukturim serioz në Shqipëri. ... Ai njoftoi se gjatë takimit kanë vlerësuar se çfarë hapash do të ndërmerren dhe se në kuadër të kësaj ka ndarë disa informacione me homologun e tij”*. (Balkanweb, 26 tetor 2016)

Në fakt, siç u tha, është e vërtetë se presioni për të ndërmarrë

masa kundër pranisë ‘guleniste’ në Shqipëri erdhi duke u shtuar ndjeshëm që nga korriku i vitit 2016, por ai që i pranishëm gjatë gjithë periudhës pas vizitës së Presidentit Erdogan në Shqipëri një vit më parë. Kështu, për shembull, që në muajin janar të vitit 2016, në një sërë gazetash shqiptare që botuar përkthimi i një shkrimi të marrë nga shtypi turk, por që qartazi i drejtohej opinionit publik shqiptar.

Shkrimi titullohej: “*Shteti paralel*” i Gylenistëve vihet sërish në lëvizje në Shqipëri” (Gazeta Tema, 28 janar 2016), dhe që botuar fillimisht në turqisht, në gazetën proqeveritare turke *Yeni Akit*, me autorë Ayhan Demir dhe *Yeni Akit*.

Ky shkrim i gjatë, i cili pretendonte të bënte një tablo të pranisë së kësaj organizate në Shqipëri, niste pikërisht duke theksuar se në vështrimin turk prania e kësaj organizate në Shqipëri është më me rëndësi se në cilindo vend tjetër të Ballkanit. “*FETÖ/ PDY (Shkurtim i Organizatës Terroriste Fethullah / Struktura e ‘Shtetit Paralel’, shën.përkth.) vazhdon të ketë ende një strukturës të fuqishme në Ballkan. Maqedonia, Bullgaria dhe Bosnjë-Hercegovina bëjnë pjesë në vendet, ku kjo strukturë është më aktive. Por nuk ka dyshim që në vend të parë qëndron Shqipëria.*” theksonin autorët e shkrimit.

Po sipas të njëjtit shkrim: “*FETÖ/PDY në Shqipëri ka shkelur në vitin 1993, duke u angazhuar fillimisht në sektorin e arsimit. Pastaj u orientua edhe në tregti dhe vazhdon të karakterizohet nga një ekspansion i qëndrueshëm sidomos në sektorët e turizmit, energjisë dhe telekomunikacionit.*” Sipas tij, në fushën e arsimit laik apo fetar, “*Në Shqipëri veprojnë*

shkollat e njohura me emrin Medrese “Liria”, që në Turqi korrespondojnë me shkollat e mesme teologjike “İmam Hatip Lisesi”, të cilat kanë edhe filiale të tyre në qytetet Elbasan, Kavajë, Tiranë, Korçë dhe Berat. Përveç medreseve ka edhe kolegje në qytetet Tiranë, Durrës dhe Shkodër, të cilat janë organizuar në kuadër të Fondacionit Arsimor “Gulistan” dhe Fondacioni Arsimor “Sema”. Kurse shkolla Memorial International School of Tirana (MIST), që është edhe shkolla më e shtrenjtë e vendit, u drejtohet biznesmenëve dhe politikanëve që bëjnë pjesë në shtresën e shoqërisë që kanë të ardhurat më të larta. Nxënësit që vijnë në nivelin universitar, në qoftë se janë në gjendje të mirë ekonomike, orientohen tek Universiteti “Epoka”, nëse jo vazhdojnë studimet e larta pranë Universitetit “Bedër”. Studentët e diplomuar nga këto shkolla në çështjet si martesë apo punësimi orientohen nëpërmjet “Qendrës Kulturore Horizontet e Reja” njofton ky shkrim.

Interesant është fakti se, ndoshta për herë të parë publikisht, në qëndër të sulmit kësaj here që venë vetë Komunitetit Musliman Shqiptar, i cili akuzohet se është krejtësisht në duart e Gulenistëve: “Mjaft me ndikim kjo strukturë,” shkruhej në artikull. “është edhe në Komunitetin Mysliman të Shqipërisë (KMSh).” Sipas tij: “Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë është arsimuar në shkollat e varura nga FETÖ/PDY dhe është një njeri mjaft besnik i kësaj strukture. Ata që nuk janë të kësaj strukture (FETÖ/PDY), nuk i pranon njeri në Komunitetin Mysliman të Shqipërisë.”

Interesant është po ashtu, dhe informacioni që ky shkrim

jepte lidhur me ndërtimin e xhamisë së Madhe në Tiranë. “Punimet për ndërtimin e Xhamisë së Madhe të Tiranës, e cila planifikohet të jetë xhamia më e madhe e Ballkanit dhe që çështja e realizimit të këtij projekti u shndërrua në historinë e “këmbëve të gjarprit”, morën start vitin e kaluar.” shkruante artikulli i gazetës turke, që më tej shkonte se: “Realizimin e projektit e ka marrë përsipër kompania “KOMAŞ AŞ”, e cila është pjesë e Fondacionit të Çështjeve Fetare të Turqisë (Türkiye Diyanet Vakfı). Vetëm se “KOMAŞ AŞ” nuk është aspak e ndjeshme në lidhje me FETÖ/PDY. Kjo kompani vazhdon ende të blejë shërbime nga pjesëtarët e FETÖ/PDY.”

Më tej i njëjti shkrimi sulmonte një portal informativ “Albeu.com”, i cili, sipas tij, “është kthyer në një bazë qendrore të lajmeve kundër Turqisë, duke nxirë emrin e mirë të saj. Njerëzit e FETÖ/PDY-së publikojnë shpesh lajme të mbushura me shpifje dhe përgojime edhe në gazetatat, kanalet televizive, revistat dhe portalet e tjera të lajmeve.”

Në fund, shkrimi mbyllet me një paralajmërim të qartë ndaj pjesëtarëve të FETÖ/PDY-së në Shqipëri. “Por le ti paralajmërojmë edhe një herë. “ paralajmëhej në të. “Ata, që për vite të tëra kanë pasur me vete përkrahjen dhe mbështetjen e Republikës së Turqisë duke pretenduar se kanë qenë një “lëvizje mirësie”, sot tezgën e hapin në “tregun e tradhtisë.”

Po ashtu në shkrim s’është e vështirë të shohësh dhe një paralajmërim në drejtim të vetë drejtuesve të shtetit shqiptar: “Duke u nisur nga marrëdhëniet vëllazërore i paralajmërojmë edhe një herë drejtuesit e shtetit të Shqipërisë dhe miqtë tanë

shqiptarë: Fethullah Gülen përfshihet në listën e personave, për të cilët Ministria e Punëve të Brendshme të Turqisë ka lëshuar urdhër arresti ndërkombëtar.”

Po kështu, për të njëjtën temë, shih dhe shkrimin e titulluar: “Perandoria “Gülen” në Shqipëri”, i cili u botua së pari në gjuhën shqip në revistën Shenja, i përkthyer nga një shkrim i botuar fillimisht në gazetën turke Yeni Akitq. (ribotuar nga Tema Online, në datën 26 shtator 2014).

* * *

Mjaft aktiv në shtyp pas grushtit të shtetit të dështuar në Turqi, ka qenë dhe këshilltari i ambasadës turke dhe njëkohësisht *zv. Shefi i Misionit* në Tiranë, Sinan Cem Baş, në polemikat e tij me gazetarin Mentor Kikia dhe Hajro Limajn, dikur ish-atashe ushtarak i Shqipërisë në Turqi, të cilët ai i akuzon si mbrojtës të ‘Organizatës Terroriste FETO në Shqipëri’ . Shih për këtë shkrimet e tij: ‘Zigzaket e Mentor Kikisë’ dhe “Paranoja e Mentor Kikise” – të botuar respektivisht 10 dhe 14 nëntor, te Gazeta Shqiptare), si dhe shkrimin: “Ambasada turke replikë me ish-atasheun ushtarak të Shqipërisë në Turqi” (Gazeta Shekulli/Java News, 5 gusht 2016), ku ndër të tjera thuhet: *“Ithtari i FETO-s, Hajro Limaj, i cili këto ditë është angazhuar me sulme ndaj presidentit dhe qeverisë së zgjedhur të Turqisë, nuk lejon cenimin e figurës së kryeterroristit Fethullah Gülen, por e ngre atë në pedestal duke e përkufizuar si filozofin dhe arkitektin e*

krijimit të shkollave turke në Turqi dhe mbarë botën (Gazeta Shekulli, 7 mars 2014). Sipas diplomatit turk: “Site-t të cilat bëjnë propagandën e organizatës FETO, shpesh herë i referohen shkrimeve të Hajro Limaj. Kam përshtypjen se të gjitha këto fakte janë të mjaftueshme për të kuptuar se kush e komandon Hajro Limajn, atë që nuk lejon cenimin e organizatës FETO.”

Një tjetër person që prej kohësh është treguar mjaft aktiv në denoncimin e ndikimit të lëvizjes Gulen në Komunitetit Musliman Shqiptar (por jo vetëm) ka qenë dhe Ermir Gjinishi. Ndër të tjera ai akuzoi drejtpërdrejt dhe Kreshnik Spahiu, themeluesin e Lëvizjes Kuq e Zi, si të financuar nga lëvizja Gulen. Sipas Ermir Gjinishit, kjo lëvizje ka depërtuar në Parlament, në polici, në gjykata, në prokurori, në SHISH.” (Shih, Ermir Gjinishi në Zululand: Kreshnik Spahiu financohet nga lëvizja Gulen. – gazeta Tema, 20 korrik 2016); shih po ashtu dhe: “INTERVISTA/ “Gjendja e myslimanëve në Shqipëri, jashtë kontrollit!!!” Ben Andoni intervistë me teologun Ermir Gjinishi (16 nëntor 2016, Tema online/Java news). (Për këtë të fundit, shih më shumë në kapitullin e “Radikalizimit”.

Është me vend të kujtohet këtu se të njëjtën akuzë për lidhjet mes Lëvizjes Kuq e Zi dhe lëvizjes Gulen, dhe financimin e saj prej gulenistëve, e pati bërë kohë më parë dhe Revista MAPO (shih Alfred Lela, “Projekti neo-Otoman, Aleanca Kuq e Zi, parti turke”, Revista Mapo, 17 maj 2012).

* * *

Duke e ngushtuar shikimin tonë vetëm në atë çka lidhet me temën që na intereson në një debat që në fakt është mjaft më i gjerë, mund të dilet në përfundimin se shkrimet që kanë lidhje me të ashtuquajturën ‘çështja guleniste’, ndahen në tre kategori kryesore:

Së pari, shkrimet që kanë thjeshtë natyrën e lajmit, pra që kanë për qëllim thjeshtë informimin, të cilët përbëjnë dhe shumicën.

Së dyti, shkrimet e përkthyer, të marra nga shtypi ndërkombëtar. Bëhet fjalë kryesisht për shkrime që kanë në qendër atë që po ndodh në Turqi, por ku një vemendje e veçantë i kushtohet natyrshëm shkrimeve që lidhen me Shqipërinë

Së treti, Debatet/reagimet lidhur me këtë çështje të botuara në faqet e shtypit.

Më poshtë po përqëndrohemi vetëm në dy kategoritë e fundit, të cilët paraqesin dhe më shumë interes për të kuptuar mënyrën se shtypi i shkruar i kësaj periudhe i është qasur kësaj çështjeje.

* * *

Tashmë dihet vëmendja e madhe që shtypi shqiptar tregon për gjithçka që shkruhet në shtypin botëror për Shqipërinë dhe shqiptarët. Kjo vëmendje sigurisht që shtohet kur këto shkrime kushtuar Shqipërisë lidhen me emra të mëdhenj të shtypit botëror.

Por ndërsa në shumë raste është thjeshtë një çështje kureshtjeje për të ditur se si na sheh ne bota, në disa raste, sidomos

kur bëhet fjalë për tema të nxehta që kanë lidhje dhe me debatet e brendshëm, ribotimi i këtyre shkrimeve kthehet në pjesë të vetë debatit. Efekti pasqyrë i këtyre lloj shkrimesh/analizash të shtypit ndërkombëtar, sidomos kur ky shihet ‘si mbi palët’, ka pasur dhe vazhdon të ketë një ndikim të madh në formësimin e perceptimeve të opinionit publik për çështje të caktuara. Nga ana tjetër, vetë përzgjedhja dhe vendi që i lihet këtyre lloj shkrimesh, dëshmon dhe qëndrimin që një gazetë e caktuar ka ndaj një çështjeje të caktuar.

Ndaj dhe s’është e rastit vëmendja aq e madhe që iu kushtua shkrimit të botuar prej revistës prestigjioze “The Economist”, i cili ka në qendër të tij pikërisht mënyrën se si Turqia e Erdoganit është duke u përpjekur të përdorë fenë Islame si një instrument të ndikimit të saj politik. Në këtë shkrim gjen dhe një analizë për situatën në të cilën gjenden institucionet përfaqësuese të besimit Islam. Një pjesë e shtypi të shkruar e botoi këtë shkrim të titulluar: “*The Economist: Synimet e Turqisë pas ndërtimit të xhamive në Shqipëri*” (22 janar 2016, Lapsi.al/Tema on line), ndërkohë që të tjera e titulluan atë: “*The Economist: Diplomacia fetare e Turqisë – Ndërtimi i xhamive jashtë për të rritur fuqinë e saj*” (shih Opinion.al, apo gazetën Telegraf të së njëjtës datë).

Shkrimi i revistës prestigjioze angleze fillon pikërisht me ndërtimin e xhamisë së madhe në qendër të Tiranës nga qeveria turke: “*Një mega-xhami po ngrihet në rrugën “George W. Bush” në Tiranë, kryeqytetin shqiptar, në afërsi të parlamentit të vendit.*” shkruan The Economist. “*Kur të përfundojë, ajo do të jetë xhamia më e madhe në Ballkan, një në një varg të gjatë të projekteve të*

tilla financuara nga Turqia.” Më tej artikulli vazhdon: “Kritikët dyshojnë se Presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan është duke vendosur me këto veprime një ringjallje të trashëgimisë së Perandorisë Otomane. Sekularët nacionalistë në Shqipëri, vend i cili ishte rreptësisht ateist nën komunizëm, stepen kur shohin se parlamenti i tyre do të ngjajë mjaft i vogël nga xhamia që ngrihet pranë ndërsa urbanistët ankohen për formën ‘McOttoman’ të projektit.”

Sipas analizës që bën The Economist: “Roli i Turqisë në islamin shqiptar shkon përtej ndërtimit të xhamive. Gjashtë nga shtatë seminarët islamike të vendit menaxhohen nga fundacione të lidhura me komunitetin Gülen. Agjencia e Zhvillimit të Turqisë, TIKA, ka përfunduar 248 projekte në Shqipëri. Përveç ndihmës fiskale, shumë shqiptarë e mirëpresin ndikimin e Turqisë si një kundërpeshë ndaj përhapjes së militantizmit islamik. Sipas myftiut të Tiranës, Ylli Gurra, deri tani 150 shtetas shqiptarë i janë bashkuar Shtetit Islamik (IS) si xhihadistë në Siri. Ai fajëson fundacionet salafiste nga monarkitë e Gjirit që u derdhën në rajon në vitet 1990. (Shumë prej tyre u dëbuan pas sulmeve të 11 shtatorit.) Z. Gurra thotë se shumica e muslimanëve shqiptarë refuzojnë radikalizmin e tillë: Sipas tij “Ata kanë më shumë prirje për Islamin turk.” Shkrimi i The Economist përfundon duke përshkruar dhe se si konflikti i ashpër që po zhvillohet aktualisht mes qeverisë turke dhe lëvizjes Gulen, është mbartur ashpërsisht dhe në gjirin e vetë Komunitetit Musliman Shqiptar: “Ndërkohë, në terrenin fetar të Turqisë ka një konflikt të brendshëm. Partia e Zhvillimit (AK) që dikur ka punuar krah për krah me lëvizjen

Gylen tashmë është prishur me të. E gjithë kjo ndryshoi dy vjet më parë, kur AK nisi një hakmarrje kundër lëvizjes, duke e akuzuar atë se kish orkestruar një skandal korrupsioni që prekte figura të larta të qeverisë. Burokratë gulenistë u dërguan prapa hekurave... Objektivi përfundimtar është “të pretendojmë territore të reja”- thotë zoti Oktem. “Është ideja që Turqia duhet të jetë udhëheqësi i gjithë botës muslimane.”

Në të njëjtën linjë me shkrimin e The Economist është dhe një shkrim i cili u botua fillimisht në gazetën amerikane “Huffington Post”, me titull: “*Si po promovohet agenda neo-otomane e Turqisë në Kosovë*” (Tema on line, 20 dhjetor 2015). Pavarësisht se shkrimi, siç kuptohet dhe prej titullit, s’ka lidhje të drejtëpërdrejtë me vetë Shqipërinë, ai paraqiti mjaft interes në shtypin e Tiranës, nga që problematika është sidoqoftë mjaft e ngjashme.

“*Turqia po eksporton islamizmin nën maskën e bashkëpunimit kulturor*” shkruhet në Huffington Post: “*Agjencia Turke për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Zhvillim (TIKA) është mekanizmi parësor nëpërmjet së cilës Turqia avancon agjendën e saj ideologjike. TIKA është pararojë e Partisë Për Drejtësi e Zhvillim (AKP) që mbështetet tek formacionet e Vëllazërisë Muslimane në botë. TIKA drejton një strukturë paralele të politikës së jashtme në koordinim me Ministrinë e Kulturës në Turqi si dhe Kryesinë për çështjet fetare për ta promovuar agjendën islamike të AKP-së. “ Shkrimi mbyllet me fjalët: “TIKA fondet e saj i transferon cash, pa ndonjë procesverbal apo regjistrim bankar. Kjo organizatë nuk dëshiron të tërheq vemendjen për veprimet e*

saj.” (Gazeta Tema, 30 dhjetor 2015)

Për t’u përmendur është dhe shkrimi: *“Netë pa gjumë” për mbështetësit e Gylenit në Europë*” (Lapsi.al, 24 gusht 2016), shkrim i përkthyer nga revista ‘Politico’, i cili ndonëse s’merret konkretisht me Shqipërinë apo Ballkanin, sjell një tablo më të gjerë lidhur me presionet e forta që Turqia është duke ushtruar në mbarë botën për eliminimin e institucioneve të lëvizjes Gulen.

Për më shumë për të njëjtën temë, shih po ashtu, dhe shkrimin: *“Erdogan: Muslimanët në Ballkan kanë nevojë për mbështetjen e botës islame”* (gazeta Tema, 14 prill 2016).

* * *

Sigurisht që e gjithë kjo situatë që në qendër të një debati të nxehtë të zhvilluar në faqet e shtypit shqiptar, e aq më shumë në portalet e shumta on line. Më poshtë po sjellim thjeshtë një përzgjedhje të disa prej shkrimeve/reagimeve të botuara gjatë kësaj periudhe, të cilat gjithsesi shërbejnë për të kuptuar më mirë thelbin e debatit, apo të shqetësimit që disa e etiketojnë si frika prej politikës neo-otomaniste të qeverisë turke. Debat ky i cili lidhet drejtpërdrejt me problematikën që ka në vëmendje ky studim.

Po e fillojmë me shkrimet e gazetarit të njohur Mentor Kikia, i cili në një sërë shkrimesh trajtoi këtë temë, duke u përfshirë, siç u tha, në një debat të ashpër me ambasadën turke në Tiranë.

Fillimisht Mentor Kikia botoi shkrimin: *“Fitorja e Erdoganit*

dhe jehona islamike në Tiranë” (Balkanweb, Gazeta Shqiptare, 10 nëntor 2016), ku ndër të tjera, ai shkruante: “... Duhet thënë se qeveria turke e ka objektiv tashmë të deklaruar të ndikojë në mjedisin politik, social, mediatik e shoqëror shqiptar. Pra nuk është vetëm një partner ekonomik dhe politik, si Gjermania p.sh. Ajo mendon se, në një farë mënyre, duhet të kthehet në kufijtë e vjetër në rajon dhe në këtë kuadër edhe të diktojë politikat e tij...” Veçanërisht me interes për qëllimet e këtij raporti, është pjesa e shkrimit të M. Kikisë, ku ai përshkruan atë që, sipas tij, është duke ndodhur aktualisht në gjirin e komunitetit mysliman në Shqipëri”

“Sot në Shqipëri’ vazhdonte më tej Mentor Kikia, “ka nga ata që janë entuziazmuar publikisht për fitoren e Erdoganit, jo thjesht si adhurues të politikës së tij, por sepse shpresojnë që kjo do të influencojë drejtpërdrejt në Shqipëri. Dhe kjo eufori nuk lidhet shumë me pritshmëritë ekonomike, por më së shumti me ato fetare. Pra ka një adhurim thjesht për Perandorinë, por për radikalizmin fetar që po instalohet në “Perandorinë e re të Erdoganit”. Ja çfarë shkruan njëri prej tyre në rrjetet sociale, kujton Kikia: “Në mënyrë të veçantë, ky rezultat ka rëndësi për zhvillimet në Shqipëri, ku rivalet për jetë a vdekje të AKP –së drejtojnë Komunitetin Mysliman të Shqipërisë, me një filozofi sipërfaqësore dhe në thelb sekulare”. Ata që dinë pak nga “punët e brendshme” të KMSH-së,” vazhdoi ai. “dinë se çfarë lufte zhvillohet mes “tradicionalëve” dhe “të rinjve”, me prirje radikale, për të marrë drejtimin e Komunitetit. Madje shteti ka një “marrëveshje” me KMSH-në, përmes së cilës ndërhyh kur ka

informacion se mund të cenohet siguria kombëtare. Falë kësaj, shteti ia ka dalë deri tani t'i pengojë "të shkolluarit e Teheranit apo Riadit" të marrin drejtimin e KMSH-së. Të tjerë shkruanin se Erdogani fitoren shkoi ta ndante me Zotin, në xhaminë Ebu Ejjub El Ansari, të parën që turqit ndërtuan kur çliruan Konstandinopojën. Po ashtu, me një gjuhë të ashpër kundërshtohet nga disa të tjerë qëndrimi i Brukselit ndaj dhunës që qeveria turke ka ndërmarrë ndaj lirisë së medias, duke i cilësuar mediat e pavarura në Turqi sikur të ishin gazeta naziste në Bruksel. Erdogani tashmë ka çdo gjë në dorë që shtetin turk ta shndërrojë në një republikë islamike, duke shkatërruar trashëgiminë e Atatürkut të madh, që e themeli Turqinë moderne mbi rrënojat dhe shallvaret e Perandorisë Osmane."

Sipas Mentor Kikisë: *"Ithtarët e Erdoganit në Shqipëri, në fakt janë ata që më shumë se çdo gjë tjetër, presin ndryshime në rrafshin fetar. Kjo në dukje nuk ka asgjë të keqe... Problemi është se ka një interferim mes atyre që gëzojnë për Erdoganin dhe atyre që gëzojnë për ISIS-in. Në Shqipëri ka disa portale informative dhe opinionbërëse që mbështeten me financime qeveritare turke sikundër besohet se ka shoqata që i përkasin ekstremit islamik, që gjithashtu mbahen në këmbë me financime që rrjedhin nga agjenci qeveritare turke. Jozyrtarisht, mësohet se këto shoqata kanë pasur rol edhe në organizimin e xhihadistëve shqiptarë për në Siri. Natyrisht, për këto nuk ka dokumente, por strukturat e posaçme shtetërore duhet të jenë në dijeni. Parë në këtë kontekst, jehona e fitores së Erdoganit në Shqipëri nuk duhet parë thjesht si simpati e individëve të caktuar, por është një*

problem që duhet të marrë vëmendjen e strukturave të shtetit. Pa dyshim që, politikisht Shqipëria dhe Kosova do të vazhdojnë të jenë vëllezërit e vegjël të Turqisë, dhe për këtë nuk duhet të ketë ndryshime në politikat e Tiranës dhe Prishtinës. Por në çështjet e fesë ne duhet të tregohemi absolutisht shumë konservatorë. Jehona e festës në Ankara nuk duhet të mbërrijë në Tiranë, e aq më pak në Komunitetin Mysliman.”

Mentor Kikia e mbyllte shkrimin e tij të gjatë me fjalët: *“Shqipëria duhet të vazhdojë të jetë shtet laik, pa lejuar parti fetare, pa lejuar instalimin e një sistemi politik fetar, dhe për këtë nuk duhet të ndryshojë asnjëherë kurs.”*

Pas reagimit të ashpër ndaj shkrimit të tij nga ana e këshilltarit të ambasadës turke në Tiranë, në të cilën indirekt Mentor Kikia akuzohej për lidhje me lëvizjen guleniste, Mentor Kikia botoi një tjetër shkrim të titulluar: *“Mbi Turqinë dhe “paranojën” e islamit në Shqipëri”* (Balkanweb/Gazeta Shqiptare 16 nëntor 2016). Në këtë shkrim, duke iu përgjigjur shkrimit të diplomatit turk *“Paranojat e Mentor Kikisë”*, për të cilin M. Kikia shprehej se që ngritur *“mbi disa sajesa e shtrembërime të atyre që unë kisha shkruar.”* M.Kikia kujtonte se në shkrimin e tij të mëparshëm ai veçse kishte sjellë shqetësimin: *“për tendencën e individëve apo grupe individësh në Shqipëri që hapur shprehen për një “frymë të re” (këtu kam parasysh tendencat radikale apo ekstreme) në mënyrën e interpretimit të islamit, e madje edhe drejtimit të Komunitetit Mysliman Shqiptar.”*

“Unë shqetësohesha” shkruante Kikia në shkrimin e tij. *“se shumë shqiptarë u gëzuan pas fitores së AKP-së, jo njësoj*

siç unë u gëzova, p.sh. kur fitoi Barak Obama, por sepse presin “erën e ndryshimit” fetar, duke e parë Erdoganin si Kalifin e myslimanëve. Kritikoja qëndrimet (dhe këto janë publike) të shumë shqiptarëve, nga më të thjeshtët deri te profesorë të njohur, të cilët vazhdojnë të mendojnë se Perandoria Osmane ka qenë jo pushtuese, por administratore e Shqipërisë. Me pak fjalë, i tërë shqetësimi im ishte se nga fitorja e AKP – një parti me baza të forta dhe tendencë të theksuar islamike, të cilën nuk e ka fshehur, përkundrazi, nuk duhet të ketë refleksione fetare në Shqipëri.”

Më tej në shkrim Mentor Kikia shtjellon dhe shqetësimin e tij dhe lidhur me atë që ai e sheh si një ngatërrim të qëllimshëm “i referimit Shqipëri-Perandori Osmane me Shqipëri-Turqi”.

Ai e mbyllte reagimin e tij, duke iu përgjigjur akuzës nga ana e diplomatit turk për marrjen në mbrojtje të lëvizjes guleniste: “Ju gati më kërkonit llogari për se mbroj strukturën e udhëhequr nga Fethullah Gylen.” shkruante Mentor Kikia. “Për strukturë këtu besoj e keni fjalën për rrjetin e shkollave të tij në Shqipëri. Ju e quani mbrojtje meqë nuk e kritikoj... Dhe për këtë argumentoni se ai është terrorist, pasi të tillë e ka shpallur qeveria juaj. Në fakt unë, si gazetar, kur vjen fjala për terrorizmin, aq më shumë ndërkombëtar, i referohem jo listës së Ministrisë së Jashtme të Turqisë, por listës së Departamentit Amerikan të Shtetit, i cili me Gulenin ka të tjera raporte.

Në fund të shkrimit Kikia, përmbledh atë që, sipas tij, përbënte dhe shqetësimin e tij kryesor lidhur me “rrezikun e interferimit të islamit politik, apo çfarëdo ndikimi tjetër me sfond fetar, që mund të vijë edhe nga Turqia.

“Në Shqipëri,” shkruante ai. “ne nuk e pyesim njëri-tjetrin për fenë as kur dashurohemi, as kur krijojmë shoqëri, as kur bëjmë biznes, as kur bëjmë politikë... Megjithatë, në Shqipëri, ashtu si edhe në Turqi, Francë, Britani e SHBA, ka ekstremistë fetarë. Ka njerëz që i janë bashkuar ISIS-it. Ka njerëz që festuan kur u shpall Shteti Islamik. Ka struktura që merren me organizimin e luftëtarëve islamikë. Ka njerëz që mendojnë se Shqipëria duhet të jetë një shtet islamik. Ka njerëz që mendojnë se duhet të instalohet islami politik. Ka njerëz që kanë synuar të krijojnë parti islamike. Por, për fat, këta janë të pakët, pa ndikim, dhe shoqëria e shteti kanë ditur t’i mbajnë mënjanë. Mua më shqetëson gjithashtu fakti se ka njerëz, që edhe nuk mund të mos konsiderohen, të cilët mendojnë se pas zgjedhjeve në Turqi dhe nën frymën e tyre, na u dashkan bërë edhe zgjedhjet në Komunitetin Mysliman Shqiptar, “ku rivalët për jetë-a-vdekje të AKP-së drejtojnë në mënyrë sekulare. Mua më shqetëson fakti,” vazhdonte ai. “që qeveria turke mundohet të ushtrojë influencën e saj, për të marrë nën kontroll jetën fetare në Shqipëri dhe KMSH-së, duke cenuar ekuilibrat e shenjtë të bashkëjetesës fetare në Shqipëri.”

Pak a shumë të njëjtin shqetësim shprehte dhe gazetari i mirënjohur kosovar me banim në Zvicër, Enver Robelli, në shkrimin e tij: “Sahatet e Stambollit dhe raportet shqiptaro turke” (Gazeta Koha Ditore/Tema on line, 25 gusht 2016).

Sipas Robellit: “Në vend se të fokusohet në thellimin e partneritetit me BE-në dhe SHBA-në, Erdoan prej vitesh ndjek një agjendë islamike, kulturore dhe neosmane. Më së shumti

kjo politikë është e dukshme në Ballkan. Kur ishte për vizitë në Kosovë më 2013” vazhdon më tej E. Robelli. “Erdoan tha se Kosova është Turqi, Turqia Kosovë. Bosnjën e pati quajtur provincë osmane. Kur u kthye nga një vizitë në Afrikën veriore më 2013 nga aeroporti i Stambollit Erdoan përshëndeti Sarajevën, Mekën dhe Medinën. Ambicia për të lartësuar të kaluarën perandorake është bërë konstante e politikës turke. Këtu ka një lloj misionarizmi që po i irriton njerëzit sidomos në hapësirën shqiptare: bëhet fjalë për një shtresë të gjerë të shoqërisë që ka respekt për Turqinë si shtet laik, por jo si shtet me agjendë islamike. Shumë politikanë të partisë së Erdoanit janë të prirë që Perandorinë Osmane ta shohin vetëm si parajsë të popujve, por e tillë nuk ka qenë Porta e Lartë. Po të ishte nuk do të derdhej aq shumë gjak në Ballkan, nuk do të dështonin aq shumë përpjekje për të futur nën kontroll territoret kryengritëse shqiptare, nuk do të ekzistonte epoka e rezistencës së Skënderbeut dhe Pjetër Bogdanit, nuk do të kishte ndodhur masakra e Manastirit e 26 gushtit 1830, kur në një përpjekje brutale për pacifikim të trojeve shqiptare guvernatori Mehmed Reshid Pasha i ftoi në një banquet të madh krerët e fiseve shqiptare, të cilët pastaj i masakroi deri në burrin e fundit, nuk do të ishte vrarë më 1878 në Gjakovë Mehmet Ali Pasha, mareshali osman me origjinë gjermane.”

Më tej Enver Robelli vazhdonte: “Turqit janë krenarë për historinë e tyre dhe kjo është e drejtë e tyre që duhet respektuar, por politikanët e Ankarasë duhet ta kenë parasysh se shumica e shqiptarëve në Ballkan nuk mund të jenë krenarë për historinë turke duke pështyrë e injoruar historinë shqiptare. Fuqia

ekonomike e Turqisë, blerja e ndërmarrjeve strategjike në Kosovë, hapja e shkollave nuk i jep të drejtë qeverisë turke ta trajtojë Kosovën si vilajet. Kjo qasje është kontraproduktive për vetë Turqinë. Turqia është partner i rëndësishëm i Evropës, rrjedhimisht edhe i shqiptarëve në Ballkan. Që ky partneritet të ruhet, Ankaraja duhet të heqë dorë nga agjendat e imponimit kulturor dhe fetar si dhe interpretimit tendencioz të historisë. Në këtë prizëm duhet parë edhe vendosjen e disa orëve me flamur turk në klasat e një shkolle në Prishtinë. Ngase qeveria turke ka meremetuar klasat, ajo mund të lërë një shenjë aty, një pllakë diku në oborr a korridor, ku tregohet se këtë apo atë punë të vlefshme e ka kryer qeveria turke. Dhe për këtë le të merren si shembuj organizatat përkatëse gjermane, zvicerane apo suedeze (GIZ, SDC, SIDA). Shteti i Kosovës nuk shpërbëhet nga disa sahatë me flamur turk, por shpeshësia dhe agresiviteti i nismave turke që kanë për qëllim glorifikimin e Perandorisë Osmane, imponimin e simboleve, vënien në dyshim të fakteve historike po shkaktojnë në shoqërinë shqiptare (jo vetëm në Kosovë) reagime të ashpra.”

Po ashtu mjaft e ashpër në reagimin e saj tregohet dhe Albana Xharra, në shkrimin e saj: “*Marionetat shqiptare të Erdoganit*” (26 Prill, 2016 , Tema Online, gazeta Ekspres/Prishtinë).

Pasi akuzon klasën politike në Kosovë, por dhe atë në Shqipëri, për atë që ajo e konsideron nënshtrim të plotë deri në servilizëm ndaj politikave të Erdoganit, sepse “*Vëllai Erdogan duhej respektuar me nënshtrim deri në mosguximin e pirjes së një gote verë përpara tij...*” vë ajo në dukje. “*apo kur ish-*

kryeministri Hashim Thaçi, edhe pse s'njihet si ndonjë besimtar i denjë i fesë islame, pat shkuar bashkë me Erdoganin dhe myftiun Naim Ternava për të falur drekën në Xhaminë e Madhe të Prishtinës.” Dhe pa shkuar shumë, sipas saj, “dhe Rama i premtoi hapësirë në qendër të Tiranës për të ndërtuar xhaminë më të madhe në Ballkan, derisa në Kosovë kishte ndërtuar përmes organizatave shtetërore, dhjetëra xhami dhe shumë të tjera nga periudha otomane i kishte rinovuar.”

Albana Xharra shqetësohet se: “Me vetëdije të plotë, si Kosova edhe Shqipëria ua hapën dyert politikave turke që të promovojnë agjendën neo-otomane, e cila ka një qëllim: shtrirjen e influencës në ish-territoret e Perandorisë Osmane. Turqia,” sipas saj, “po eksporton islamizmin nën maskën e bashkëpunimit kulturor...”

Sipas Albana Xharrës, “Erdogani e qeveria e tij... e ka bërë të qartë agjendën e tyre ideologjike në krye me islamin politik. Investime marramendëse janë bërë në Kosovë, por jo në fabrika. Agjencia Turke për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Zhvillim (TIKA) është mekanizmi parësor përmes të cilit Turqia avancon agjendën e saj ideologjike.” Por shqetësimi më i madhe i saj është për faktin se “agjenda e Erdoganit bazohet haptazi te feja, pra është një agjendë haptazi islamike, madje, gjithnjë sipas saj, duke krijuar dhe parti politike si Besa në Maqedoni, të cilat marrin direkt para nga Erdogani, çka sipas saj, ka për qëllim “turqizimin e shqiptarëve’... E jo rastësisht dhe pa agjendë u dha edhe deklarata e zv/kryeministrit turk, Numan Kurtumulus, në Kosovë, kur e përsëriti disa herë se “Kosova është pjesë e botës islamike”, se “Turqia është e lidhur emocionalisht me Kosovën”

dhe se “Kosova ka kulturë islame”, madje përpara syve të politikanëve tanë. Ky përfaqësues i autokratit Erdogan, vetëm sa rikonfirmoi agjendën turke në Kosovë, për të cilën është punuar intensivisht qysh nga mbarimi i luftës 1999. Të pavetëdijshëm për shtrirjen e ndikimit turk, duke qenë të zënë me ndërtimin e institucioneve tona, paratë nga Turqia kanë mbushur vazhdimisht gropat e zbrazura.”

“Sot të kritikosh Erdoganin në Kosovë, një numër jo i vogël i shqiptarëve t’i “nxjerrin sytë” e përfundonte shkrimin e saj Albana Xharra.

Përfundimi në të cilin ajo mbërrin në fund të shkrimit të saj, mund të thuhet se qëndron dhe në rastin e Shqipërisë, pa çka, ç’është e vërteta, kurrsesi në përmasat që me sa duket ekziston një dukuri e tillë në Kosovë. Për më tepër në rastin e Shqipërisë hapësira e preferuar e të ashtuquajturve ithtar të Erdoganit, me sa duket, më shumë se sa në median kryesore, është ajo e portaleve të shumta, qofshin këto me orientim fetar ose jo.

Si shembull sa u tha më lart, shih për shembull, shkrime të tipit: “Kotësitë bajate të paranojakut islamofob Enver Robelli”, me autor një farë Fatlum Sadiku, që pas emrit shton *MA, Ankara* (Zëri Islam, 12 shtator 2016). Apo shkrimin: “Mbahet në Tiranë simpoziumi: Keqpërdorimi i fesë: Rasti i Turqisë” (21.11. 2016, Anadolu Agency), i cili raporton për një simpozium të mbajtur në Tiranë, i organizuar nga një shoqatë e quajtur: “Shoqata Alternativa e së Ardhmes (ALSAR)”. Sipas shkrimit, në qëndër të seminarit në fakt qe goditja e lëvizjes FETO (Guleniste). Sipas kryetarit të kësaj shoqate, Mehdi Gura, “*ndikimi dhe rreziku i*

së cilës ka penetruar dhe është përvijuar dhe në vendin tonë, në sektorët mediatikë, kulturorë, politik, arsimor dhe fetar”.

Është interesante të vërehet gjuha me të cilën goditet kjo lëvizje në ambjente të tilla: *“Fetullah Gülen,”* shprehet një ndër folësit në simpozium, sipas shkrimit të Anadolu Agency: *“I ka shërbyer fuqive globale dhe në këtë mënyrë i ka shkaktuar shumë dëm Islamit në Turqi. Ai shkoi deri atje saqë urdhëroi që punonjësit të infiltruar në ushtri të konsumojnë alkool, gratë e tyre të heqin shaminë, etj. E çfarë mund të bëjë më shumë një shejtan? ... Nëse Güleni ka një plan global, duhet të dijë që Allahu ka strategjinë dhe planin e tij”.*

Është interesante të vihet në dukje fakti që, ndërsa në Shqipëri Komuniteti Musliman akuzohet se është në duart e gulenistëve, dhe se krerët e tij kryesorë janë pjesë e kësaj lëvizje, në Kosovë, përkundrazi, krerët e Komunitetit Musliman të Kosovës janë erdoganistë të zjarrtë. Në fakt gjuha që ata përdorin jo rrallë do të ishte e papërfytyrueshme në kontekstin e Shqipërisë, për shkak të reagimit të madh që do të shkaktonte.

Shih për këtë, për shembull, shkrimin : *“Kreu i muslimaneve të Kosovës, Osmanet s’ishin pushtues.”* (16 qershor 2016 – Balkanweb/Gazeta Shqiptare, Gazeta Tema). Bëhet fjalë për një deklaratë të kreut të Komunitetit Musliman të Kosovës, të bërë prej tij gjatë ceremonisë të organizuar me rastin e 625 vjetorit të betejës së Kosovës, me ç’rast ai u shpreh se është detyrim i muslimanëve. *“për ta kujtuar sulltan Muratin, i cili kontribuoi në çlirimin e popullit shqiptar nga pushtuesi sllav.”*

DISA PËRFUNDIME

Ky vështrim për mënyrën se si shtypi shqiptar ka trajtuar gjatë një periudhe nëntë mujore (janar-shtator 2016) problematikën që lidhet me fenë, shërben para së gjithash për të na dhënë një panoramë të përgjithshme të çështjeve që ekzistojnë, si dhe të vendit që zë tematika e lidhur me fenë në ligjërimin publik. Sigurisht, që nga ana tjetër, ai të lejon të krijosh dhe një ide se cilat janë shqetësimet, frikërat, pretendimet e pritshmëritë që karakterizojnë debatin kur është fjala por fenë.

Nga ana tjetër, një vëzhgim si ky, sidomos duke u përqendruar në analizën e disa prej debateve më kryesore, të lejon të nxjerrësh dhe disa përfundime.

Ç'është edhe më interesante, duke pasur kësaj here mundësinë për një shikim krahasues me të dhënat e një studimi të ngjashëm të kryer po prej IDK gjatë viteve 2011-2012, ke mundësinë të nxjerrësh disa konkluzione për vetë evoluimin e tematikës që lidhet me fenë.

Konkluzioni i parë që mund të nxirret në fakt s'përbën diçka të re: Është një fakt që tashmë prej disa vjetësh opinionin publik tregon një interesim të veçantë për gjithçka që lidhet me fenë,

madje duke i kthyer jo rrallë diskutimet që në një mënyrë a një tjetër lidhen me të, në çështje të ‘nxehsta’, duke nxitur ndoshta dhe disa prej debateve publike më interesante. Ndërkohë, ajo çka është më me interes të vihet në dukje, që rezulton nga një studim analitik si ky këtu, është fakti që tashmë në opinionin publik janë konsoliduar disa konstante, që mund të konsiderohen tradicionale:

Kështu, e tillë mund të konsiderohet ndjeshmëria e lartë që dëshmon shtypi i shkruar dhe, nëpërmjet tij, besojmë, opinionin publik, sa herë që bëhet fjalë për atë që tashmë prej kohësh përkufizohet me termin: “bashkëjetesa dhe toleranca fetare”, si një ndër shtyllat kryesore mbi të cilat prej më së paku një shekulli ngrihet uniteti kombëtar dhe kohezioni social i shoqërisë shqiptare. Lidhur me këtë, janë dy përfundimet me rëndësi që mund të nxirren:

Së pari, është e qartë se pjesa më e madhe e opinionit publik shqiptar beson se bashkëjetesa dhe toleranca fetare përbëjnë një ndër vlerat më të çmuara të trashëguara të shoqërisë shqiptare, me të cilën ne, shqiptarët, që përndryshe kemi jo pak probleme për sa i takon imazhit që kanë të tjetër për ne, mund të mburremi përpara botës, sidomos në këto kohë të trazuara që bota përjeton sot. Madje mund të thuhet se në këtë drejtim nuk ekziston ndonjë dallim thelbësor midis ligjërimit propagandistik zyrtar dhe asaj që besojnë pjesa më e madhe e shqiptarëve.

Kjo po ashtu shpjegon dhe ‘kujdesin’ e madh që pjesa më e madhe e shtypit dëshmon sa herë që bëhet fjalë për të trajtuar temën fetare.

Sidoqoftë, një vështrim më nga afër i debateve të zhvilluara gjatë periudhës së marrë në shqyrtim lidhur me situatën fetare në vend, të lejon të evidentosh disa elementë që të tërheqin vëmendjen, si dhe disa tendenca që duket se janë duke u konsoliduar në ligjërimin publik:

Kështu, sërish si dhe para katër vjetësh, në qendër të debatit e të diskutimeve lidhur me fenë, qëndron çështja e laicitetit. Gjatë periudhës së marrë në shqyrtim gjatë vitit 2016 kjo temë zë një vend mjaft të dukshëm, sidomos në debatet e shumtë e të zjarrtë që shoqëruan idenë e hedhur prej kryeministrit Edi Rama lidhur me përfshirjen një lënde të veçantë lidhur me fetë në kurrikulat e arsimit publik.

Në debatet e zhvilluara me këtë rast, nuk është e vështirë të dallosh se si në thelb bëhet fjalë për dy vizione krejt të ndryshëm që përplasen mes tyre lidhur me vendin që zë apo duhet të zërë feja në shoqërinë dhe në hapësirën publike shqiptare.

Nga njëra anë qëndrojnë ata që (nëse do të gjykohet nga shtypi), përbëjnë qartësisht shumicën, të cilët vazhdojnë të mbrojnë parimin e laicitetit (shekullarizmit), pra parimin e ndarjes së qartë jo thjesht të shtetit nga feja, por dhe të vetë hapësirës publike nga ndikimi fetar, çka për ta mbetet një ndër parimet kryesore kushtetuese mbi të cilën ka funksionuar shteti shqiptar qysh prej lindjes së tij, duke garantuar efektin shkatërrues përçarës që do mund të kishte përndryshe përbërja fetare e shqiptarëve për unitetin kombëtar. Duke gjykuar nga debatet e zhvilluara gjatë kësaj periudhe, ke përshtypjen se vazhdon të mbetet i pranuar

gjerësisht mendimi se pikërisht parimi i laicitetit qëndron në bazë të asaj bashkëjetese shembullore fetare që vazhdon të karakterizojë jetën shqiptare.

Ashtu siç mbetet mbizotëruese ideja se toleranca dhe bashkëjetesa fetare përbëjnë një ndër vlerat më me rëndësi jo thjesht për të tashmen por dhe të ardhmen e vendit, që ruan balancat që kanë ekzistuar tradicionalisht në një vend si Shqipëria, ku përndryshe përkatësitë e ndryshme fetare mund të luanin një rol të rrezikshëm përçarës.

Pra, mund të thuhet se vetëdija për domosdoshmërinë e ruajtjes së karakterit laik të shoqërisë shqiptare është kthyer tashmë në një bindje në mendjen e pjesës më të madhe të shqiptarëve, pavarësisht nëse janë ose jo besimtarë, apo fesë së cilës i përkasin.

Por ndërkohë duhet thënë se janë duke u shtuar dhe zërat që kërkojnë ta venë në dyshim këtë parim. Një qëndrim të tillë, siç mund të shihet dhe nga një sërë shembujsh të sjellë në këtë studim, e gjen të shprehur jo rrallë në faqet e medias së konsideruar *mainstream*. Por atë e gjen shumë më tepër në disa segmente të medias sociale, sidomos në një sërë faqesh apo blogjesh online me orientim fetar, në të cilat kundërshtohet haptazi parimi i laicitetit të jetës publike.

Gjithsesi, duhet thënë se qëndrime të tilla, ndonëse gjithnjë e më të zëshme, vazhdojnë të mbeten ende përgjithësisht periferike, me një ndikim të kufizuar vetëm në qarqe të caktuara.

Sidoqoftë, është fakt që në përgjithësi gjatë viteve e fundit po vërehet gjithnjë e më shumë një farë tensioni në raportet mes

parimit të laicitetit dhe fesë, kur vjen puna te raportet mes fesë dhe hapësirës publike. Ndërsa deri më sot laiciteti është kuptuar përgjithësisht si një përjashtim i fesë dhe i simboleve të saj nga hapësira publike, e në mënyrë të veçantë nga ajo politike, duke e përcaktuar vendin e tyre vetëm në sferën private, tashmë duket se kjo mënyrë interpretimi e laicitetit është duke u sfiduar gjithnjë e më shpesh nga qarqe të caktuara. Pikërisht, ky tension përbën dhe objektin kryesor të diskutimeve të periudhës së shqyrtuar në këtë studim, sidomos në rastin e debateve që shpërthyen pas bërjes publike nga ana e kryeministrit Edi Rama të idesë së futjes në kurrikulën e shkollave publike të një lënde të veçantë që lidhet me kulturën fetare.

Nga ana tjetër, nga diskutimet që ngjalli ky propozim s' ishte e vështirë të vësh re se ekziston një ndarje qëndrimesh mes bashkësive fetare, që kërkojnë një prani më të madhe të fesë në hapësirën publike, dhe një pjese të madhe të opinionit publik, e cila, vazhdon t'i qëndrojë besnike një interpretimi më tradicional të laicitetit, e cila e sheh veçanërisht me dyshim çdo prekje të këtij parimi.

Ajo që është e re në këtë periudhë krahasuar me përfundimet që nxirrte studimi i kryer katër vjet më parë, është një shqetësim e frikë në rritje për pasojat që mund të ketë për ekuilibrat e brendshëm të shoqërisë shqiptare, e rrjedhimisht në bashkëjetesën fetare, shfaqja e një radikalizmi fetar me prirje xhihadiste islamike në Shqipëri e në Kosovë. Debati për këtë problematikë lidhet po ashtu dhe me shqetësimin për implikimet që një gjë e tillë, e

sidomos numri relativisht i rëndësishëm i shqiptarëve që rezulton të kenë vajtur për të luftuar në radhët e shtetit islamik në Siri, në imazhin për Shqipërinë e për shqiptarët jashtë vendit, me efekte penalizuese për proceset e integritimit evropian.

Nga ana tjetër, me sa duket për herë të parë opinioni publik shqiptar tashmë po ndërgegjësohet se shoqëria shqiptare jo vetëm që s'është e imunizuar nga radikalizmi fetar, por ç'është edhe më shqetësuese duket se s'është plotësisht e përgatitur për t'u përballur me dukuri të tilla të kthyer tashmë në një shqetësim serioz për mbarë botën. Siç nuk është plotësisht e përgatitur për t'u përballur me shqetësimet që lidhen me ndikimet që vinë nga jashtë vendit. Ka një frikë në rritje për pasojat që mund të vinë nga përdorimi i fesë nga aktorë të ndryshëm jashtë vendit si një instrument për të rritur ndikimin e tyre politik, apo qoftë dhe për të orientuar aleancat gjeopolitike të Shqipërisë.

S'është pra e rastit që kësaj here kësaj çështjeje i është lenë një kapitull më vete. Kjo dhe për faktin se kjo periudhë përkon me një rritje të ndjeshme të diskutimeve lidhur me shqetësimin që ekziston në një pjesë të opinionin publik lidhur me pasojat që mund sjellin në ekuilibrat fetar në vend përdorimi i fesë si një instrument i ndikimit politik nga ana e vendeve të ndryshme.

Këtu është vendi të thuhet se ndërsa deri vonë shqetësimi kryesor i opinionit publik dukej se lidhej me dyshimet se Greqia që duke e përdorur Kishën Autoqefale Orthodoxe të Shqipërisë për qëllimet e saj, kësaj radhe debati mbizotërues ka të bëjë së pari me shqetësimin në rritje që kanë ngjallur politikat e ndjekura nga Turqia, e dyshimi se ajo qartazi kërkon ta shfrytëzojë faktorin

fetar si një instrument të ndikimit të saj politik në Ballkanin Perëndimor.

Ky debat i vjetër për rolin e Turqisë në zhvillimet brendshme të vendit, sigurisht që doli edhe më shumë në pah gjatë vitit të fundit, kur u bë e qartë se dashje padashje Shqipëria që e përfshirë në një konflikt që në thelb që një konflikt i brendshëm turk, me natyrë sa politike aq edhe fetare. Është fjala për të ashtuquajturën çështja guleniste, apo më mirë për presionet në rritje nga ana e qeverisë turke ndaj autoriteteve shqiptare për të luftuar ndikimin e kësaj lëvizjeje në vend. Nga ana tjetër, një përplasje e tillë e mbartur artificialisht nga Turqia, nëpërmjet së cilës sidoqoftë opinioni publik pati mundësinë të kuptojë përmasat e ndikimit që aktorë të ndryshëm turq kanë arritur të kenë në shumë prej aspekteve të jetës së vendit, s'kishte si të mos shërbente për të rritur shqetësimin se ndikime të tilla në jo pak raste rrezikojnë të bien ndesh me interesat tona kombëtare, e po ashtu me aspiratën e përbashkët të pjesë më të madhe të shqiptarëve për t'u bërë pjesë e familjes së përbashkët të vendeve europiane.

Përfundimi i fundit lidhet me dallimet midis situatës dhe shqetësimeve që ekzistojnë në Kosovë lidhur me fenë, dhe asaj në Shqipëri.

Jo rastësisht një pjesë e këtij studimi i është kushtuar pikërisht debateve të zhvilluara në Kosovë gjatë së njëjtës periudhë për këtë temë. Sigurisht që në këtë rast kemi të bëjmë me një vështrim më të përmbledhur, pas asnjë pretendim shterues, por duke u ndalur një disa prej debateve e shqetësimeve më domethënëse. Kjo për arsyen e thjeshtë se pavarësisht nga dallimet që ekzistojnë mes

Shqipërisë dhe Kosovës, tashmë është e qartë se sidomos në një fushë si ajo e fesë, ekzistojnë lidhje e një kontamimin reciprok, i cili nuk mund të neglizhohet.

Nga ana tjetër s'është e vështirë të mbërrish në përfundimin se mes dy shoqërive po ravijëzohen një sërë dallimesh domethënëse në lidhje me fenë. Sepse, siç del në përfundim dhe analiza që bën për këtë radioja e njohur gjermane Dojçe Vele, ndryshe nga ç'ndodh në shoqërinë shqiptare, ku gjithsesi radikalizmi fetar islamik vazhdon të mbetet një dukuri përgjithësisht marginale, ndërkohë që shoqëria në tërësinë e saj vazhdon të karakterizohet nga bashkëjetesa e toleranca fetare, në Kosovë me sa duket problemi është duke marrë përmasa mjaft më shqetësuese.

AN EXAMINATION OF
MEDIA COVERAGE
REGARDING ISSUES
RELATING TO RELIGION
January – December 2016

Institute for Dialogue and Communication

This study was made possible through the financial support of the Open Society Foundation for Albania

INTRODUCTION

This overview of the way in which the Albanian written media has covered and treated the range of issues relating to the subject of religion over a period of nine months to one year aims first of all to present as systematic and thorough a picture as possible of the relationship that exists between religion and the Albanian society. At the same time, it constitutes an attempt to identify the issues, concerns fears, claims, expectations as well as complains that characterize some of the main debates that are currently taking place in Albanian society on this matter.

It should be noted that in a sense this research is a continuation of a similar research conducted by the Institute for Dialogue and Communication several years ago (September 2011 – June 2012), titled “Albanian media reporting on religion, laicity and the public Space”. This is why it offers the possibility to compare the evolution not just of the media coverage of this issue, but above all, of the concerns and debates that accompany it.

The study in general covers an eight month period, beginning in January 2016 and ending in September of the same year.

The only exception is the chapter dedicated to the debate on

Turkish influence on Albanian Islam, and more specifically to the so-called “Gülenist question”. Although this is a much broader and complex question, because it is directly related to developments within the Albanian Muslim Community, and more generally to the broader debate on the use of religion by various countries as an instrument of political and geopolitical influence, made us dedicate a separate chapter to this issue. However, due to the fact that the debates on this issue, which has been present for some time, suddenly spiked in the months following the failed coup d’état in Turkey in mid July 2016, it was deemed appropriate to extend the examination of the debates on this issue, until the end of 2016.

As known, the Turkish government blamed the failed coup on the FETO movement (the Gülenist movement), and it declared an uncompromising war on it; a development that was reflected too in the repeated requests the Turkish government lodged with the Albanian government for it to take steps to eliminate the influence exerted in Albania by this movement, which is considered a terrorist organization by the Turkish government. According to the Turkish government, the FETO movement in Albania has a significant influence that is not limited just to the institutions that it controls, such as the network of schools, generally known as Turkish schools, but extends to politics, the media, the army and police and the academic world, including the Albanian Muslim Community and its institutions.

For reasons of methodology, the articles examined during this period have been divided into three main topic based groups, each

of which has been analyzed in a separate chapter. These topics are defined in broad outlines by the three main issues related to religion that attracted the attention of the public opinion during this time, and which caused plenty of discussions.

The first group includes those articles and writings that dealt with the heated debates ignited by the idea promoted a short time ago by Prime Minister Edi Rama on the inclusion of a subject on education about religion in the curricula of the public education system. Although the writings on this topic are perhaps fewer in number when compared to those in the other groups, given the importance of the issue, this is perhaps the most interesting of the three groups. In essence, this is a debate that revolves around the relationship between faith and religious institutions on the one hand and secular institutions on the other. This relationship constitutes one of the basic principles of Albania's constitution and in the view of many people it stands at the very foundation of the structure of religious coexistence that has existed since the creation of the Albanian state a little more than a century ago.

The second group, under the general heading "Religious coexistence and the threat of Islamic radicalism", includes the writings that have in common the issue of religious coexistence and the concerns about the various factors that could threaten it. Writings dealing with the issue of terrorism and more generally, Islamic radicalism, occupy an important place in this group. In a numerical sense, these constitute undoubtedly the biggest group. This is explained by the appearance in Albanian lands of a radical strain of Islam, of jihadist inclinations and with clear

international connections, which found its expression in the participation of a significant number of Albanians who went to fight in Syria and joined the ranks of the Islamic State. One of the issues that drew the most attention during this time was the so-called trial of the imams that took place in Tirana against a group accused of inciting religious hatred and recruiting fighters for the war in Syria. It was the first time that a trial of this nature took place in Albania.

The third, and last chapter, as mentioned earlier, deals with the so-called “Gülenist question”, but in fact, it addresses the broader issue of the potential implications that various religious influences from abroad can have on religious issues in the country, on religious coexistence, but also on the politics and geopolitical orientation of the Albanians.

* * *

In any case, the objective of this research is not to merely build a database of data concerning coverage of the topic of religion in the press in a given period of time. The main objective is to take as accurate a snapshot as possible of the attitudes of the Albanian press to this topic, in order to analyze, and ultimately, reach a number of conclusions on the place religion occupies in Albanian society. It also tries to identify what are some of the perceptions, problems or the main concerns and fears that Albanian society feels in this regard.

In order to do this, of course one must look at many cases that go beyond the limited period of time covered by the project, and make reference in more than a few instances to a number of phenomena, and especially to a number of debates, that have happened in the past, but remain relevant when it comes to understanding and explaining the most important tendencies, phenomena and tensions that have been noticed in recent years, especially as pertaining to the relationship between laicity, as one of the main constitutional principles on which the public life in the country is organized, and the ever growing pressure and presence of religion and its symbols in the public sphere.

But first and foremost, the aim is to examine and analyze the way in which the press has covered during this time a number of developments related to religion and the debates that have drawn an unusual attention by the public, as a way of shedding light and at the same time understanding better the sensitivities and influences that exist in various segments of public opinion concerning religion, or the discussions and concerns that are frequently raised about the potential interference of religion in Albanian politics or even in the language of politics. Or the perceived attempts by foreign actors to exploit religion as a geopolitical instrument of influence.

In conclusion, based on the material at hand, it will be possible to offer a very brief outline of several scenarios that concern the near future.

Of course, the examination focuses mostly on the press that is currently published in Albania proper, where there exists a historical sensitivity about the relationship between Albanian society and the religious factor. For practical reasons, the study mainly examines the press, and focuses much less on electronic media, the monitoring of which demands another level of engagement that was impossible for the project.

During a nine month period, the project collected all writings and articles related to religion that were published in Albanian dailies. In several cases, a number of articles that were initially published in some of the most influential online portals were also collected, but this happened only in those cases when these articles and writing were echoed or mentioned in the mainstream press.

The study also includes a special section dedicated to the Kosovo press and the debates that took place in Kosovo on this topic during the same period. Of course, in this case the examination has been briefer and more superficial. The reason for this is because despite the peculiarities and differences that exist between Albania and Kosovo in this regard, there is no doubt that for a multitude of reasons there exists between the two a connection and potential for dissemination that cannot be neglected.

Finally, by attempting to provide a systematic and inclusive

examination of the way in which Albanian press has covered the topic of religion, the place that it and the symbols associated with it occupy or should occupy in the public space, the study aims to reach two main objectives:

- To offer a general overview of the issues, and of the concerns, fears, claims, expectations and complaints that shape the perception of the public as a whole or of various, specific groups;
- To raise the awareness of the public about the problems, challenges and risks that a country like Albania faces in the era of globalization because of the confusion, ambiguity and the improvisation that has characterized this important element that is of such crucial importance when it comes to preserving the balances that have traditionally existed, as well as the religious cohesion of society as a whole.

* * *

During the period under examination there have been a record number of publications dealing with the topic of religion in the Albanian press. The project examined 487 writings and articles, but one can expect the real number to be higher, given the fact that the project focused on the most important dailies and on a

very limited number of online portals that were selected because of the impact they could have on the public debate. To put things in perspective, it is almost double the number of articles that were published 4 years ago.

However, the reason for this increased attention is relatively easy to explain. It concerns first and foremost, the special attention dedicated to the fight against religiously motivated terrorism during this period. One must remember that during this period the fight against the so-called Islamic State has topped the international agenda. Furthermore, in various European countries no so far from Albania, there have taken place a number of serious attacks, such as the terrorist attacks in Paris, Brussels or Turkey, which have all combined to increase the attention of the press on the topic of Islamic terrorism. One must also add to this the influx of refugees from the Middle East that crossed into Europe and the increase tensions and debates on religion that this has brought about in Europe. In this global context when there is a growing perception of the threat posed by Islamic radicalism, and when in many parts of Europe the use of stereotypes has grown alongside an anti-Islam populism, it is natural for a country like Albania to pay more attention to this topic.

This explains the significant increase of translations and publications of articles from international news media in the Albanian press during this time. These are articles that deal with Albania and the Albanian people, but also with the serious debate about Islam that is taking place in Europe.

In fact, if one looks closely, there have been many factors during this time, that in one way or another, have drawn more attention to the subject of religion in the press, as well as in the public discourse as a whole. Part of the reasons relates to the particular ambiguity that there exists in Albania. It is a country and a people that on the one hand are amongst the most enthusiastic supporters of everything European, and who see their historical perspective as closely linked to that of the great European family of nations, but on the other hand constitute one of the few nations where a majority of the population is of the Muslim faith. It is natural for such a situation to raise concerns and stir a debate about the risks that religious radicalism and Islamic jihad can present.

This explains the growing concern about the visible exploitation of the Islamic religion as a vehicle for political and geopolitical influence on the part of Turkey or the suspicions about the relationship between the Albanian Autocephalous Orthodox Church and Greece.

SOME CONCLUSIONS

This overview of the way in which the Albanian press has treated the issues relating to religion over a period of nine months to one year allows one too to draw a number of conclusions:

First, in Albania laicite (secularism), i.e. the principle according to which there is a strict and clear separation between state and religion, continues to serve, and enjoy widespread acceptance, as one of the most important constitutional principles. The dominant opinion is that the principle of laicite lays at the foundation of that exemplary coexistence between different religions that continues to characterize Albanian society.

Second, generally speaking, there exist a widespread awareness and outright conviction about the importance of religious tolerance and coexistence to the present and the future of the country, as well as of the fact that said tolerance and coexistence can be guaranteed only by preserving the equilibria

that have traditionally prevailed in a country like Albania. Indeed, this has become one of those beliefs that determine a cautious approach that prevails in all discussions relating to this subject. This in turn, perhaps explains the fact that, generally speaking, Albanian media shows great caution and sensitivity whenever covering issues that concern religion.

The only exceptions to this can be found in web pages or online blogs of Islamic inspiration where the principle of secularism is openly attacked. But such outlets operate in the fringes of the public debate and enjoy limited influence confined to certain circles.

Third, it must be said that in recent years a certain tension in the relations between secularism and religion, when it comes to the relation between religion and the public space, has become more visible. If up to now secularism was understood as the exclusion of religion and its symbols from the public space, hence confining it to the private sphere, it would seem that this interpretation of secularism is currently being subjected to increasing challenges stemming from certain circles. It is indeed this tension that constitutes the main subject of the debates that took place in the period examined by this study.

Schools, or to be more precise, the public elementary and secondary education system, continues to occupy center stage in these debates. From several years now a debate has been ongoing on whether religious symbols should be allowed in public schools of the elementary and secondary education system. Recently this

debate assumed a new dimension after Prime Minister Edi Ramay proposed the inclusion of religious education in the curricula of the public elementary and secondary schools. As expected, this proposal which directly concerns the future of the country caused a lot of discussion, during which one could clearly distinguish a gap in the respective positions of the two, main political camps in the country. While the right, which is currently in power, seems to be increasingly more open to allowing a growing presence of religion in the country's public sphere, the political left seems to remain loyal to a more traditional interpretation of secularism, insisting that religion and its symbols should not be allowed to enter the public sphere, and especially public schools. That said, one should take note of the very cautious tones that were observed during this political debate.

Fourth, during this period, there were clear and growing concerns about the use of religion by politics for electoral ends. This concern was noticeable too with respect to the growing frequency with which religious reference are used in the public discourse by many of the country's political leaders, especially from the right, and including from the Prime Minister.

It must be said, that for the moment, this development remains at an embryonic stage, but nevertheless, it has given rise to concerns, which were publicly.

Nevertheless, if the preliminary data that has been published by the press about the recent census of the population, which included questions on the religious belonging of Albania's

citizens, and according to which approximately 70 percent of Albanians refused to declare their religious belonging, since they considered it to be a private matter, will be confirmed, it will certainly have a direct and significant effect on the debate about the relations between secularism, religion and the public sphere.

When discussing the possible scenarios of the influence that religion may gain in the public sphere or even in Albanian politics, one must dedicate a separate chapter to the influences that come from abroad, and especially to those coming from Kosovo or Macedonia, amongst whose Albanian populations, as is known, religion occupies a far more visible place in public life. The reason for this is simple and straightforward: despite the specific differences that exist in all three of these Albanian inhabited territories in this respect, there is no doubt that there exist between them connections and a potential for mutual dissemination of ideas that cannot be ignored. After all, it cannot be a coincidence those mere months after a proposal for allowing religious teaching in public schools was presented to the Parliament of Kosovo, the same proposal was presented to the Albanian Parliament too.